

PROGRAMI ZGJEDHOR

2025

Kosova mundet ma mirë

Bedri Hamza
për Kryeministër.

PDK

PËRMBAJTJA

1. FJALA HYRËSE	3
2. VIZIONI DHE QËLLIMET KRYESORE	4
3. ZHVILLIM I QËNDRUESHËM PËR TË GJITHË	5
4. NJË JETË ME DINJITET PËR ÇDO FAMILJE	11
5. FURNIZIM I SIGURT DHE I QËNDRUESHËM ME ENERGJI ELEKTRIKE	14
6. NJË QASJE E RE PËR SEKTORIN MINERAR	17
7. BUJQËSI E ZHVILLUAR DHE INOVATIVE	20
8. ARSIMI, GATI PËR TË ARDHMEN	24
9. SHËNDETËSI ME PACIENTIN NË QENDËR	29
10. BASHKË PËR NJË KOSOVË TË GJELBËR	34
11. DREJTËSI E REFORMUAR PËR KOSOVËN	37
12. ADMINISTRATA PUBLIKE NË SHËRBIM TË QYTETARËVE	41
13. NJË KOSOVË E FORTË DHE E PËRGATITUR PËR ÇDO SFIDË	44
14. ART DHE KULTURË PËR TË GJITHË	46
15. TURIZMI NË FUNKSION TË ZHVILLIMIT	50
16. KOSOVA, SHTET I SPORTIT DHE SPORTISTËVE ELITARË	53
17. POLITIKA E JASHTME E KOSOVËS: RRUGA PËR PARTNERITET, NJOHJE, SIGURI DHE ZHVILLIM	56

1. Fjala Hyrëse

Jeta e qytetarëve të Kosovës ka mundur të jetë më e mirë në katër vjetët e fundit. Ka mundur të jetë shumë më mirë edhe Kosova. Jemi pajtuar me të gjithë ju për këtë. Unë me qytetarët, me plane të matshme e konkrete për ta dhe Kosovën, e kemi bërë programin tonë. Është fryt i shumë punëtorëve që i kam zhvilluar në Kosovë dhe diasporë. Është reflektim i asaj që më keni kërkuar dhe jam konsultuar me ndërmarrës, mësimdhënës dhe me ekspertë të shumtë. Është tërësisht i realizueshëm dhe do të zbatohet në qeverisjen time nga ministria kompetentë, të cilët i kuptojnë nevojat e qytetarëve dhe kanë ekspertizën e duhur për fushat që do t'i mbulojnë. Është program që krijon mundësi dhe kushte që çdo qytetar, çdo profesionist, çdo punëtor ta realizojë veten në profesionin dhe punën e tij, jo diku tjetër, por në Kosovë.

Në vendet me ekonomi jo aq të zhvilluar, me papunësi të theksuar, programi më i rëndësishëm i mirëqenies sociale për çdo qytetar është një punë e mirë me pagë të dinjitetshme. Paga të dinjitetshme do të ketë për të gjithë. Jam i dëshmuar për këtë. Ekzistojnë strategji të mirëfillta për t'i rritur të ardhurat, duke e ruajtur stabilitetin fiskal. Ekzistojnë zgjidhje ku të gjithë mund të fitojnë. I kam parë mangësitë e qeverisë aktuale. I kam parë edhe mundësitë e humbura. Besimin tuaj e kërkoj, sepse jam i bindur që alternativa që ofroj është më e mira për ju.

Sa ju është përmirësuar jeta gjatë këtyre katër vjetëve? Sa është shtrenjtuar shporta juaj si konsumatorë? A po i rrisni fëmijët tuaj më lehtë dhe a po arsimohen ata më mirë? Kujdesi ndaj të moshuarve a është përmirësuar? Po shërbimet shëndetësore? Këto janë shqetësimet e përditshme të të gjithë qytetarëve tanë. Unë ofroj zgjidhje për to!

Ne nuk mund të rrimë duarkryq teksa mijëra të rinj, vajza dhe djem, largohen çdo vit, pasi nuk shohin këtu të ardhme. Nuk mund të heshtim teksa Kosova izolohet gjithnjë e më shumë. Nuk mund as të qëndrojmë indiferentë kur partnerët ndërkombëtarë, që na përkrahën ndër dekada, sot janë të zhgënjyer nga mungesa e përparimit dhe e bashkëpunimit. Është e rëndë teksa shohim shumë kompani që mbyllen për shkak të mungesës së inxhinierëve dhe operatorëve të makinerisë prodhuese, sepse ata po ikin në kërkim të mundësive më të mira në vende të huaja.

Ekonomia jonë po përballlet me kriza të njëpasnjëshme. Qytetarët janë lënë të vetëm në betejën e përballjes me kostot e jetesës. E sfidat e tyre nuk janë thjesht numra të raporteve. Ato janë jetë njerëzish. Janë prindër që nuk mund t'ua sigurojnë fëmijëve të ardhmen që meritojnë. Janë të rinj të talentuar që po e braktisin vendin me zemër të thyer.

Kjo gjendje duhet të ndryshojë. Ne duhet të bëhemi bashkë që ta ndryshojmë.

Në këtë udhëkryq për Kosovën ne po qëndrojmë përballë një zgjedhjeje vendimtare: ta pranojmë gjendjen në të cilën jemi apo të bashkohemi që të punojmë për një Kosovë më të mirë? Unë kam zgjedhur të dytën kur e kam pranuar nominimin për Kryeministër. Programi im nuk është thjesht një premtim për të nesërmen. Është një thirrje për veprim. Është një kampanë që fton çdo qytetar të Kosovës të besojë në forcën e tij, në mundësitë që vendi ynë ofron. Është ftesë për t'u bashkuar që ta bëjmë Kosovën më të mirë.

Lexoni programin tim! Analizojeni! Nëse e gjeni veten në të dhe dëshironi që të jetësohet, bashkohuni me mua! Kosova duhet të ecë përpara dhe e diela e 9 shkurtit 2025 është një shans që nuk guxojmë ta humbim!

Për të mirën e përgjithshme, për të mirën e fëmijëve, grave dhe burrave, të rinjve dhe të moshuarve, ju ftoj të bëhemi bashkë dhe ta bëjmë Kosovën ma të mirë!

TË GJITHË, PA DALLIM!



Me respekt,
BEDRI HAMZA
Kandidat për Kryeministër

PDK

2. Vizioni dhe qëllimet kryesore

VIZIONI

Kosova, shtet i bazuar në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit privat, me një rol mbështetës dhe lehtësues të qeverisë, e aftë për të siguruar të ardhura dhe mirëqenie të lartë për të gjithë qytetarët, ku të rinjtë e gjejnë perspektivën për t'u zhvilluar, ku nevojtarët e gjejnë mbështetjen e duhur nga shteti, ku shteti është i aftë të ofrojë siguri dhe kushte për të gjithë ata që kërkojnë një jetë të lumtur dhe prosperuese.

Plani ynë, "Kosova mundet ma mirë", paraqet një agjendë transformuese, e cila mundëson adresimin e sfidave dhe nevojave kryesore që i ka vendi për të siguruar një jetë më të mirë për të gjithë qytetarët.

PLANI YNË ZHVILLIMOR NDËRTOHET RRETH KËTYRE PESË QËLLIMEVE KYÇE:

1. ZHVILLIM I QËNDRUESHËM EKONOMIK

Transformimi i vendit përmes investimeve strategjike në infrastrukturë, nxitja e kapitalit privat, krijimi i vendeve të reja të punës dhe sigurimi i stabilitetit energjetik. Synimi ynë është një zhvillim gjithëpërfshirës që fuqizon çdo rajon dhe rrit cilësinë e jetesës për qytetarët, duke krijuar një ekonomi të qëndrueshme për brezat e ardhshëm. Përmes këtij angazhimi të fuqishëm synojmë t'i rrisim mundësitë ekonomike për të gjithë qytetarët, duke ofruar shanse reale për një të ardhme më të mirë dhe të sigurt në vendin e tyre.

2. JETË MË E MIRË PËR SECILIN

Ne synojmë ta bëjmë Kosovën një vend tërheqës për të jetuar, për të punuar dhe për të ndërtuar një të ardhme prosperuese. Kosova do të shndërrohet në një vend të mirë për rritjen e një familjeje. Të rinjtë do ta gjejnë perspektivën e nevojshme për zhvillimin e tyre, familjet do ta gjejnë mbështetjen e shtetit në çdo hap dhe shteti do të garantojë siguri dhe kushte ideale për të gjithë ata që synojnë një jetë të lumtur. Nëpërmjet masave për rritjen e të ardhurave për familjet e Kosovës dhe ofrimin e shërbimeve publike cilësore, do ta bëjmë Kosovën një vend që ofron jetë më të mirë për të gjithë.

3. ARSIM PËR TË ARDHMEN

Ne synojmë t'i ofrojmë çdo nxënësi dhe studentin në Kosovë dijen, shkathtësitë dhe mundësitë që u nevojiten për të pasur sukses në një botë që po ndryshon me shpejtësi. Duke e pajisur sistemin arsimor me burimet dhe mbështetjen e nevojshme, si për mësimdhënësit, ashtu edhe për nxënësit e studentët, Kosova do të pozicionohet si shembull i transformimit arsimor në rajon.

4. SISTEM SHËNDETËSOR ME PACIENTIN NË QENDËR

Krijimi i një sistemi shëndetësor që ofron kujdes të qashtëm dhe modern për të gjithë qytetarët është thelbësor për përmirësimin e cilësisë së jetesës. Ky sistem do të sigurojë shërbime mjekësore të lehta për t'u arritur, të fokusuara në nevojat e pacientëve, duke kontribuar kështu në një shoqëri më të shëndetshme.

5. NJË KOSOVË E SIGURT DHE E INTEGRUAR

Rruga e Kosovës drejt stabilitetit, rritjes dhe prosperitetit mbështetet në një strategji gjithëpërfshirëse që ngërthen sigurinë, angazhimin diplomatik dhe integrimin ekonomik. Kjo kërkon një qasje të shumanshme, me theks të veçantë në bashkëpunim, gjithëpërfshirjen dhe partneritetet strategjike për të siguruar një të ardhme të sigurt dhe të begatë për qytetarët e Kosovës.

3

ZHVILLIM I QËNDRUESHËM PËR TË GJITHË



PDK

3. ZHVILLIM I QËNDRUESHËM PËR TË GJITHË



VEPRIMET E PROPOZUARA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

1. LEHTËSIMI I BARRËS TATIMORE PËR TA NXITUR EKONOMINË. Do ta realizojmë reformën fiskale për ta lehtësuar barrën tatimore dhe për ta forcuar rolin e politikës fiskale në nxitjen e zhvillimit ekonomik. Ne do ta ndryshojmë praktikën e deritanishme të pagesës së TVSh-së për mallrat e importuara në kufi, e cila i ka ngarkuar bizneset ta paguajnë TVSh-në para se ta shesin produktin – praktikë kjo e padrejtë për bizneset. Për ta lehtësuar këtë barrë të bizneseve, ne do ta transferojmë mbledhjen e TVSh-së brenda Kosovës, në mënyrë që biznesi ta paguajë TVSh-në pasi ta ketë shitur produktin. Bizneset e vogla me qarkullim vjetor deri në 10 000 €, përjashtuar aktivitetet e shërbimeve si avokatura apo konsulenca, do të jenë të liruar nga tatimi. Për më tepër, bizneset e shërbimeve me qarkullim vjetor ndërmjet 10 000 € dhe 30 000 € do të taten bazuar në fitimin real pas zbritjeve të lejuara, në vend të normës aktuale prej 9 %. Do të zbatojmë dispozita ligjore që lejojnë pushime tatimore për t'i inkurajuar investimet vendore dhe të huaja. Bizneset që investojnë mbi 500 000 euro apo punësojnë mbi 50 punëtorë do të lirohen nga tatimi në fitim për periudha të caktuara kohore. Po ashtu, do ta shfuqizojmë ligjin aktual për tatimin në pronë, për të siguruar barrë të përballeshme tatimore për familjet dhe bizneset. Me qëllim të zvogëlimit të barrës tatimore në të ardhurat personale, pragu i të ardhurave personale që lirohen

nga tatimi do të rritet, duke bërë që të ardhurat deri në 400 € të kenë zero tatim. Të ardhurat ndërmjet 400 € dhe 800 € do të taten me normën 8 %, ndërsa të ardhurat mbi 800 € do të taten me normën 10 %. Ky ndryshim do ta zvogëlojë barrën fiskale për qytetarët tanë përballë rritjes së kostove të jetesës dhe do ta nxisë konsumin përmes rritjes së fuqisë blerëse në ekonominë tonë.

2. MJEDIS TË FAVORSHËM PËR INVESTIME. Do të ofrojmë mbështetje të drejtpërdrejtë për investimet private dhe do të sigurojmë një ambient miqësor për zhvillimin e sektorit privat. Ekonomia jonë do të hapë më shumë vende pune, të ardhura më të mëdha dhe kushte më të dinjitetshme për punëtorët e sektorit privat. Për t'i stimuluar investimet në sektorin privat, ne do të paraqesim një program të mbështetjes financiare që ofron subvencione dhe grante deri në 30 % të shumës totale të investimit. Kjo iniciativë është e orientuar drejt bizneseve me plane të mira dhe të qëndrueshme për ta rritur prodhimin vendor, për ta zvogëluar varësinë nga importet dhe për ta zgjeruar tutje zinxhirin e prodhimit brenda Kosovës.

3. NGRITJA E PRODHIMIT VENDOR DHE NXITJA E EKSPORTEVE. Ne do t'i mbështesim industrinë tona që të bëhen konkurruese në skenën globale, duke zvogëluar deficitin tonë tregtar dhe duke ndërtuar një ekonomi më të fortë dhe më të mbështetur te vetja. Për ta mbështetur rritjen e eksporteve, do të paraqesim një sërë masash të veçanta për eksportuesit. Do të ofrojmë produkte të posaçme të garantimit kreditor për kompanitë eksportuese në mënyrë që t'ua mundësojmë rrjedhën e parasë në kohën e duhur. Për ta rritur konkurrueshmërinë e produkteve të Kosovës, do ta mbështesim modernizimin e teknologjisë së prodhimit, duke subvencionuar investimet dhe duke ofruar pako të veçanta të granteve për zëvendësim dhe avancim të teknologjisë së kompanive eksportuese. Për ta lehtësuar depërtimin e produkteve të Kosovës në tregjet e jashtme, do ta përforcojmë diplomacinë ekonomike, duke shfrytëzuar praninë tonë diplomatike jashtë vendit dhe odat tona të biznesit. Duke lidhur bizneset tona me partnerë ndërkombëtarë dhe tregje të reja, ne synojmë t'i rrisim eksportet dhe ta forcojmë pozitën konkurruese të Kosovës në ekonominë globale. Masat mbështetëse për eksportuesit do të përfshijnë edhe krijimin e zonave të veçanta eksportuese që do të ofrojnë lehtësira tatimore, procedura të thjeshtuara administrative dhe mbështetje infrastrukturore për bizneset eksportuese. PDK-ja do të angazhohet për tërheqjen e investimeve serioze që kontribuojnë në zhvillimin dhe forcimin e prodhimit vendor me qëllim të krijimit të vendeve të punës dhe rritjes së fuqisë ekonomike të vendit.

4. REFORMIM I FUNKSIONIT TË FONDIT TË GARANTIMIT TË KREDIVE TË KOSOVËS.

Do ta zgjerojmë fushëveprimin e Fondit të Garantimit të Kredive të Kosovës për ta përmirësuar qasjen në financa për sektorët strategjikë. Për ta përmirësuar qasjen në financa, ne do ta zgjerojmë rolin e Fondit të Garantimit të Kredive të Kosovës (FGKK), duke i mundësuar lejimin e linjave kreditore për shfrytëzim të destinuar për institucionet kredidhënëse që operojnë në Kosovë. Kjo do t'ju sigurojë institucioneve kredidhënëse qasje në fonde më të lira, të cilat pastaj do të shndërrohen në kredi me kushte më të favorshme për bizneset që operojnë në sektorët me rëndësi të veçantë strategjike në Kosovë. Procesi i përzgjedhjes së përfituesve të kredive brenda sektorëve të caktuar ekonomikë do të mbetet plotësisht në dorën e institucioneve kreditore, pa asnjë ndërhyrje nga FGKK me qëllim që të evitohet çdo interferim i mundshëm nga institucionet publike. Po ashtu, do ta rrisim shkallën e mbulueshmërisë së garancisë kreditore për kreditë që u lëshohen sektorëve strategjikë, si dhe do të sigurohemi që kreditë që garantohen nga FGKK të bartin norma më të ulëta të interesit.

5. THEMELIMI I BURSËS SË KOSOVËS SI DOMOSDOSHMËRI PËR ZHVILLIM.

Ne do ta themelojmë Bursën e Kosovës për t'i përmirësuar mundësitë e financimit dhe për ta mbështetur zhvillimin ndërkombëtar të kompanive të Kosovës. Bursa do të shërbejë si një platformë e tregut të kapitalit për sektorin privat, ku do të tregtohen aksionet dhe letrat me vlerë të korporatave nga Kosova. Kjo do të krijojë një kanal të ri për kompanitë vendore që të mbledhin fonde nga investitorët dhe të përfitojnë nga burimet financiare të tregjeve të kapitalit, duke shtuar konkurrencën në sistemin financiar dhe duke ulur kostot e financimit. Përmes Bursës së Kosovës, kompanitë e Kosovës do të kenë mundësi të zgjerohen më shpejt, ta rrisin efikasitetin e tyre dhe t'i zgjerojnë operacionet e tyre në tregjet ndërkombëtare. Një nga përfitimet kryesore të kësaj burse do të jetë mundësia për diasporën e Kosovës dhe investitorët e huaj që të investojnë në kompanitë tona, duke sjell kapital të ri dhe duke kontribuar në rritjen e ekonomisë vendore. Kjo platformë do të bëhet një burim i rëndësishëm i fondeve për kompanitë e suksesshme, veçanërisht për ato që kanë nevoja financiare që shkojnë përtej kapaciteteve të sistemit bankar lokal. Ndërmarrjet publike do të reformohen dhe gradualisht do të kuotohen në bursë, për ta rritur efikasitetin, transparencën dhe për të siguruar financim shtesë përmes investitorëve privatë. Ky proces jo vetëm që do t'i forcojë ndërmarrjet publike, por do të ofrojë edhe mundësi për investitorët dhe qytetarët që të marrin pjesë në zhvillimin e ekonomisë së vendit.

6. FUQI PUNËTORE E AFTË PËR TA NXITUR ZHVILLIMIN.

Ne do të zbatojmë masa strategjike për ta rritur produktivitetin dhe aftësitë e fuqisë punëtore në Kosovë, duke investuar në trajnime të avancuara dhe inovacion. Për të zhvilluar profesionistë të kualifikuar në sektorë kyçë, do të ofrojmë subvencione për trajnime ndërkombëtare, duke sjell njohuri dhe praktika globale në vend. Mbështetja për inovacionin brenda ndërmarrjeve private do të krijojë kushte për adoptimin e teknologjive të reja dhe përmirësimin e efikasitetit, duke përfshirë grante për projekte me përparësi teknologjike. Do të nxisim, gjithashtu, zhvillimin e shkollave profesionale në fusha si programimi, inteligjenca artificiale dhe shërbimet teknike, duke lidhur trajnimin profesional me nevojat e tregut të punës. Përmes praktikave profesionale do të fitojnë të rinjtë përvojë të drejtpërdrejtë në kompani, duke ndihmuar zhvillimin e aftësive të tyre teknike dhe menaxheriale. Këto masa do ta përgatisin fuqinë punëtore për kërkesat e së ardhmes dhe do ta rrisin konkurrencën e kompanive vendase në tregjet ndërkombëtare.

8. INVESTIMET PUBLIKE NË FUNKSION TË ZHVILLIMIT EKONOMIK.

Do ta rrisim shkallën e realizimit të projekteve publike dhe do të lansojmë projekte të mëdha të investimeve kapitale publike për zhvillim të qëndrueshëm. Përmes një procesi më dinamik të realizimit të investimeve publike, do të sigurojmë që vendi të ndjekë një ritëm të shpejtë të zhvillimit të infrastrukturës së nevojshme për rritje të mirëqenies dhe zhvillim të qëndrueshëm. Gjithashtu, do të nisim iniciativa të reja të mëdha kapitale në infrastrukturën e transportit, arsim, shëndetësi, kulturë dhe sport. Përmes rritjes së investimeve publike kapitale, po ashtu do të gjenerojmë rritje të aktivitetit për sektorin privat, e cila do të reflektohet në më shumë vende pune dhe të ardhura më të larta për qytetarët tanë.

9. MODERNIZIMI I INFRASTRUKTURËS PËR TË MUNDËSUAR NJË EKONOMI TË ZHVILLUAR.

Do t'i përfundojmë segmentet kryesore të autostradave dhe do të bëjmë investime të mëdha në infrastrukturën rrugore dhe hekurudhore për përmirësimin e lidhshmërisë, lëvizshmërisë së shpejtë dhe sigurisë. Do të përfundohen segmentet e autostradave që janë në ndërtim dhe do të mundësojmë një lidhje sa më të shpejtë e efikase rrugore me të gjitha vendet fqinje, duke synuar që në të ardhmen e afërme të realizohen lidhje ndërshtetërore edhe hekurudhore për ta bërë Kosovën një nyje nevralgjike të transportit në rajon. Do të ndërtojmë rrugë të reja për t'i anashkaluar qendrat urbane dhe për ta zvogëluar kohën e udhëtimit, si dhe do ta rrisim buxhetin e alokuar për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e rrugëve ekzistuese, duke përfshirë edhe krijimin e një linje të veçantë buxhetore për mirëmbajtjen e rrugëve që janë nën përgjegjësinë e

komunave. Ne do ta rrisim nivelin e sigurisë rrugore dhe do ta instalojmë sistemin inteligjent të transportit në autostrada dhe rrugë nacionale, për ta përmirësuar sigurinë dhe për ta adresuar rritjen e aksidenteve me fatalitet.

PROJEKTET PRIORITARE TË INFRASTRUKTURËS RRUGORE:

- Investimi në ndërtimin dhe elektrifikimin e linjës hekurudhore Prishtinë - Fushë-Kosovë - Aeroporti i Prishtinës "Adem Jashari".
- Linjat e Tramvajit për Transportin Publik në Prishtinë, të cilat do të përfshijnë jo vetëm zonat e urbane dhe periferike të Prishtinës, por edhe linjat për Fushë-Kosovë, Lipjan dhe Graçanicë.
- Ndërtimi i Unazës së Re gjithëpërfshirëse të kryeqytetit.
- Përfundimi i autostradës Prishtinë - Gjilan - Dheu i Bardhë.
- Finalizimi i segmentit të mbetur të autostradës Besi - Merdar, pjesë e rrugës evropiane R7.
- Ndërtimi i segmentit të lidhjes së autostradave, përkatësisht kyçja Qafë e Duhllës - Shtime - Lipjan - kyçja në Baullë.
- Finalizimi i projektit të zgjerimit të rrugëve nacionale Prishtinë - Pejë (M9) dhe Prishtinë - Mitrovicë (M2).
- Nisja e zgjerimit të rrugëve nacionale Istog - Pejë - Deçan - Gjakovë - Prizren.
- Përfundimi i rrugës Deçan - Plavë.
- Finalizimi i ndërtimit të rrugës Prizren - Tetovë.
- Përfundimi i rrugës që lidh Restelicën me Dibrën e Madhe dhe shndërrimi i pikës kufitare të Strezimitit në një pikë kufitare të përhershme.
- Rruga dhe pika e re kufitare me Maqedoninë e Veriut, Debëllde - Tanushë.
- Përfundimi i projektit të modernizimit të linjës hekurudhore 10 (148 km e gjatë Leshak - Hani i Elezit), e cila e integron Kosovën në rrjetin ndërkombëtar hekurudhor.
- Ndërtimi i lidhjes hekurudhore me Shqipërinë.
- Negocimi dhe projektimi i një lidhjeje të re me autostradën dhe hekurudhën me Malin e Zi.
- Funksionalizimi i linjës Klinë - Prizren dhe elektrifikimi i rrjetit hekurudhor për ta ngritur nivelin e shërbimit me shpejtësi prej 120 km/h.

10. NDËRMARRJET PUBLIKE NGA BARRË NË INSTRUMENT ZHVILLIMI. Ne do t'i transformojmë ndërmarrjet publike në ndërmarrje të vetëqëndrueshme dhe konkurruese, duke i kthyer ato në faktorë të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik të vendit. Ndërmarrjet publike me potencial për zhvillim do të përfshihen në programet për përmirësimin e performancës financiare dhe operacionale. Këto programe do të ndihmojnë në rritjen e efikasitetit të ndërmarrjeve, në përmirësimin e menaxhimit dhe në optimizimin e burimeve të tyre. Ne do të përfshijmë, gjithashtu, kompani prestigjioze ndërkombëtare të konsulencës për të ofruar mbështetje teknike dhe ekspertizë në procesin e reformës së këtyre ndërmarrjeve,

duke siguruar që ato të adoptojnë standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare në operacionet e tyre. Pasi ta rikuperojnë performancën dhe ta rrisin vlerën e tyre në treg, do t'i krijojmë kushtet për privatizimin e një pjese të pronësisë së këtyre ndërmarrjeve, duke i kuotuar ato në Bursën e Kosovës. Kjo qasje do të ndihmojë jo vetëm në tërheqjen e investitorëve privatë, por edhe në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së ndërmarrjeve. Procesi i kuotimit në bursë do ta forcojë pozicionin konkurrues të këtyre kompanive në tregun lokal e ndërkombëtar dhe do ta nxisë kreativitetin dhe inovacionin brenda tyre. Në vend që të jenë barrë për financat publike, këto ndërmarrje do të kontribuojnë në rritjen e ekonomisë së vendit dhe do të bëhen një shtytës i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik. Nëpërmjet këtij transformimi synojmë të sigurojmë që ndërmarrjet publike të jenë më të përgjegjshme dhe të vetëqëndrueshme, duke krijuar mundësi për përfitime afatgjatë dhe rritje të qëndrueshme. Duke u bazuar në përvojat e suksesshme të vendeve të tjera, kombinimi i reformave financiare dhe operacionale me pjesëmarrjen në tregjet e kapitalit do të sjellë një forcim të strukturës ekonomike dhe do të tërheqë investime të reja për rritjen dhe zhvillimin e sektorit publik në Kosovë.

11. FORMALIZIMI I NDËRTIMEVE: ZHBLOKIMI I MILIARDA EUROVE KAPITAL. Do ta përshejtojmë legalizimin e ndërtimeve pa leje dhe do t'i aplikojmë lejet elektronike për t'i zvogëluar mundësitë e informalitetit dhe burokracinë. Kosova përballet me një problem të madh me mbi 300 mijë ndërtesa dhe banesa pa leje, duke bllokuar rreth 10 miliardë euro kapital të papërdorur. Për ta adresuar këtë sfidë dhe për ta formalizuar sektorin e ndërtimit, PDK-ja propozon amendamentimin e ligjit ekzistues për legalizimin e ndërtimeve, aty ku nuk preken pronat publike apo interesi publik. Ndërtesat pa leje do të legalizohen me një tarifë simbolike prej një eurosh për metër katror, me lehtësira të plota për familjet në asistencë sociale, veteranët, familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës. Për ta përshejtuar këtë proces, do të krijohet Agjencia e Trajtimit të Ndërtesave pa Leje, e cila do të funksionojë si një "one-stop-shop", duke bashkërenduar të gjitha institucionet e përfshira dhe duke operuar nën Zyrën e Kryeministrit në bashkëpunim të ngushtë me komunat. Gjithashtu, do të vendoset një sistem elektronik për lejet e ndërtimit për ta parandaluar informalitetin në të ardhmen dhe për ta automatizuar të gjithë procesin e dhënies së lejeve, duke zvogëluar burokracinë dhe kontaktin e drejtpërdrejtë midis qytetarëve dhe zyrtarëve. Kjo iniciativë do ta rrisë transparencën, do t'i përmirësojë procedurat administrative, do t'i inkurajojë investimet në sektorin e ndërtimit dhe do të gjenerojë të ardhura të reja për buxhetin e shtetit.

12. INVESTIME DHE ZHVILLIM PËR TË GJITHA RAJONET E KOSOVËS. Do ta promovojmë zhvillimin e balancuar rajonal, duke ringjallur qytetet e vogla dhe mbështetur investimet lokale. Për ta promovuar zhvillimin e balancuar rajonal, do të paraqesim masa specifike për t'i bërë qytetet më të vogla më

atraktive për t'u vizituar dhe për të investuar, duke u ofruar qytetarëve një perspektivë për jetë më të mirë në rajonet e tyre të origjinës. Do ta vazhdojmë ndërtimin dhe përmirësimin e rrugëve tregtare dhe infrastrukturës logjistike që lidhin qytetet e vogla me qendrat e mëdha ekonomike, duke lehtësuar transportin e mallrave dhe duke përmirësuar qasjen në tregje e shërbime. Kjo do ta ulë edhe trendin e zhvendosjes së banorëve të këtyre zonave. Do të mbështesim projekte turistike dhe do t'i mbrojmë aktivitetet artizanale që karakterizojnë këto zona, duke theksuar veçantitë lokale dhe duke i bërë më tërheqëse për vizitorë. Do të ofrojmë mbështetje të veçantë për investitorët që investojnë në zonat më pak të zhvilluara të Kosovës, duke përfshirë projekte të targetuara infrastrukturore dhe subvencionimin e të punësuarve. Duke nxitur zhvillimin e balancuar rajonal, ne do të sigurojmë që rritja dhe prosperiteti ekonomik të arrijnë në çdo cep të vendit tonë. Do të transferojmë ose ndërtojmë institucione të reja shtetërore qendrore pikërisht në zona periferike për ta balancuar zhvillimin. Do të krijojmë një program bursash për studentët që vijnë nga zonat e vogla urbane apo rurale dhe më pak të zhvilluara për t'i mbështetur në arsimimin e tyre.

15. NDËRTIMI I PARKUT LOGJISTIK PRANË TERMINALIT HEKURUDHOR TË MALLRAVE NË MIRADI. Kosova ka nevojë për një sistem logjistik të integruar dhe efikas për ta përkrahur zhvillimin ekonomik. Ndërtimi i një parku logjistik pranë terminalit hekurudhor në Miradi do të krijojë një qendër të transportit multimodal, duke lidhur transportin tokësor, ajror dhe hekurudhor. Afërsia me autostradat kryesore dhe Aeroportin "Adem Jashari" do ta përmirësojë koston dhe shpejtësinë e logjistikës, duke e bërë Kosovën më konkurruese në rajon. Parku do të ofrojë kapacitete moderne për magazinim dhe shpërndarje, duke shkurtuar kohën dhe koston e transportit dhe duke përmirësuar zinxhirin e furnizimit.

16. NDËRTIMI I AKUMULIMEVE ARTIFICIALE UJORE NË KOSOVË. Kosova përballet me mungesë të madhe të burimeve ujore, me vetëm 15 % të tokave bujqësore të mbuluara nga sisteme vaditjeje. Ndërtimi i akumulimeve ujore, përfshirë digat e reja në Firajë, Shtime, Kuqicë (Skenderaj), Verboc (Drenas), Pollatë (Llap) dhe Kamenicë (në Kremenatë, Desivojcë dhe Shipashnicë), është i domosdoshëm për të siguruar furnizim të qëndrueshëm me ujë për bujqësi, konsum të pijshëm dhe industri. Ky program synon të krijojë rezerva të reja ujore që mbështesin zhvillimin bujqësor, rrisin sigurinë ushqimore, ofrojnë furnizim të qëndrueshëm dhe përmirësojnë cilësinë e ujit të pijshëm. Për më tepër, digat do të pajisen me turbina për prodhimin e energjisë elektrike, duke diversifikuar burimet energjetike të Kosovës. Akumulimet do të shërbejnë edhe si destinacione turistike, duke nxitur turizmin dhe krijuar vende të reja pune. Ky investim strategjik do të sigurojë një furnizim të qëndrueshëm me ujë dhe do ta mbështesë zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të vendit.

VEPRIMET E PROPOZUARA PËR TREGUN E PUNËS

1. FONDI I PAPUNËSISË PËR TA MBËSHTETUR MIRËQENIEN DHE ZHVILLIMIN E AFTËSIVE TË TË PAPUNËSUARVE. Ne do ta krijojmë Fondin e Papunësisë për ta mbështetur mirëqenien e fuqisë tonë punëtore. Ky fond do të ofrojë përfitime të papunësisë për një periudhë të caktuar, duke ndihmuar qytetarët t'i përballojnë nevojat e përditshme të jetesës në rast humbjeje të punës. Gjatë kësaj periudhe punëtorët do të mbështeten edhe me trajnime profesionale për zhvillim të aftësive, të cilat do t'i ndihmojnë ata të gjejnë punë të re dhe t'i përmbushin kërkesat e tregut të punës. Ky fond reflekton angazhimin tonë për mirëqenien e fuqisë sonë punëtore dhe do të sigurojë një mbështetje të fortë për përshtatjen e saj në tregun e punës, duke ndjekur mundësi të reja karriere me besim dhe optimizëm.

2. ZGJERIMI DHE FORCIMI I FONDIT TË PUNËSIMIT PËR MBËSHTETJE TË PROGRAMEVE TË PUNËSIMIT TË QËNDRUESHËM, PRAKTIKËS ME PAGESË DHE AFTËSIMIT PROFESIONAL. Ky fond do të financojë programe të subvencioneve për punësim të qëndrueshëm, praktikë me pagesë, trajnim në punë dhe aftësim profesional, duke siguruar që çdo qytetar të ketë qasje në mundësi për t'u zhvilluar dhe për të gjetur punë. Fondi do t'i mbështesë aktivisht iniciativat e punëdhënësve për të punësuar punëtorë të rinj, si dhe iniciativat e punëkërkesve për të gjetur punë të përshtatshme. Një skemë e veçantë do të krijohet për bizneset fillestare të të rinjve (start-up), e cila do ta përfshijë udhëzimin, këshillimin, trajnimin, mentorimin dhe mbështetjen financiare për themelimin e veprimtarive të tyre të biznesit. Me këto masa synojmë të krijojmë një mjedis, ku çdo individ ka mundësi ta zhvillojë potencialin e tij dhe të kontribuojë në rritjen ekonomike të vendit. Për ta përmirësuar lidhjen ndërmjet kërkesës dhe ofertës së fuqisë punëtore, do ta zhvillojmë sistemin e inteligjencës së tregut të punës përmes mbledhjes, analizës dhe shpërndarjes së të dhënave në lidhje me tregun e punës, përfshirë tendencat e punësimit, demografinë e fuqisë punëtore, vendet e lira të punës, kërkesat për aftësi dhe kushtet ekonomike.

3. SKEMA "DIL PREJ SOCIALIT" PËR T'I NDIHMUAR PRANUESIT E NDIHMAVE SOCIALE PËR T'U INTEGRUAR NË FUQINË PUNËTORE. Ne do ta zhvillojmë programin qeveritar "Dil prej sociali" për t'i inkurajuar dhe mbështetur përfituesit e skemave sociale që të integrohen në tregun e punës. Ky program do ta përfshijë mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe trajnimit, si dhe subvencione punësimi për përfituesit e asistencës sociale. Ne nuk e matim suksesin tonë me numrin e njerëzve që marrin përfitime sociale, por me numrin e atyre që largohen nga këto skema dhe integrohen në tregun e punës. Synimi ynë është të krijojmë një sistem gjithëpërfshirës të mbrojtjes sociale që siguron një minimum të të ardhurave mujore për qytetarët në nevojë, ndërsa punojmë aktivisht për

t'i ndihmuar ata të sigurojnë punësim të qëndrueshëm dhe të kontribuojnë në zhvillimin e vendit.

4. PËRMIRËSIMI I POZICIONIT TË NËNAVE NË TREGUN E PUNËS. Ne jemi të përkushtuar për ta përmirësuar pozicionin e nënave në tregun e punës dhe për të siguruar që ato ta kenë mbështetjen e duhur gjatë periudhës së lindjes. Për këtë qëllim, ne do ta rishikojmë Ligjin e Punës për të ofruar një kompensim të denjë për pushimin e lindjes për nënat. Aktualisht, nënat mbeten në një pozitë të dobët financiare gjatë pushimit të lindjes. Për ta mbrojtur më tej pozicionin e nënave në tregun e punës, do ta përfshijmë pushimin prindëror për lindje, duke u mundësuar edhe baballarëve të marrin pushim lindjeje. Këto masa do të kontribuojnë në krijimin e një mjedisit më të drejtë dhe mbështetës për të gjitha familjet, duke përmirësuar mirëqenien e prindërve dhe siguruar një fillim të fortë për të gjithë fëmijët tanë.

5. LEHTËSIMI I PUNËSIMIT TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA. Ne do ta lehtësojmë punësimin e personave me aftësi të kufizuara, duke subvencionuar pagat e tyre dhe financiar plotësisht teknologjinë e nevojshme për t'i siguruar që ata të mund t'i ushtrojnë detyrat e tyre në mënyrë të barabartë dhe efektive. Me këto masa, ne synojmë të krijojmë një mjedis pune gjithëpërfshirës, ku çdo qytetar të ketë mundësi të barabarta për të kontribuar dhe për të ndërtuar një karrierë të suksesshme.

4 NJË JETË ME DINJITET PËR ÇDO FAMILJE



PDK

4. NJË JETË ME DINJITET PËR ÇDO FAMILJE



VEPRIMET E PROPOZUARA

1. DINJITET DHE STABILITET PËR PUNONJËSIT E SEKTORIT PUBLIK.

Paga do të rritet 50 % për të gjitha kategoritë e sektorit publik, duke përfshirë mësimdhënësit, mjekët, infermierët, punonjësit e administratës dhe të gjitha shërbimet publike. Kjo rritje nuk do të jetë e njëjtë për pozitat me emërime politike. Rritja për këto kategori do të jetë 30 %. Rritja e pagave në sektorin publik do ta përmirësojë mirëqenien e punonjësve, ta nxisë motivimin dhe të kontribuojë në një sektor publik më të fuqishëm dhe më të qëndrueshëm.

2. MË SHUMË DINJITET E MIRËNJOHJE PËR TË MOSHUARIT: RITJJA E PENSIONEVE DHE NDIHMAVE SOCIALE.

Do t'i rrisim pensionet për të siguruar një jetë të dinjitetshme për pensionistët tanë. Kjo rritje reflekton përkushtimin tonë për t'i mbështetur ata që kanë kontribuar në shoqërinë tonë, duke u mundësuar të gëzojnë siguri financiare dhe një cilësi më të mirë jetese në vitet e tyre të pensionit.

NË QEVERISJEN TONË:

- Pensioni bazik i moshës do të ngritet në 200 euro.
- Pensionet kontributdhënëse do të rriten për 30 %.

3. NJOHJA E SAKRIFICËS PËR VETERANËT DHE FAMILJET E TYRE.

PDK-ja nderon sakrificat e mëdha të luftëtarëve tanë të lirisë dhe familjeve të tyre, të cilët me guximin dhe përkushtimin e tyre kanë formësuar shtetin tonë. Ne e njohim kontributin e tyre të madh dhe jemi të angazhuar për t'u siguruar atyre dhe familjeve të tyre mbështetjen dhe respektin që meritojnë, si një testament i guximit dhe qëndresës së tyre.

shtimin e tyre kanë formësuar shtetin tonë. Ne e njohim kontributin e tyre të madh dhe jemi të angazhuar për t'u siguruar atyre dhe familjeve të tyre mbështetjen dhe respektin që meritojnë, si një testament i guximit dhe qëndresës së tyre.

NË QEVERISJEN TONË:

- Përfitimet e të gjitha kategorive të luftës, duke përfshirë familjet e dëshmorëve, veteranët dhe invalidët e luftës, do të rriten për 50 %.
- Prindërit e familjeve të dëshmorëve nuk do të duhet të zgjedhin ndërmjet pensionit të moshës dhe pensionit të familjes së dëshmorit, por do t'i përfitojnë të dy llojet e pensioneve.
- Do t'i heqim kufizimet për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përfitues të pensionit të veteranit, që të jenë aktivë në tregun e punës.

4. RITJJA E MBËSHTETJES PËR FAMILJET QË PRANOJNË NDIHMA SOCIALE.

Përmes reformave dhe rritjes së asistencës financiare synojmë t'i përmirësojmë cilësinë e jetesës dhe të krijojmë mundësi për integrim më të plotë ekonomik e social të këtyre familjeve. Në qeverisjen tonë, asistencë financiare për familjet që pranojnë ndihma sociale do të rritet për 50 %.

5. SHËNDET PA SHPENZIME PËR TË MOSHUARIT: BARNA FALAS PËR TË MOSHUARIT ME SËMUNDJE KRONIKE.

Ne do të ofrojmë barna falas për të moshuarit që vuajnë nga sëmundje kronike, duke siguruar që ata të kenë qasje në trajtimet që u nevojiten pa barrë financiare.

6. LEHTËSIM PËR PRINDËRIT: MBULIMI I SHPENZIMEVE PËR ÇERDHE PRIVATE.

Ne do të ofrojmë një subvencion prej 100 eurosh në muaj për familjet që nuk mund t'i regjistrojnë fëmijët e tyre në çerdhet publike dhe që i regjistrojnë ata në çerdhe private, duke siguruar kështu mundësi më të përballueshme dhe të qasshme për kujdesin ndaj fëmijëve. Ky veprim do ta lehtësojë barrën financiare për prindërit, do ta lehtësojë aktivizimin e grave në tregun e punës, si dhe do ta mbështesë zhvillimin e hershëm të fëmijëve në mjediset cilësore të kujdesit.

7. SHËRBIME TË SPECIALIZUARA DHE RITJJE TË SHITESAVE PËR FËMIJËT ME NEVOJA TË VEÇANTA.

Me qëllim të ofrimit të kujdesit të nevojshëm dhe sa më afër shtëpisë për fëmijët me nevoja të veçanta, do të ndërtojmë qendra të qëndrimit ditor falas për këtë kategori të fëmijëve në shtatë qytete të Kosovës. Shërbimi i qëndrimit ditor ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës dhe integrimin më të mirë në shoqëri.

përmes terapisë së specializuar sipas standardeve ndërkombëtare, programeve ushqimore të personalizuara, aktiviteteve zbatimëse dhe orientimit profesional. Për më tepër, ky shërbim synon ta përmirësojë cilësinë e jetës së prindërve në mënyrë që ata ta kenë qetësinë e nevojshme dhe të jenë në gjendje të kontribuojnë në shoqëri sipas profesioneve të tyre. Marrë parasysh nevojat e kushtueshme të kujdesit, përfshirë dietat më të kushtueshme, do t'i rrisim edhe shtesat që shpërndahen për këto kategori të fëmijëve.

8. QENDRA PËR KUJDESIN E TË MOSHUARVE: MBËSHTETJE PËR FAMILJET DHE PËRKUJDESJE PËR TË MOSHUARIT. Një program gjithëpërfshirës që përmirëson cilësinë e jetës së të moshuarve dhe lehtëson barrën e kujdesit për familjet e tyre. Ne do të krijojmë qendra të specializuara për kujdesin e të moshuarve në secilin regjion të Kosovës. Këto qendra do të ofrojnë kujdes mjekësor të specializuar, terapi fizike, aktivitete sociale dhe kulturore, si dhe trajnime për aftësitë jetësore që ndihmojnë të moshuarit ta ruajnë pavarësinë e tyre. Për më tepër, një program mbështetjeje do t'u ofrohet familjeve që kujdesen për të moshuarit në shtëpi, me trajnime dhe resurse për menaxhimin e nevojave të tyre. Një sistem monitorimi do të vendoset për ta garantuar cilësinë dhe efektivitetin e shërbimeve të ofruara, duke kontribuar në një kulturë të re që vlerëson dhe respekton të moshuarit, si dhe forcon solidaritetin social në Kosovë. Përveç sigurimit të një kujdesi profesional e cilësor për qytetarët e moshës së tretë, ky program do të ketë efekt të drejtpërdrejtë në lehtësimin e barrës së grave në familje. Kujdesi për të moshuarit është një ndër angazhimet kryesore të grave dhe ndihma në këtë fushë i çliron ato që të bëjnë një jetë më aktive në shoqëri, duke u aktivizuar në tregun e punës apo duke u angazhuar në aktivitete shkollore, kulturore, sociale dhe politike.

5

**FURNIZIM I SIGURT
DHE I QËNDRUESHËM
ME ENERGJI ELEKTRIKE**



5. FURNIZIM I SIGURT DHE I QËNDRUESHËM ME ENERGI ELEKTRIKE



VEPRIMET E PROPOZUARA

1. FURNIZIM I QËNDRUESHËM ME ENERGI PËR NJË KOSOVË MË TË SIGURT. Kosova ka nevojë për kapacitete të reja energjetike për një furnizim të qëndrueshëm dhe të besueshëm. Prandaj do të investojmë në kapacitetet gjeneruese të reja dhe të përmirësuara për të siguruar një furnizim të qëndrueshëm dhe të besueshëm me energji për çdo familje dhe biznes në Kosovë. Për këtë qëllim, planifikojmë ndërtimin e termocentralit me gaz me një kapacitet prej 350 MW krahas lidhjeve me tubacione me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Po ashtu, do të ndërmerren studime dhe nxiten projekte investimesh për hidrocentrale të reja atje ku janë planifikuar të ndërtohen ujëmbledhës.

2. GAZIFIKIMI I KOSOVËS: NJË HAP I GJELBËR PËR NJË TË ARDHME TË PASTËR DHE TË QËNDRUESHME. PDK-ja propozon një projekt për gazifikimin e Kosovës, që përfshin hartimin e një studimi të hollësishëm për ndërtimin e një rrjeti të shpërndarjes dhe furnizimit me gaz natyror. Ky projekt strategjik do t'i diversifikojë burimet e energjisë dhe do ta përmirësojë infrastrukturën energjetike, duke siguruar një burim më të pastër, të përbalueshëm dhe të qëndrueshëm energjie. Furnizimi me gaz do t'i ulë kostot e jetesës për qytetarët dhe bizneset, pasi gazi natyror është një zgjidhje më e leverdishme për ngrohje dhe gatim. Ky projekt do ta përmirësojë jetën e qytetarëve dhe do t'i shkurtojë shpenzimet operative të bizneseve, duke rritur konkurrencën dhe qëndrueshmërinë

ekonomike të vendit. Studimi do t'i shqyrtojë mundësitë e ndërtimit të rrjetit të furnizimit me gaz natyror dhe do t'i identifikojë rrugët më të përshtatshme për lidhjen me furnizues rajonalë dhe ndërkombëtarë. Ky projekt do të kontribuojë në sigurinë energjetike dhe do ta rrisë aftësinë e Kosovës për t'i përballuar sfidat energjetike të së ardhmes, duke krijuar një bazë të qëndrueshme për zhvillim ekonomik dhe social.

3. NJË DRITARE E RE PËR ENERGINË E RINOVUESHME: AGJENCIA ONE-STOP-SHOP. PDK-ja do të krijojë një agjenci One-Stop-Shop për ta përsheptuar dhe lehtësuar dhënie e lejeve për investitorët privatë dhe qytetarët që dëshirojnë të investojnë në energji të rinovueshme si energjia diellore, hidro, e erës apo gjeotermale. Kjo agjenci do të shërbejë si pika qendrore ku investitorët dhe qytetarët mund t'i kryejnë të gjitha procedurat e nevojshme në një vend të vetëm, duke shmangur burokracitë e tepërta dhe vonesat që deri më tani kanë penguar zhvillimin e sektorit të energjisë së gjelbër në Kosovë. Qëllimi i kësaj agjencie është ta funksionalizojë dhe zvogëlojë sa më shpejt potencialin për energji të rinovueshme të Kosovës, për të mos lejuar që investimet e rëndësishme të zvarriten. Shumë investitorë, pasi kanë pritur për vite me radhë për t'i marrë lejet e nevojshme, janë dorëzuar dhe larguar, duke humbur kështu mundësi të mëdha për vendin. Kjo agjenci do të sigurojë që ky proces të jetë më i shpejtë, më efikas dhe transparent, duke mbështetur investimet në energji të pastër dhe të qëndrueshme. Për më tepër, kjo agjenci do t'u shërbejë edhe qytetarëve që duan të instalojnë panele diellore për shtëpitë, bizneset apo fermat e tyre, duke u ofruar një zgjidhje të lehtë dhe të shpejtë pa u maltretuar nëpër zyrat e ndryshme shtetërore. Të gjitha procedurat, përfshirë kërkesat, verifikimet dhe lëshimin e lejeve, do të realizohen në një sportel të vetëm. Ndërsa, agjencia do të koordinohet me të gjitha institucionet e tjera të përfshira për të siguruar një proces të integruar dhe të qartë. Kjo masë do të ndihmojë në përsheptimin e projekteve për energji të rinovueshme dhe do të kontribuojë në rritjen e sigurisë energjetike dhe qëndrueshmërisë ekonomike të Kosovës.

4. MBËSHTETJE FINANCIARE PËR TA BËRË ENERGINË E PASTËR TË PËRBALLUESHME PËR TË GJITHË. Do të ofrojmë subvencione për teknologjitë e gjelbra si panelet diellore (fotovoltaikë) dhe turbinat me erë. Po ashtu, do ta përkrahim sistemin e shpërndarjes së subvencioneve në mënyrë që ta rrisim shkallën e subvencionit për familjet me të ardhura më të ulëta.

5. NXITJA E INOVACIONEVE PËR EFIÇENCË DHE QËNDRUESHMËRI NË SEKTORIN ENERJETIK. Ne do t'i rrisim investimet në hulumtim dhe zhvillim për ta inkurajuar inova-


cionin dhe për të zhvilluar teknologji të reja që përmirësojnë efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e sektorit tonë energjetik.

6. RRITJA E EFIÇENCËS NË SHFRYTËZIMIN E ENERGJISË PËR TA ULUR KONSUMIN DHE SHPENZIMET. Do të zbatojmë masa për ta përmirësuar efikasitetin e shfrytëzimit të energjisë, si përmirësimi i izolimit të ndërtesave, përdorimi i pajisjeve me efikasitet më të lartë dhe teknologjive të ndriçimit, duke ulur kështu kërkesën për energji dhe shpenzimet për konsumatorët.

7. ZBATIMI I PROJEKTEVE PËR SISTEMET E NGROHJES QENDRORE NË PESË QYTETE TË KOSOVËS. Për ta shkurtuar konsumin e energjisë elektrike dhe për t'u siguruar qytetarëve tanë sisteme ngrohjeje më të besueshme, efikase dhe më të pastra, do ta mbështesim zbatimin e sistemeve të ngrohjes qendrore në Gjilan, Ferizaj, Prizren, Pejë dhe Mitrovicë.

6

NJË QASJE E RE PËR SEKTORIN MINERAR



PDK

6. NJË QASJE E RE PËR SEKTORIN MINERAR



VEPRIMET E PROPOZUARA

1. SEKTORI MINERAR NË FUNKSION TË ZHVILLIMIT EKONOMIK PËRMES DERREGULLIMIT DHE LEHTËSIMIT TË PROCEDUREVE. PDK-ja do të angazhohet për rigjallërimin e sektorit minerar dhe energjetik, duke tërhequr investitorë të huaj seriozë përmes partneriteteve publiko-private. Qëllimi është që burimet natyrore dhe energjetike të shfrytëzohen në mënyrë të qëndrueshme për ta nxitur rritjen ekonomike, krijimin e vendeve të reja të punës dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve të Kosovës. Parimi udhëheqës do të jetë derregullimi dhe lehtësimi i procedurave, me fokus në thjeshtimin e proceseve administrative dhe rregullatore për të krijuar një mjedis më të favorshëm për investime të shpejta dhe efikase. Kjo përfshin përmirësimin e kornizës ligjore dhe rregullative për tërheqjen e kapitalit, duke lehtësuar qasjen e investitorëve në sektorët minerarë dhe energjetikë. Këta dy sektorë të ndërlidhur mund të bëhen motorë të fuqishëm të rritjes ekonomike.

2. HAPJA E SEKTORIT MINERAR PËR INVESTIME PRIVATE.

Trepça dhe KEK-u do të profilizohen në përpunimin e mineraleve, prodhimin e metaleve (Trepça) dhe prodhimin e energjisë elektrike (KEK). Ndërkohë, procesi i nxjerrjes së lëndës së parë minerale do të shkëputet nga këto dy kompani dhe do të ofrohet për investitorë përmes koncesioneve. Kjo qasje krijon mundësi për të thithur investime më të shpejta dhe të bollshme, duke shtuar të ardhurat për vendin dhe duke hapur vende të reja pune.

3. HAPJA E VENDBURIMEVE TË PASHFRYTËZUARA PËR INVESTIME DHE KONCESIONE NË KOSOVË.

PDK-ja synon të hapë për investime dhe koncesione jo vetëm minierat e komplekseve ekzistuese minerare, por edhe vendburimet minerare të pashfrytëzuara më parë. Për shembull, do të ofrojë për koncesion basenet me linjit në Dukagjin dhe Drenicë, përveç baseneve të qendrës së Kosovës. Kjo qasje do të krijojë mundësi për investitorë të interesuar që t'i zhvillojnë këto vendburime të vlefshme, duke sjell përfitime të mëdha ekonomike. E njëjta gjë vlen edhe për vendburimet e studiuara të mineraleve të tjera, të cilat deri tani kanë mbetur jashtë përdorimit. Kështu, investitorët e rinj do ta kenë mundësinë të zhvillojnë burime të reja që nuk kanë qenë më parë pjesë e sektorit të shfrytëzimit, duke sjell përfitime të reja për ekonominë e Kosovës dhe duke hapur më shumë vende pune.

4. KOSOVA SI ZËVENDËSUES I EKSPORTEVE TË QYMYRIT PËR EVROPËN PAS EMBARGOS NDAJ RUSISË.

Kosova ka një mundësi serioze për ta shfrytëzuar situatën aktuale të krijuar nga embargot e Bashkimit Evropian ndaj Rusisë për importin e qymyrit. Në vitin 2021 vendet e BE-së importuan rreth 52 milionë tonë qymyr nga Rusia, një burim që sot është bllokuar për shkak të embargos. Në këtë kontekst, Kosova mund të ofrohet si zëvendësues i besueshëm për këto vende, duke shitur ose këmbyer qymyrin për energji elektrike. Kjo mundësi mund të ndihmojë jo vetëm në zhvillimin e sektorit energjetik të Kosovës, por edhe në përforcimin e marrëdhënieve tregtare me vendet evropiane që janë në kërkim të burimeve të reja të qymyrit pas ndërprerjes së rrugës tradicionale të importimit prej Rusisë.

5. HULUMTIME TË REJA PËR ZHVILLIMIN E SEKTORIT MINERAR NË KOSOVË.

Ne do t'i nxisim hulumtimet e reja gjeologjike dhe minerare, duke marrë parasysh se shumica e hulumtimeve aktuale janë kryer më shumë se gjysmë shekulli më parë. Përparimet në teknologji dhe shkencë sot ofrojnë mundësi për të marrë informacione shumë më të sakta dhe të hollësishme për pasuritë nën tokë. Me teknologji moderne mund të bëhen analiza më të thelluara që mund të sjellin zbulime të reja, të cilat do të ndihmojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit minerar dhe energjetik të Kosovës. Këto hulumtime të reja janë thelbësore për të siguruar një bazë të saktë dhe të qëndrueshme për zhvillimin e resurseve të vendit. Një valë e re hulumtimesh do ta krijonte bazën për zhvillimin e mëtejshëm të industrisë minerare të Kosovës dhe do të tërhiqte investime të reja, duke rritur kapacitetet prodhuese të vendit. Rivlerësimi i këtyre burimeve strategjike mund ta hapë rrugën për një zhvillim më të madh industrial,

duke gjeneruar vende të reja pune, duke shtuar të ardhurat për shtetin dhe duke kontribuar në stabilitetin ekonomik afatgjatë të Kosovës.

6. KRIJIMI I AGJENCISË “ONE-STOP-SHOP” PËR SEKTORIN MINERAR. Do të ndërmerim reforma të thella në bazën ligjore të sektorit minerar dhe energjetik përmes një procesi të derregullimit, duke thjeshtuar dhe lehtësuar ndjeshëm investimet në këto fusha. Një ndër hapat kryesorë të kësaj reforme është krijimi i një agjencie moderne dhe efikase, ku të gjitha shërbimet për licencimin dhe procedurat e nevojshme për shfrytëzimin e minierave dhe burimeve energjetike do të kryhen në një sportel të vetëm. Ky sistem “One-Stop-Shop” me qeverisje elektronike do ta eliminojë nevojën për kalimin nga një institucion në tjetrin, duke u mundësuar investitorëve privatë, bizneseve dhe qytetarëve, që t’i përmbushin të gjitha burokracitë në një proces të unifikuar dhe të shpejtë.

7. RRRITJA E KAPACITETEVE NJERËZORE DHE INSTITUCIONALE NË SEKTORIN MINERAR DHE TË ENERGISË. PDK-ja synon t’i zhvillojë kapacitetet njerëzore dhe institucionale në sektorët minerarë dhe energjetikë përmes forcimit të institucioneve edukative dhe shkencore, për t’i përmbushur kërkesat e tregut dhe standardet ndërkombëtare. Për këtë, do të shtohen bursat dhe mobiliteti akademik në këto fusha, si dhe do të nxitet transferimi i teknologjisë përmes partneriteteve ndërkombëtare. Gjithashtu, do të krijohen qendra kërkimore dhe laboratorë të specializuar, duke bashkëpunuar ngushtë me industrinë dhe akademinë për inovacione që rrisin qëndrueshmërinë dhe tërheqin investime në Kosovë.

8. INVESTIMET INFRASTRUKTURE NË MBËSHTETJE TË SEKTORËVE MINERARË DHE ENERGETIKË NË KOSOVË. PDK do të investojë në infrastrukturë për të lehtësuar zhvillimin e sektorëve minerarë dhe energjetikë, duke përmirësuar rrugët, modernizuar sistemin elektrik dhe rehabilituar hekurudhat për t’i mbështetur këto industri. Këto përmirësime do të sigurojnë qasje më të lehtë dhe efikase për investitorët, duke ulur kostot dhe rritur efikasitetin e operacioneve. Së bashku me një kornizë ligjore dhe fiskale nxitëse, këto masa do të krijojnë një mjedis të përshtatshëm për investime të reja, duke nxitur zhvillimin e burimeve natyrore të Kosovës.

9. ZGJIDHJA E PROBLEMEVE MJEDISORE NË SEKTORIN MINERAR. PDK-ja do të angazhohet për menaxhimin e ndikimeve mjedisore nga aktivitetet minerare, veçanërisht në zonat e prekura nga shfrytëzimi i linjitet dhe aktivitetet e Trepçës. Kjo përfshin adresimin e ndotjeve toksike, emetimeve të pluhurit dhe mbetjeve të pakontrolluara që dëmtojnë shoqërinë dhe ambientin. PDK-ja do të punojë me donatorët ndërkombëtarë për të zbatuar masa konkrete për eliminimin e ndotjeve dhe rehabilitimin e këtyre zonave. Një prioritet do të jetë modernizimi dhe implementimi i teknologjive të reja për menaxhimin mjedisor, duke huazuar praktikatat më të mira për qëllime për rehabilitimin e minierave të braktisura. Këta hapa do të sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm për sektorin minerar dhe energjetik, duke mbrojtur mjedisin dhe komunitetet lokale

7 BUJQËSI E ZHVILLUAR DHE INOVATIVE



PDK

7. BUJQËSI E ZHVILLUAR DHE INOVATIVE



VEPRIMET E PROPOZUARA

1. FUQIZIMI I FERMERËVE PËRMES ZGJERIMIT TË SUBVENCIONEVE, GRANTEVE DHE PËRMIRËSIMIT TË QASJES NË FINANCA. Zgjerimi i skemave të subvencioneve dhe granteve, të shoqëruara me masat për lehtësira në qasjen në kredi më të favorshme, do të sigurojë më shumë burime financiare për fermerët që duan të investojnë në teknologji të avancuar, makineri moderne dhe infrastrukturë të nevojshme për bujqësi intensive. Përdorimi i pajisjeve të automatizuara dhe infrastrukturës moderne do t'i ndihmojë fermerët për shkurtrimin e kostove të prodhimit dhe për ofrimin e produkteve me çmime dhe cilësi më konkurruese në tregjet lokale dhe ndërkombëtare.

2. DIGJITALIZIMI I PROCEDURAVE TË APLIKIMIT DHE MONITORIMIT PËR SUBVENCIONET DHE GRANTET.

Do të zbatohet një proces të transformimit digjital për t'i thjeshtuar procedurat e aplikimit dhe për ta bërë më të lehtë procedurën e aplikimit të fermerëve për subvencione dhe grante. Do të krijohet një sistem të përshtatshëm të subvencioneve, i orientuar kah rritja e sasisë dhe cilësisë së prodhimit, që do t'i ndihmojë më shumë fermerët të investojnë në aktivitetet e tyre bujqësore dhe të krijojnë lidhje më të qëndrueshme me tregun. Për më tepër, do t'i forcojmë mekanizmat e monitorimit të granteve, duke përfshirë subjekte private monitoruese, për të siguruar që grantet të përdoren sipas kritereve të përcaktuara dhe ta mbrojnë paratë publike nga shpërdorimi.

3. PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS MBËSHTETËSE PËR BUJQËSI TË ZHVILLUAR. Masat për përmirësimin e kapaciteteve të ujitjes do të përfshijnë rindërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së vjetër të ujitjes për të siguruar një shpërndarje efektive të ujitjes, ndërtimin e pendëve, rezervuarëve, kanaleve dhe tubacioneve të reja, si dhe përdorimin e sensorëve për ta monitoruar lagështinë e tokës dhe kushtet klimatike. Për më tepër, do ta përmirësojmë rrjetin e rrugëve që lidhin fermat me tregjet, si dhe do ta mbështesim rritjen e kapaciteteve për ruajtje të produkteve bujqësore në të gjitha zonat e vendit.

4. NDËRTIMI I KANALIT TË LEPECIT: UJË PËR ZHVILLIM DHE SIGURI. Projekti më i madh për rritjen e kapaciteteve të sistemeve të ujitjes, por edhe të furnizimit me ujë të pijshëm, do të jetë ndërtimi i Kanalit të Lepencit dhe digave të Firajës dhe të Shtimes. Furnizimi me ujë nga ky projekt i madh infrastrukturor do të shpërndahet përmes dy kanaleve. Kanali i parë do të shtrihet nga Shtimja në Ferizaj, Viti e deri në Gjilan. Kanali i dytë do të shtrihet nga Shtimja në drejtim të Graçanicës, në Prishtinë e deri në Obiliq.

5. TOKA E SHËNDETSHME PËR PRODHIM TË SHËNDETSHËM: PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË TOKËS. Përdorimi i teknikave që ruajnë dhe përmirësojnë pjellorinë e tokës, si analizat e rregullta të tokës, përdorimi i plehrave organike, aplikimi i plehrave kimike dhe pesticideve në mënyrë të kontrolluar, do të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë së tokës dhe të prodhimeve. Implementimi i praktikave që ndihmojnë në parandalimin e erozionit të tokës dhe realizimi i projekteve të konsolidimit të tokës do të krijojnë parcela më të mëdha dhe më të integruara, duke lehtësuar menaxhimin dhe përdorimin më efikas të tokës. Ndërtimi i infrastrukturës për menaxhimin e tokës, përfshirë rrugët e qasshme, kanalet e ujitjes, kullimin, rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe sistemet e drenazhit, do të ofrojë mbështetje për fermerët që angazhohen në projekte të rregullimit dhe konsolidimit të tokës.

6. RITJIA E PRODUKTIVITETIT: TRAJNIME PËR PRAKTIKA TË AVANCUARA BUJQËSORE. Ofrimi i trajnimeve profesionale për fermerët në teknologji të reja, menaxhim efikas të fermave dhe teknika të avancuara bujqësore do të ndihmojë në përmirësimin e praktikave dhe produktivitetit të tyre. Përfshirja më e madhe e sektorit privat dhe sigurimi i mbështetjes nga ekspertët meritorë për zgjidhjen e problemeve dhe

përmirësimin e praktikave bujqësore do të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit.

7. NGA FERMA NË TREG: SHTIM I VLERËS SË PRODUKTEVE PËRMES PËRPUNIMIT. PDK-ja do të zbatojë një program mbështetjeje për rritjen e kapaciteteve të përpunimit të produkteve bujqësore, duke ofruar shërbime këshillimi për zhvillimin e biznesit dhe realizimin e kërkimeve të tregut për t'i identifikuar mundësitë. Iniciativa do të përfshijë edhe ndihmë financiare për investime në teknologji dhe pajisje të avancuara. Qëllimi është zvogëlimi i varësisë nga importet e mallrave të përpunuara dhe krijimi i vlerës lokale nga produktet bujqësore. PDK-ja do ta mbështesë përpunimin e produkteve të ndryshme, përfshirë mishin dhe qumështin, duke përmirësuar cilësinë dhe konkurrencën në tregun vendor dhe ndërkombëtar. Rritja e kapaciteteve përpunuese do ta forcojë ekonominë bujqësore dhe do të krijojë vende të reja pune në zonat rurale, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e fermerëve.

8. MBËSHTETJE PËR STANDARDE NDËRKOMBËTARE QË RRISIN MUNDËSITË E EKSPORTIT TË PRODUKTEVE BUJQËSORE. Ne do ta mbështesim forcimin e Institutit Bujqësor në bashkëpunim edhe me qendrat e tjera shkencore universitare për t'i përmbushur standardet e cilësisë dhe për t'i zhvilluar kapacitetet e nevojshme për të fituar akreditim ndërkombëtar. Ky përmirësim do të sigurojë që certifikatat e kontrolleve të jenë të njohura ndërkombëtarisht, duke garantuar produkte më cilësore dhe duke rritur mundësitë tona për eksport.

9. MASA MBROJTËSE DHE PRODUKTE SIGURIMI QË MBËSHTESIN FERMERËT PËR PËRBALLIMIN E NDRYSHIMEVE KLIMATIKE. Për shkak të ndryshimeve klimatike, fermerët po përballen me sfida për t'i menaxhuar dëmet në produktet e tyre bujqësore. Ne do t'i ndihmojmë ata të mbrohen më mirë nga humbjet, duke i dhënë përparësi ndërtimit të sistemeve që bazohen në masa parandaluese, përfshirë edhe pajisje teknologjike, në raport me ndihmat ad-hoc që jepen pas dëmeve. Në këtë drejtim do të ofrojmë mbështetje edhe për sigurimin e qasjes së fermerëve në produkte të sigurimit bujqësor me mbulueshmëri të gjerë, me kosto të përballueshme, duke u mbështetur nga shteti.

10. ZGJERIMI DHE MODERNIZIMI I INFRASTRUKTURËS SË POSAÇME BUJQËSORE. Për të rigjeneruar e konsoliduar bujqësinë, PDK-ja do të mundësojë investime infrastrukturore që kanë për qëllim nxitjen, ruajtjen, ambalazhimin e produkteve bujqësore, duke e lehtësuar tregtinë dhe mundësuar sa më shumë të ardhura për fermerët. Në këtë kuadër, nëpërmjet partneritetit privat-publik, do të ndërtojmë qendra të grumbullimit dhe distribuimit të produkteve bujqësore, blegtorale, bimëve mjekësore e frutave të malit, me frigoriferë të specializuar për mirëmbajtje. Përmes ndërtimit të infrastrukturës së kompletuar të grumbullimit, konservimit e paketim-

it, produktet bujqësore e blegtorale të fermerëve të Kosovës marrin vlerë tjetër dhe rrisin fitimet për popullsinë rurale. Në këtë mënyrë ndihmohen fermerët për të ofruar produkte të cilësisë së lartë dhe për të konkurruar në tregjet lokale dhe ndërkombëtare.

11. KONSOLIDIMI I TOKAVE BUJQËSORE. Fragmentimi i tokës është një pengesë e madhe për zhvillimin e bujqësisë intensive dhe për zbatimin e teknikave moderne të prodhimit. Për këtë arsye, do të angazhohemi për konsolidimin e tokës bujqësore, duke propozuar një ligj për partneritetet bujqësore që do ta stimulojë bashkimin e parcelave të tokës dhe ndërtimin e fermave më të mëdha. Gjithashtu, synojmë të krijojmë një treg të rregullt të tokës bujqësore në Kosovë, duke përmirësuar bazën ligjore për shitblerje dhe qiradhënie.


12. NXITJA E BUJQËSISË ORGANIKE. Në tregjet ndërkombëtare po rritet vullshëm kërkesa për produkte organike dhe, po ashtu, ndjeshmëria ndaj mbrojtjes së mjedisit ka bërë që të ekzistojnë mundësi për grante dhe kredi me kushte të favorshme nga institucionet financiare ndërkombëtare për ta mbështetur bujqësinë organike. Ne do t'i mbështesim fermerët për të aplikuar dhe përfituar nga këto fonde, për ta nxitur zhvillimin e këtij sektori të rëndësishëm për ekonominë, turizmin dhe mjedisin. Njëherësh, nxitja e bujqësisë organike do të mundësojë edhe ushqime më të freskëta e cilësore për banorët e Kosovës, duke ndikuar drejtpërdrejtë në shëndetin publik.

13. STIMULIMI DREJT PEMËTARISË. Një nga prioritetet kryesore për periudhën e ardhshme do të jetë zgjerimi i sektorëve të pemëtarisë dhe vreshtarisë. Synimi ynë është t'i rrisim sipërfaqet e kultivuara me pemë si mollë, dardhë, qershi, vishnje, kajsi, pjeshkë, kumbulla, rrush, manaferra, dudë dhe dredhëza. Një fokus i veçantë do t'i kushtohet kultivimit të arrorëve, pasi kjo kategori është gjithnjë e më e kërkuar në tregjet rajonale dhe ato të Bashkimit Evropian. Konkretisht do të nxitet mbjellja dhe kultivimi i lajthive, arrave, bajameve e gështenjave, të cilat po gëzojnë një rritje domethënëse çmimesh në tregjet ndërkombëtare vitet e fundit. Zgjerimi i sipërfaqeve me pemishte do të luajë rol të rëndësishëm në rritjen e industrisë përpunuese ushqimore dhe në krijimin e mundësive të reja për punësim, pasi këto kultura kërkojnë një krah pune të konsiderueshëm. Gjithashtu, ato janë të leverdishme edhe në ngastra apo ara të kufizuara apo të fragmentuara, siç i ka Kosova.

14. VRESHTARIA DHE VERËTARIA. Zhvillimi i vreshtarisë është një prioritet strategjik, me qëllim të përmirësimit të kushteve për vreshtarët dhe rritjes së produktivitetit në këtë sektor. Verëtarja, si produkti përfundimtar i vreshtarisë, përfaqëson një mundësi të madhe për eksport dhe për përmirësimin e pozicionit të Kosovës në tregjet ndërkombëtare. Përmes Institutit Bujqësor ne do ta nxisim bashkëpunimin

me ekspertë të huaj enologë, të cilët do të ofrojnë këshillim dhe mentorim për prodhuesit e verës në Kosovë. Gjithashtu, në kuadër të programit të bursave, do të japim bursa për studime në enologji, me qëllim të krijimit të kadrove vendase për prodhimin e verës.

15. NJË HOV I RI PËR BLEGTORINË. Blegtorinë është një ndër traditat më të pasura dhe të hershme të popullit tonë, prandaj nxitja dhe zhvillimi i blegtorisë do të jetë një prioritet i rëndësishëm për të ardhmen. Tradicionalisht, familjet në zonat rurale janë të përfshira në blegtori, një sektor që ka potencial të madh për zhvillim dhe, po ashtu, Kosova është e pasur me kullota, që do të thotë se ka potencial të madh për bagëti të imët. Ne do të angazhohemi për rritjen graduale të subvencioneve për blegtorinë, duke synuar rritjen e numrit të deleve, dhive dhe përmirësimin e sektorit të blegtorisë në përgjithësi. Njëherësh do të mbështeten nismat për përmirësimin e standeve dhe stallave të lopëve për të arritur standarde sa më të larta dhe mundësuar certifikimet që hapin derën për eksporte. Zgjerimi dhe konsolidimi i blegtorisë do të mundësojë jo vetëm pasurimin e zonave rurale dhe nxitjen e industrisë ushqimore, por edhe ofrimin e ushqimeve më të lira e më të mira për qytetarët e Kosovës.



ARSIMI, GATI PËR TË ARDHMEN

PDK

8. ARSIMI, GATI PËR TË ARDHMEN



VEPRIMET E PROPOZUARA PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR

1. PROGRAM KOMBËTAR PËR ZHVILLIMIN NË FËMIJËRINË E HERSHME. PDK-ja është e përkushtuar të zbatojë një program kombëtar gjithëpërfshirës për zhvillimin në fëmijërinë e hershme, duke njohur rëndësinë jetike të arsimit parashkollor për formimin e së ardhmes së fëmijëve tanë. Si pjesë e kësaj nisme, do ta rrisim ndjeshëm numrin e regjistrimeve të fëmijëve në institucionet parashkollore, si dhe do të zgjerojmë kapacitetet e çerdheve për fëmijë. Vëmendje të veçantë do t'i kushtojmë përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parashkollor, duke garantuar qasje të barabartë dhe mundësi për të gjithë fëmijët që të përfitojnë nga arsimi i hershëm, duke promovuar një mjedis gjithëpërfshirës dhe mbështetës që në fillimet e rrugëtimit të tyre arsimor.

2. INVESTIME NË INFRASTRUKTURË, RESURSE NJERËZORE DHE PROGRAME EDUKATIVE. PDK-ja do të ndër marrë një nismë të madhe për ndërtimin e çerdheve të reja në të gjitha rajonet, për të garantuar qasje të barabartë në edukim parashkollor për të gjithë fëmijët. Ne do të investojmë në infrastrukturë, resurse njerëzore dhe programe edukative, duke siguruar që çerdhet të jenë të pajisura me mjetet dhe stafin e duhur për një edukim cilësor. PDK-ja do të sigurojë lokacionet për ndërtimin e këtyre institucioneve, duke hapur një linjë të veçantë buxhetore për shpronësimin e tokave të nevojshme. Prioriteti ynë do të jetë ndërtimi i çerdheve të reja, fillimisht

në zonat ku aktualisht nuk ekziston asnjë strukturë parashkollore, duke mundësuar qasje më të lehtë për fëmijët dhe familjet që jetojnë në këto zona.

3. MBËSHTETJE FINANCIARE PËR FAMILJET. PDK-ja do të ofrojë mbështetje financiare për familjet, duke ofruar një kupon prej 100 eurosh për çerdhe private për ato familje që nuk kanë mundësi t'i regjistrojnë fëmijët në institucionet publike. Ky bonus financiar do të mbulojë pjesërisht kostot e regjistrimit në çerdhet private, duke i ndihmuar familjet t'i përballojnë shpenzimet e larta të këtyre shërbimeve. Kjo masë do të lehtësojë ndjeshëm barrën financiare të familjeve dhe do të sigurojë një zgjidhje të përkohshme për prindërit që kërkojnë kujdes parashkollor për fëmijët e tyre.

VEPRIMET E PROPOZUARA PËR ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

1. INVESTIME NË INFRASTRUKTURËN SHKOLLORE PËR TË OFRUAR NJË PËRVOJË ARSIMORE HOLISTIKE PËR NXËNËSIT. Ne do t'i japim përparësi ndërtimit të shkollave të reja dhe zgjerimit të atyre ekzistuese për ta akomoduar mësimin gjithëditor, duke siguruar që nxënësit ta marrin kohën e rekomanduar të instruksioneve. Ky investim jo vetëm që do ta lehtësojë mbingarkesën që detyron shkollat të funksionojnë në ndërrime të shumta, por do të sigurojë një mjedis më të përshtatshëm për nxënësit, ku ata mund të angazhohen plotësisht me kurrikulën. Plani ynë përfshin përmirësimin e faciliteteve ekzistuese me ambiente moderne si laboratorë shkencorë, biblioteka dhe zona rekreative, duke siguruar që nxënësit të kenë qasje në një përvojë arsimore holistike. Ky zgjerim do të krijojë hapësira shtesë për aktivitete jashtëshkollore, duke i lejuar nxënësit t'i eksplorojnë interesat përtej klasës, gjë që është jetike për zhvillimin e tyre të përgjithshëm.

2. ARSIM CILËSOR, SHKOLLA TË SIGURTA DHE TË SHËNDETSHME. Kalimi në një sistem shkollor gjithëditor dhe ofrimi i aktiviteteve jashtëshkollore do të ofrojë mbështetje gjithëpërfshirëse për nxënësit gjatë gjithë ditës. Përmes rishqyrtimit, kurrikulat dhe teksteve shkollore do të jenë në përputhje me sfidat e sotme në arsim. Ndërsa, ofrimi i sigurisë së nxënësve është një prioritet, veçanërisht përballë niveleve gjithnjë në rritje të dukurive negative, si dhuna, bullizmi, abuzimi, konsumi i duhanit, alkoolit dhe narkotikëve. PDK-ja do të angazhohet për zbatimin e programeve kundër këtyre dukurive negative, sipas praktikave më të mira të BE-së, duke përfshirë trajnime për mësuesit dhe fushata ndërgjegjësimi. Çdo shkollë do të ketë shërbime profesionale, duke përfshirë

pedagog, psikolog, sociolog dhe zyrtar të sigurisë të trajnuar për t'i parandaluar dhe trajtuar aktivitetet e lidhura me dhunën. Aktivitetet mësimore pas shkollës, përfshirë sportin, artin dhe mentorimin, do të mbështeten në partneritet me sektorin privat, ndërsa programe shkollë gjithëditore do të nisnin në shkolla të përzgjedhura për ta rritur produktivitetin. Rishikimi i kurrikulave kombëtare dhe teksteve shkollë do të përshpejtohet, duke siguruar që ato të jenë të përputhshme me të ardhmen në arsim dhe të përfshijnë materiale digjitale për ta përmirësuar cilësinë e arsimit.

3. AVANCIMI I ARSIMIT PROFESIONAL PËR T'I RRIUR MUNDËSITË E PUNËSIMIT TË TË RINJVE. Ne do të punojmë për akreditimin e programeve profesionale, duke ofruar rrugë alternative që përputhen me aftësitë dhe interesat e nxënësve dhe duke adresuar pabarazitë socio-ekonomike në arsim. Duke akredituar këto programe, ne do të sigurojmë që kualifikimet profesionale të jenë të njohura për kompanitë vendore dhe ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, duke udhënë nxënësve një avantazh konkurrues në tregun e punës. Qasja jonë përfshin zhvillimin e partneriteteve me industrinë për të krijuar mundësi të praktikave, duke lejuar nxënësit të fitojnë përvojë praktike deri sa ndjekin mësimin. Kjo qasje praktike do t'i pajisë nxënësit me aftësitë e nevojshme për të përparuar në tregun e punës, duke bërë arsimin profesional një alternativë të respektuar ndaj rrugëve tradicionale akademike. Nxënësit që do të ndjekin drejtime të shkollimit profesional do të mund të përfitojnë nga Fondi i Bursave.

4. AVANCIMI I KURRIKULËS DHE PËRFSHIRJA E MATERIALEVE MËSIMORE DIGJITALE. Ne do ta përshpejtojmë miratimin dhe zbatimin e ligjit për tekstet shkollë, duke siguruar që tekstet të jenë në përputhje me kurrikulën dhe të përfshijnë materiale digjitale për ta përmirësuar cilësinë e arsimit. Kjo do të përfshijë dispozita për tekstet shkollë digjitale me një skemë pune, përkthimin, përshtatjen e teksteve të huaja dhe zhvillimin e një pakete edukative për nivelin parafilior. Këto tekste shkollë digjitale do të jenë interaktive dhe lehtësisht të përditësueshme, duke lejuar një përvojë të mësuarit dinamik që ndjek standardet globale arsimore. Për më tepër, materialet e vlerësimit në tekstet shkollë do të jenë të përputhura me testin e Maturës për t'i përgatitur më mirë nxënësit për këtë provim kritik. Kjo përputhje do të sigurojë që nxënësit të vlerësohen në mënyrë të qëndrueshme, duke pasqyruar mirëkuptimin e tyre të vërtetë dhe gatishmërinë për arsim të lartë ose për tregun e punës.

5. TRANSFORMIMI DIGJITAL NË ARSIM PËR MODERNIZIMIN E MJEDISIT MËSIMOR DHE NXITJEN E PËRDORIMIT TË TEKNOLOGJIVE EDUKATIVE. Ne do t'i implementojmë iniciativat e digjitalizimit, duke përfshirë sigurimin e laptopëve për nxënësit dhe mësuesit, integrimin e këtyre pajisjeve me Microsoft Office 365, vendosjen e Smart Boards në klasa dhe implementimin e një Sistemi të Menaxhimit të Mësimin (LMS) në çdo shkollë për ta modernizuar sistemin arsimor. Këto mjete do t'i fuqizojnë nxënësit dhe mësuesit për

t'i përdorur teknologjitë më të fundit arsimore, duke nxitur një mjedis të mësuarit interaktiv dhe angazhues. Me Smart Boards, mësimet mund të jenë më dinamike dhe vizualisht stimuluese, ndërsa LMS do të lejojë rrugë të personalizuar të mësuarit, ku nxënësit mund të përparojnë me ritmin e tyre. Ne do të sigurojmë edhe integrimin e inteligjencës artificiale, asistentëve të mësuarit dhe mësimdhënies për ta mbështetur mësimin adaptiv dhe për të ofruar përvoja të personalizuar edukative. Gjithashtu, do të sigurohemi që të gjitha përmbajtjet edukative të jenë të qasshme në internet, duke lejuar nxënësit të vazhdojnë të mësojnë jashtë klasës dhe ta kapërcejnë hendekun digjital që aktualisht pengon përparimin edukativ në Kosovë.

6. STRUKTURIMI I TRAJNIMEVE DHE AVANCIMIT NË KARRIERË PËR MËSIMDHËNËSIT. Ne do të krijojmë një sistem të strukturuar për trajnimin, avancimin dhe vlerësimin e mësuesve, me qëllim përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe arritjeve të nxënësve. Për këtë, do të ndërtojmë Qendrën Kombëtare për Trajnime të Vazhdueshme për Mësuesit, që do të ofrojë programe të avancuara për zhvillimin profesional të mësuesve dhe drejtuesve të shkollave, me fokus në didaktikë, teknologji edukative dhe metodologji moderne. Plani ynë do të përfshijë punëtoritë të rregullta për zhvillimin profesional që trajtojnë metodat moderne të mësimdhënies, menaxhimin e klasës dhe integrimin e teknologjisë. Gjithashtu, do të prezantojmë mjete të bazuara në Inteligjencën Artificiale për t'i ndihmuar mësuesit për përcjelljen e përparimit të nxënësve dhe personalizimin e mësimave sipas nevojave të tyre individuale. Mekanizmat e monitorimit do të vendosen për ta siguruar zbatimin efektiv të objektivave të trajnimit.

7. ZHVILLIMI I TREGUESVE TË PERFORMANCËS PËR MËSIMDHËNËSIT ME QËLLIM TË KRIJIMIT TË NJË SISTEMI TRANSPARENT DHE TË PËRGJEGJSHËM NË ARSIM. Ne do të zhvillojmë tregues të qartë për performancën e mësimdhënësve, duke përfshirë përgatitjen e kurrikulës, përdorimin e LMS-së, menaxhimin e klasës dhe do t'i matim ato sistematikisht për t'i identifikuar fushat për përmirësim dhe për të nxitur ndërhyrje të synuara. Këta tregues do të përdoren për të krijuar një sistem arsimor transparent dhe të përgjegjshëm, ku mësuesit dhe nxënësit mbështeten për të arritur më të mirën e tyre. Vlerësime të rregullta do të kryhen për ta monitoruar përparimin dhe vendimet e bazuara në të dhëna do të merren për ta adresuar çdo hendek në sistem. Kjo do të përfshijë mekanizma të feedback-ut ku nxënësit, mësuesit dhe prindërit mund t'i japin përshtypjet mbi praktikën arsimore, duke siguruar që sistemi të mbetet i përgjegjshëm ndaj nevojave të të gjithë akterëve.

8. ZHVILLIMI DHE FUQIZIMI I ZYRAVE TË ORIENTIMIT PËR KARRIERËN E NXËNËSVE NË SHKOLLË. Ne do t'i inkurajojmë dhe udhëzojmë në mënyrë aktive nxënësit drejt arsimit të mëtejshëm ose alternativave të përshtatshme, duke i ndihmuar ata të marrin vendime të informuara për të ardhmen e tyre. Shkollat tona do të ofrojnë shërbime të plota

këshillimi për karrierën që ndihmojnë nxënësit t'i kuptojnë pikat e tyre të forta, interesat e tyre dhe të eksplorojnë një gamë të gjerë mundësish arsimore dhe profesionale. Ky udhëzim do të sigurojë që nxënësit të jenë të vetëdijshëm për të gjitha rrugët e mundshme, qoftë arsim i lartë, trajnim profesional apo hyrje në tregun e punës. Gjithashtu, do të krijojmë partneritete me universitete dhe punëdhënës për të krijuar rrugë të qarta nga arsimit i mesëm në arsim të mëtejshëm ose punësim, duke siguruar që nxënësit të jenë mirë të përgatitur për hapat e ardhshëm në jetën e tyre. Për më tepër, do t'i hapim dyert dhe do t'i sponsorizojmë institucionet e njohura ndërkombëtare, të njohura si Akseleratorë (përshpejtues) të Startup-eve për t'u angazhuar me studentët tanë, duke nxitur inovacionin dhe ndërmarrësinë që në moshë të re.

9. STRUKTURË AKADEMIKE ME TRE SEMESTRA NË VIT DHE PUSHIME TË RREGULLTA PËR NXËNËSIT. Ne do të kalojmë në një strukturë akademike me tre semestra në vit me pushime të rregullta, duke përmirësuar mirëqenien e nxënësve, performancën akademike dhe siguruar periudha pushimi të nevojshme. Kjo strukturë, me pushime të mesme, do ta parandalojë mbingarkesën e nxënësve dhe do ta lejojë përqendrimin më të qëndrueshëm akademik gjatë periudhave të semestrit. Pushimet e rregullta, po ashtu, do të ofrojnë mundësi për aktivitete jashtëshkollore, mbështetje përmirësuese dhe programe përforcimi, duke siguruar që nxënësit të kthehen në shkollë të çlodhur dhe të gatshëm për të mësuar. Kjo qasje është dëshmuar se përmirëson rezultatet e të nxënësve dhe duke e miratuar atë do ta përshtatim kalendarin tonë akademik me praktikën më të mira të vërejtura në sistemet arsimore me performancë të lartë në nivel global.

VEPRIMET E PROPOZUARA PËR ARSIMIN E LARTË

1. RRRITJA E FINANCIMIT TË UNIVERSITETEVE PËR INFRASTRUKTURË MODERNE DHE PERFORMANCË MË TË MIRË. Edhe pse buxheti i Kosovës ka shënuar rritje, universitetet publike vazhdojnë të përballen me buxhete të pamjaftueshme për t'i përmbushur nevojat e tyre thelbësore. Ne do të ndërmarrim masa për të siguruar rritje të financimit, duke theksuar edhe financimin e bazuar në performancë dhe duke garantuar një shpërndarje të drejtë dhe efektive të fondeve. Do ta sigurojmë kornizën e përshtatshme ligjore, e cila mundëson që buxhetimi dhe menaxhimi përkatës për Institucionet e Arsimit të Lartë të bëhet bazuar në praktikën/modelet më të mira. Kjo do t'i ndihmojë universitetet të zhvillojnë infrastrukturë moderne, ta përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies dhe t'i rrisin kapacitetet kërkimore. Investimet në laboratorë modernë, biblioteka digjitale dhe hapësira interaktive për mësimdhënie dhe mësimnxënie janë thelbësore për përgatitjen e studentëve për tregun e punës. Digjitalizimi i mësimdhënies dhe i administratës akademike do ta përmirësojë qasjen në burime dhe efikasitetin e procesit të mësimdhënies.

Indikatorët e performancës, si suksesi akademik, publikimet shkencore dhe bashkëpunimet ndërkombëtare, do të jenë ndër kriteret kryesore për shpërndarjen e fondeve, duke u bazuar në një diskutim të hapur me të gjithë akterët përkatës. Njëpërmjet këtyre investimeve do t'i ndërtojmë universitetet si qendra të cilësisë dhe inovacionit, duke garantuar një të ardhme më të ndritur për vendin tonë. Do t'i mbështesim universitetet edhe në përpjekjet e tyre për të gjeneruar të ardhura vetjake, duke krijuar kornizë të përshtatshme që universitetet të themelojnë ente legale (institute, qendra), të cilat do të sigurojnë më shumë dinamizëm në raportet me tregun e punës dhe nevojat e shoqërisë në përgjithësi.

2. PROGRAME DUALE TË STUDIMIT QË INTEGROJNË TË MËSUARIT AKADEMIK ME PËRVOJËN PRAKTIKE. Ne do t'i japim përparësi krijimit të programeve duale të studimit që integrojnë të mësuarit akademik me përvojën praktike në vendin e punës. Këto programe do të jenë të fokusuar veçanërisht në sektorë si ICT dhe prodhim. Duke bashkëpunuar me liderët e industrisë, universitetet do të jenë në gjendje t'u ofrojnë studentëve përvojë praktike, duke i bërë ata më të punësueshëm dhe më të përgatitur për të kontribuar në ekonomi menjëherë pas diplomimit. Kjo qasje jo vetëm që do ta përmirësojë punësimin e të diplomuarve, por do ta forcojë edhe lidhjen midis arsimit dhe industrisë, duke siguruar që programet akademike të jenë të përgjegjshme për nevojat e tregut të punës. Ne do ta respektojmë pavarësinë akademike të universiteteve, por edhe do të përfshijmë stimuj për ta inkurajuar miratimin e këtyre programeve, duke përfshirë bashkëpunimin me Akseleratorët Ndërkombëtarë të Startup-eve për ta nxitur inovacionin dhe ndërmarrësinë te studentët.

3. HARMONIZIM I VAZHDUESHËM I PROGRAMEVE UNIVERSITARE ME KËRKESAT E TREGUT TË PUNËS. Ne do të punojmë për të siguruar që programet studimore në Institucione të Arsimit të Lartë në Kosovë të dizajnohen dhe të përditësohen vazhdimisht bazuar në kërkesat e tregut të punës dhe përparësitë strategjike të shtetit. Angazhimet tona në këtë kuadër do të jenë të përqendruara në promovimin dhe forcimin e "Misionit e Tretë" të universiteteve. Kjo do të përfshijë konsultime të rregullta me akterët e industrisë dhe qeverinë për t'i identifikuar trendet dhe boshllëqet e aftësive, duke i mbështetur universitetet që ta përshtatin kurrikulën e tyre në përputhje me rrethanat. Duke përshtatur ofertat akademike me nevojat e tregut, ne mund ta shkurtojmë mospërputhjen e aftësive dhe t'i përmirësojmë perspektivat e punësimit të të diplomuarve. Për më tepër, do të promovojmë programe ndërdisiplinore që kombinojnë aftësitë teknike me aftësitë e buta, si komunikimi dhe zgjidhja e problemeve, për të krijuar të diplomuar të plotë që janë të pajisur për të përparuar në një mjedis pune dinamik. Në këtë kuadër do të promovohen edhe programe trajnimi dhe 'Mësimi gjatë gjithë jetës'. Edhe pse shumica e universiteteve në Kosovë i kanë themeluar bordet këshillëdhënëse industriale, ky bashkëpunim shpesh ka mbetur vetëm formal dhe nuk ka pasqyruar

kërkesat reale të tregut të punës. Ne do të angazhohemi për mbështetje institucionale të këtyre bordeve dhe trupave të tjerë të ngjashëm, duke siguruar që universitetet ta përshtatin ofertën e tyre programore me nevojat e ekonomisë.

4. QENDRA PËR KËRKIM DHE ZHVILLIM PËR TA NXITUR INOVACIONIN. Ne do të krijojmë një kornizë për ta përcaktuar nivelin e duhur të kërkimit për Kosovën, bazuar në potencialin e saj në njohuri, financa dhe zhvillim industrial. Kjo kornizë do ta udhëheqë krijimin e qendrave të Kërkimit dhe Zhvillimit (R&D) që nxisin bashkëpunimin midis universiteteve dhe kompanive. Këto qendra të Kërkimit dhe Zhvillimit (R&D) do ta theksojnë inovacionin në fusha të tilla si Inteligjenca Artificiale (AI), duke siguruar pjesëmarrjen aktive të Kosovës në avancimet e fundit teknologjike. Duke u përqendruar në kërkimet e aplikuara që adresojnë nevojat e ekonomisë lokale dhe rajonale, Kosova mund të pozicionohet si një qendër për inovacion në Ballkan. Këto qendra R & D do të shërbejnë si inkubatorë për teknologji dhe procese të reja, duke kontribuar në rritjen industriale dhe përmirësimin e konkurrencës së Kosovës në një shkallë globale. Politikatat tona do ta respektojnë pavarësinë kërkimore të universiteteve, duke ofruar stimuj për t'u përqendruar në fushat e kërkimit që mund ta nxisin zhvillimin kombëtar dhe që adresojnë sfidat e identifikuar në dokumentet përkatëse nacionale dhe ato ndërkombëtare.

5. TREGUES TË QARTË TË PERFORMANCËS DHE INSTRUMENTE MATËSE PËR TA RRIUR CILËSINË E ARSIMIT DHE TRANSPARENCËN NË UNIVERSITETET E KOSOVËS. Për të arritur nivele më të larta të cilësisë, ne do të prezantojmë tregues të qartë të performancës dhe instrumente matëse për universitetet në Kosovë. Këta tregues do të mbulojnë fusha kyçe si rezultatet edukative, produktiviteti kërkimor, performanca e stafit akademik dhe kënaqësia e studentëve. Duke vlerësuar sistematikisht këto metrika, universitetet mund të identifikojnë fusha për përmirësim dhe të zbatojnë strategji të synuara për ta përmirësuar cilësinë e arsimit. Kjo qasje e bazuar në të dhëna do ta rrisë transparencën dhe përgjegjshmërinë, duke siguruar që universitetet të japin vlerë për studentët dhe shoqërinë në tërësi. Në këtë mënyrë, do ta respektojmë pavarësinë akademike të universiteteve, duke ofruar mbështetje dhe stimuj për t'i zbatuar këto masa të performancës në mënyrë efektive.

6. PROMOVIMI I NDËRKOMBËTARIZIMIT TË ARSIMIT TË LARTË. Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë është një hap i rëndësishëm për rritjen e konkurrencës së universiteteve. Universitetet duhet të ndjekin programe të bashkëpunimit ndërkombëtar përmes projekteve të përbashkëta shkencore, shkëmbimeve akademike dhe programeve si Erasmus+. Përmes mbështetjes financiare dhe politikave nxitëse, do ta mbështesim personelin akademik dhe studentët e doktoratës që të marrin pjesë aktivisht në projekte kërkimore ndërkombëtare, sidomos me universitete të renditura në top 500, që

kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit. Kjo do të ndihmojë në zhvillimin e aftësive të studentëve e stafit dhe do ta rrisë prestigjin e institucioneve të arsimit të lartë.

7. FUQIZIMI I QENDRAVE TË ORIENTIMIT NË KARRIERË NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË. Krijimi i qendrave të karrierës në institucionet e arsimit të lartë do t'i ndihmonte studentët për orientimin drejt mundësive të punës dhe praktikave. Për ta siguruar funksionimin e suksesshëm të qendrave të karrierës, do ta inkurajojmë punësimin e specialistëve të karrierës dhe këshilltarëve të trajnuar profesionalisht dhe do të krijojmë mekanizma për monitorimin dhe vlerësimin e performancës së këtyre qendrave, duke përdorur indikatorë të matshëm, si shkalla e punësimit e të diplomuarve dhe numri i praktikave të ofruara.

8. FONDI SHTETËROR I BURSAVE. Për ta përmirësuar cilësinë e burimeve njerëzore dhe për të garantuar zhvillimin e një fuqie punëtore konkurruese ndërkombëtarisht, do të krijojmë një fond bursash për mandatin e ardhshëm qeverisës. Ky fond, i cili do të administrohet nga një trup i pavarur, do t'u ofrojë studentëve tanë mundësi që të ndjekin studime në universitete brenda dhe jashtë vendit, ku përparësi do të kenë degët që konsiderohen si më deficitare dhe prioritare në Kosovë. Duke siguruar bursa për studentët e talentuar, Kosova do të përfitojë nga njohuritë dhe aftësitë e reja që do të sjellin, duke forcuar kështu bazën e saj ekonomike dhe sociale. Kjo do të krijojë mundësi për rritje dhe zhvillim në sektorët strategjikë dhe do ta forcojë pozitën konkurruese të Kosovës në tregun global.


9

SHËNDETËSI ME PACIENTIN NË QENDËR



PDK

9. SHËNDETËSI ME PACIENTIN NË QENDËR



VEPRIMET E PROPOZUARA PËR SISTEMIN SHËNDETËSOR

1. FUQIZIMI I SPITALEVE RAJONALE. Ne do të përqendrohemi me investime në infrastrukturën dhe pajisjet e spitaleve rajonale për të garantuar që këto institucione të ofrojnë shërbime të nivelit të lartë. Do të krijojmë një plan për të angazhuar përkohësisht mjekë të specializuar nga ShSKUK në spitalet rajonale. Me këtë synojmë ta rrisim cilësinë e shërbimeve, ta përmirësojmë bashkëpunimin dhe trajnimet për mjekët, t'i shkurtojmë listat e pritjes dhe t'i shfrytëzojmë më mirë kapacitetet ekzistuese në spitalet rajonale.

2. RRRITJA E NIVELIT TË PËRGJITHSHËM TË CILËSISË SË SHËRBIMEVE. Ne do t'i analizojmë rastet që referohen jashtë vendit dhe do të investojmë në pajisje moderne dhe trajnime për stafin. Kjo do të ndihmojë në ofrimin e shërbimeve bashkëkohore brenda vendit. Do të nënshkruajmë memorandume bashkëpunimi me vende si Gjermania, Italia dhe Turqia për të sjellë ekspertë ndërkombëtarë në Kosovë për periudha gjashtëmujore deri në një vit. Ky hap do të ndihmojë në ngritjen e cilësisë së shërbimeve dhe trajnimin e stafit vendor.

3. ELIMINIMI I MUNGESAVE TË BARNAVE DHE MATERIALEVE SHPENZUESE. Do të krijojmë një sistem digjital për planifikimin dhe menaxhimin e barnave dhe materialeve shpenzuese, që do të ndihmojë në parandalimin e vonesave dhe humbjeve të materialeve, duke siguruar që ato të jenë në

përputhje me kërkesat e sistemit. Ne do t'i avancojmë procedurat e prokurimit për të siguruar materiale cilësore dhe me kosto konkurruese, duke krijuar një sistem të kontrollit për t'i monitoruar dhe korrigjuar mangësitë.

4. FUNKSIONALIZIMI I SISTEMIT TË SIGURIMEVE SHËNDETËSORE. Do të plotësohet dhe përmirësohet legjislacioni primar dhe sekondar, për ta filluar pastaj zbatimin e sigurimeve shëndetësore. Zbatimi i sigurimeve shëndetësore do të krijojë qëndrueshmëri financiare për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, ndërsa investimet qeveritare do të fokusohen në infrastrukturën shëndetësore, pajisje mjekësore, edukim të vazhdueshëm profesional dhe përmirësim të kushteve të punës për profesionistët shëndetësorë, për të ofruar kujdes shëndetësor efikas dhe kualitativ për të gjithë qytetarët.

5. RIORGANIZIMI I SPECIALIZIMEVE NË SHËNDETËSI DHE LIGJI PËR SPECIALIZANTËT. Do të sigurojmë pagë dhe kontratë pune në Kosovë për të gjithë specialistët e të gjitha profileve shëndetësore. Ne planifikojmë që specializimet në shëndetësi t'i riorganizojmë, duke krijuar bazën ligjore (Ligjin për Specializimet), duke e valorizuar edhe punën e integruar në shëndetësi (ShSKUK) dhe mësimdhënie. Ligji për Specializimet do të pamundësojë ndryshimin e kriterëve të specializimeve sipas interesave grupore apo politike.

6. DIGJITALIZIMI I SISTEMIT SHËNDETËSOR. Do të krijojmë një platformë digjitale, tërësisht të integruar dhe efikase, e cila do t'i lidhë të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor dhe shërbimeve. Ky sistem do të sigurojë që pacientët të marrin kujdes të koordinuar dhe të vazhdueshëm, nga vizitat ambulatorore deri te trajtimi në spitalet e specializuara. Strategjia e përgjithshme për digjitalizimin e sistemit shëndetësor synon modernizimin e këtij sistemi, duke përmirësuar cilësinë e kujdesit, efikasitetin e shërbimeve dhe qasjen për të gjithë qytetarët. Kjo do të ndihmojë në ndërtimin e një sistemi shëndetësor të qëndrueshëm dhe të sigurt, që përmbush nevojat e të gjithë popullsisë. Digjitalizimi i sistemit shëndetësor do të përfshijë këta komponentë:

- **ZGJERIMI I SISTEMIT INFORMATIV SHËNDETËSOR (HIS)** do t'i përfshijë nivelet sekondare dhe terciare të kujdesit, duke integruar spitalet rajonale, qendrat diagnostike, spitalet universitare dhe njësitë e kujdesit të specializuar. Ai do të mundësojë një rrjedhë të vazhdueshme të të dhënave, duke lehtësuar diagnostikimin dhe trajtimin e saktë të pacientëve.
- **IMPLEMENTIMI I MODULEVE SPECIFIKE PËR MENAXHIMIN E PACIENTËVE TË HOSPITALIZUAR DHE JO TË HOSPITALIZUAR** do të mundësojë një qasje më

të personalizuar ndaj kujdesit mjekësor. Pacientët do të marrin kujdes të përshtatur sipas nevojave të tyre, duke rritur efikasitetin e trajtimeve dhe bashkëpunimin në mes të njërive të ndryshme të kujdesit.

- **PËRDORIMI I SISTEMEVE PËR NDARJEN E TË DHËNAVE TË ANALIZAVE LABORATORIKE NË KOHË REALE** do ta përmirësojë ndjeshëm bashkëpunimin ndërmjet mjekëve dhe pacientëve. Laboratorët do të jenë në gjendje t'i ndajnë rezultatet e analizave menjëherë me mjekët përkatës, duke shkurtuar kohën e pritjes dhe përmirësuar vendim-marrjen klinike.
- **FARMACITË DO TË ADOPTOJNË NJË PLATFORMË PËR MENAXHIMIN E RECETAVE ELEKTRONIKE DHE SHPËRNDARJEN E BARNAVE**, gjë që do t'i evitojë gabimet gjatë përshkrimit të barnave dhe do ta rrisë sigurinë e pacientëve. Ky sistem do të sigurojë që pacientët t'i marrin ilaçet e duhura në kohë dhe në mënyrë të sigurt.
- **DIGJITALIZIMI I FONDIT TË SIGURIMIT SHËNDETËSOR** do ta përfshijë regjistrimin elektronik të anëtarësimit, menaxhimin e përfitimeve dhe lehtësimin e pagesave. Ky proces do të koordinohet me barnatoret për ta mundësuar kompensimin e shpejtë dhe të saktë të barnave të rimbursuara për pacientët.
- **SISTEMET PËR IMAZHE MJEKËSORE DHE INFORMACION RADIOLOGJIK (PACS/RIS)** do ta përmirësojnë menaxhimin dhe qasjen e të dhënave radiologjike. Mjekët do të kenë qasje të shpejtë dhe të sigurt në imazhe mjekësore, duke rritur saktësinë e diagnostikimit dhe ndihmuar në trajtime më të personalizuara.
- **PORTALI I DEDIKUAR PËR PACIENTËT** do t'u ofrojë atyre mundësinë të qasen në dosjet e tyre mjekësore në çdo kohë. Përmes këtij portali, pacientët do të mund të caktojnë takime, t'i ndjekin rezultatet e analizave dhe të komunikojnë në mënyrë të sigurt me profesionistët e shëndetit, duke rritur përfshirjen e tyre në kujdesin personal.
- **TELEMEDICINA DO T'I MBËSHITESË KONSULTIMET MJEKËSORE NË DISTANCË**, veçanërisht për pacientët në zona të largëta apo me sëmundje të specializuara që kërkojnë konsultime me ekspertë ndërkombëtarë. Kjo do ta përmirësojë qasjen e barabartë në kujdes mjekësor dhe do ta lehtësojë diagnozën dhe trajtimin pa pasur nevojë për udhëtime të gjata.
- **SISTEMI I DOSJEVE MJEKËSORE ELEKTRONIKE (EMR)** do t'i integrojë të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor, duke siguruar të dhëna të plota dhe të sakta për çdo pacient. Ky sistem do të lejojë që mjekët të kenë një pamje të plotë të historikut mjekësor të pacientit, duke përmirësuar cilësinë e kujdesit dhe duke zvogëluar gabimet mjekësore.

7. NDËRTIMI I SISTEMIT KOMBËTAR TË EMERGJENCAVE MJEKËSORE. Sistemi Kombëtar i Emergjencave Mjekësore do të krijojë një rrjet të koordinuar dhe efikas për trajtimin e situatave emergjente mjekësore në të gjithë Kosovën. Ai do të përbëhet nga një rrjet kombëtar i integruar, që përfshin qen-

dra rajonale të koordinuara dhe ekipe mjekësore të gatshme për të ofruar ndihmë të menjëhershme në vendngjarje dhe gjatë transportit, duke siguruar një transferim të shpejtë në ndihmën e kualifikuar. Ky sistem do t'i huazojë praktikën më të mira nga vendet perëndimore dhe përvojën e suksesshme të Shqipërisë, e cila ka ndërtuar një sistem të tillë në vitet e fundit. Duke ndjekur modelin e Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore të Shqipërisë, do ta menaxhojë dhe koordinojë rrjetin e ambulancave në nivel kombëtar dhe do ta përfshijë transportin ajror me helikopterë për raste kritike. Ky sistem do të përmbajë komponentë të rëndësishëm për ta përmirësuar dhënien e përgjigjes dhe ofrimin e ndihmës në raste emergjente, duke garantuar trajtimin e duhur për pacientët në kohën më të shkurtër të mundshme.

KOMPONENTËT E KËTIJ SISTEMI JANË:

- **QENDRAT RAJONALE TË EMERGJENCAVE MJEKËSORE:** Do të krijohen qendra të specializuara të emergjencës mjekësore në rajone kyçe të Kosovës. Këto qendra do të jenë të pajisura me teknologji moderne dhe personel të trajnuar për të menaxhuar situata kritike si aksidentet rrugore, krizat kardiake, plagosjet e rënda dhe sëmundjet akute. Çdo qendër do të jetë e përgatitur për të ofruar ndihmë të menjëhershme dhe stabilizim për pacientët deri në transportimin e tyre në një spital të specializuar, nëse është e nevojshme. Në këtë mënyrë lehtësohet barra e spitaleve rajonale dhe QKUK-së.
- **SISTEMI I INTEGRUAR I KOORDINIMIT:** Një qendër kombëtare e koordinimit do të jetë përgjegjëse për menaxhimin dhe drejtimin e burimeve mjekësore në rastet emergjente. Ky sistem do t'i integrojë qendrat rajonale dhe të gjitha shërbimet e ambulancave, duke përfshirë edhe transportin ajror, për të siguruar një përgjigje të shpejtë dhe efikase në çdo rajon të vendit.
- **HELIKOPTERI PËR TRANSPORT MJEKËSOR AJROR:** Helikopteri do të jetë i vendosur në një qendër strategjike dhe i gatshëm për të ofruar transport ajror të shpejtë për pacientët që kërkojnë trajtim urgjent. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për pacientët në zona të largëta ose për raste ku rruga tokësore nuk është e mundur apo do ta vononte ndihmën mjekësore. Helikopterët do të jenë të pajisur me personel mjekësor dhe pajisje të avancuara për stabilizimin e pacientëve gjatë fluturimit drejt spitaleve të specializuara.
- **SHËRBIMET E AMBULANCIVE DHE NDIHMËS SË PARË:** Rrjeti do të përfshijë ambulanca të pajisura me teknologji të avancuar dhe staf të trajnuar që do të operojnë në të gjithë vendin. Ky sistem do të sigurojë që pacientët ta marrin kujdesin e parë në vendngjarje, stabilizimin dhe transportin në qendra mjekësore, bazuar në natyrën e emergjencës së tyre.
- **TRAJNIMI DHE CERTIFIKIMI I PERSONELIT TË EMERGJENCIVE:** Të gjitha ekipet që punojnë në shërbimet e

emergjencave do të marrin trajnime të specializuara për t'u përgatitur për çdo lloj situatë urgjente. Kjo do të përfshijë trajnim për përdorimin e teknologjisë mjekësore, kujdesin në situata kritike dhe transportin e sigurt të pacientëve.

- **PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË PËR REAGIM TË SHPEJTË:** Do të vendoset një sistem digjital për menaxhimin e thirrjeve emergjente, duke lidhur drejtpërdrejt thirrjet me Qendrën Kombëtare të Koordinimit dhe duke përcaktuar në kohë reale burimet më të afërta që mund të ndihmojnë në rast urgjence, pasi shpesh përkatësia e komunave apo zona e autoritetit të spitaleve specifike rajonale mund ta pengojë e komplikojë dhënien e shërbimit.

8. NDËRTIMI I SPITALIT RAJONAL TË PRISHTINËS.

Ndërtimi i Spitalit Rajonal të Prishtinës është një hap kyç për përmirësimin e sistemit shëndetësor në rajonin e Prishtinës, duke adresuar një boshllëk të rëndësishëm në shërbimet shëndetësore sekondare. Aktualisht, qytetarët e Prishtinës dhe komunave përreth, si Podujeva, Obiliqi, Fushë-Kosova dhe Drenasi, nuk kanë qasje në një spital rajonal, për shkak të të cilit detyrohen të drejtohen menjëherë në sektorin terciar për çështje që mund të trajtohen më afër, duke shkaktuar mbingarkesë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). Me ndërtimin e Spitalit të Prishtinës, pritet të reduktohet kjo mbingarkesë dhe të përmirësohet cilësia e shërbimeve për pacientët. Spitali do t'u mundësojë qytetarëve ta marrin trajtimin e nevojshëm në nivel rajonal, duke optimizuar burimet shëndetësore dhe rritur efikasitetin e kujdesit mjekësor, si dhe cilësinë e jetës për popullsinë e këtyre zonave.

9. PROGRAMI KOMBËTAR I MJEKËSISË SË SPECIALIZUAR TË LËVIZSHME.

Ky program ofron shërbime shëndetësore të specializuara për qytetarët në zonat e thella rurale të Kosovës, ku qasja në kujdesin mjekësor është e kufizuar. Duke krijuar një rrjet njësisish lëvizëse mjekësore me teknologji diagnostikuese dhe staf të specializuar, do të mundësojë kontrolle preventive, diagnostikim të hershëm dhe trajtime për sëmundjet kronike. Ekipet do të ofrojnë, po ashtu, shërbime për shëndetin e nënave dhe fëmijëve, fushata vaksinimi dhe ndërgjegjësimi për parandalimin e sëmundjeve infektive. Njësitë do të bashkëpunojnë me spitalet rajonale dhe qendrat e kujdesit parësor për ta siguruar vazhdimësinë e kujdesit. Përdorimi i teknologjisë digjitale për regjistrimin e të dhënave do ta përmirësojë koordinimin midis strukturave shëndetësore. Kjo nisimë do ta zvogëlojë pabarazinë në kujdesin shëndetësor dhe do ta lehtësojë ngarkesën mbi spitalet rajonale, duke garantuar që qytetarët në zonat rurale të kenë qasje të rregullt në shërbime të specializuara dhe duke përmirësuar shëndetin e përgjithshëm.

10. PROGRAMI I KUJDESIT PALIATIV. Ky program synon të krijojë një rrjet të integruar të shërbimeve për pacientët me sëmundje kronike dhe të pashërueshme, duke ofruar ku-

jdes fizik, emocional dhe psikologjik për ata dhe familjet e tyre. Qendrat e kujdesit paliativ do të krijohen në rajone të ndryshme të Kosovës dhe do të ofrojnë shërbime mjekësore të specializuara, trajtim të dhimbjes dhe mbështetje të personalizuar për pacientët në fazat e fundit të sëmundjeve. Ekipet multidisiplinare të këtyre qendrave do të përfshijnë mjekë, infermierë, psikologë dhe punonjës socialë, duke garantuar qasje gjithëpërfshirëse.

Përveç kujdesit në qendrat e specializuara, programi do të ofrojë kujdes paliativ në shtëpi për pacientët që pëlqejnë të marrin shërbime në ambientin familjar. Ekipet e kujdesit do t'i vizitojnë pacientët në shtëpi, duke u ofruar ndihmë për menaxhimin e dhimbjes dhe simptomave të tjera. Njëkohësisht, do të ofrojnë mbështetje edhe për familjet që kujdesen për ta. Gjithashtu, do të ofrohet mbështetje psiko-sociale dhe shpirtërore për pacientët dhe familjarët e tyre, për t'i ndihmuar ata të përballen me sfidat emocionale që vijnë me sëmundjet e pashërueshme.

11. QENDRA KOMBËTARE PËR TRAJTIMIN E VARËSIVE.

Kjo qendër do të krijojë një institucion të specializuar për trajtimin e varësive nga substancat narkotike, alkooli dhe lojërat e fatit, duke ofruar shërbime të plota rehabilitimi dhe riintegrimi. Ajo do të funksionojë si një pikë qendrore për trajtim dhe mbështetje terapeutike, duke ndihmuar pacientët të përballen me varësinë dhe të rikthehen në jetën e tyre të përditshme me mbështetje psiko-sociale. Qendra do të vendoset në komunën periferike të Kamenicës, për të siguruar një ambient të qetë dhe të izoluar nga tundimet urbane që mund ta pengojnë procesin e rehabilitimit. Kjo do të ndihmojë në decentralizimin e institucioneve shtetërore dhe revitalizimin e zonave periferike, duke krijuar mundësi për zhvillim lokal. Duke ofruar shërbime të specializuara, qendra do të kontribuojë në përmirësimin e jetës së pacientëve, duke u ofruar atyre një ambient të sigurt për trajtim. Në të njëjtën kohë, programi do ta rrisë ndërgjegjësimin publik për varësitë dhe do të ndihmojë në reduktimin e stigmës, duke mundësuar rikthimin e tyre si anëtarë të dobishëm të shoqërisë.

12. PROGRAMI KOMBËTAR PËR KUJDESIN NDAJ AUTIZMIT DHE SËMUNDJEVE NEURO-ZHVILLIMORE.

Programi Kombëtar për Kujdesin ndaj Autizmit dhe Sëmundjeve Neuro-Zhvillimore do të krijojë një sistem gjithëpërfshirës për identifikimin e hershëm, diagnozën dhe trajtimin e autizmit dhe çrregullimeve të tjera neuro-zhvillimore. Qendrat e specializuara do të ofrojnë terapi sjelljeje, terapi të folurit dhe shërbime edukative të personalizuara për fëmijët dhe të rriturit me autizëm. Programi, gjithashtu, do t'i mbështesë familjet me udhëzime praktike dhe grupe mbështetëse për menaxhimin e sfidave të përditshme. Një aspekt kyç do të jetë trajnimi i vazhdueshëm i profesionistëve të kujdesit shëndetësor dhe edukatorëve, duke përfshirë metodat më të reja ndërkombëtare për diagnozën dhe trajtimin e çrregullimeve neuro-zhvillimore. Përmes këtij programi të prekurit me au-

tizëm do të kenë mundësi ta zhvillojnë potencialin e tyre dhe të integrohen më mirë në shoqëri, ndërsa familjet të marrin mbështetjen e nevojshme në këtë rrugëtim.

13. NXITJA E PRODHIMIT VENDOR FARMACEUTIK: SIGURI SHËNDETËSORE DHE ZVOGËLIM I VARËSISË NGA IMPORTET. Prodhimi vendor në sektorin farmaceutik dhe të produkteve shëndetësore është një nevojë strategjike, e cila u bë e evidente gjatë pandemisë, duke theksuar rëndësinë e vetëmjaftueshmërisë dhe sigurisë shëndetësore për përm-bushjen e kërkesave bazë. Krijimi i një klime të favorshme për investime përmes favorizimeve institucionale, mbështetjes infrastrukturale dhe partneriteteve publiko-private është thelbësor për ndërtimin e kapaciteteve lokale të prodhimit dhe për rritjen e furnizimit të qëndrueshëm me produkte es-enciale, duke zvogëluar varësinë nga importet. Zhvillimi i in-dustrisë farmaceutike vendase do të përfitojë nga investimet në teknologji moderne, qendra kërkimore dhe lehtësirat për certifikim cilësie. Kjo qasje do t'i përshpejtojë investimet dhe do ta tërheqë inovacionin në këtë fushë, duke ulur kostot për konsumatorët dhe krijuar vende të reja pune. Mbështetja për prodhimin vendor duhet të jetë pjesë e një plani të strukturuar për ta forcuar sigurinë shëndetësore dhe për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, me fokus në krijimin e një industrie farmaceutike konkurruese

10

**BASHKË PËR NJË
KOSOVË TË
GJELBËR**

PDK



10. BASHKË PËR NJË KOSOVË TË GJELBËR



VEPRIMET E PROPOZUARA

1. FUQIZIMI I INSTITUCIONEVE MJEDISORE DHE RITJIA E TRANSPARENCËS DHE PËRGJEGJËSISË. Do të bëjmë një analizë të hollësishme mbi strukturën e institucioneve mjedisore dhe resurset ekzistuese për t'i përshtatur ato me funksionet e nevojshme, duke vlerësuar mundësitë për rialokimin e resurseve njerëzore. Plotësimi i pozitave të lira, me fokus të veçantë në ato udhëheqëse që aktualisht mbahen nga ushtrues detyre për vite me radhë, do të jetë prioritet. Ne do të krijojmë kushte për punësimin e specialistëve, veçanërisht në inspektoratin mjedisor, IHMK, ARPL, AMMK, DMMU, ku mungesa e tyre është problematike. Gjithashtu, do t'i fuqizojmë trupat institucionale përgjegjëse për lejedhënie mjedisore, duke plotësuar personelin dhe ofruar mbështetje teknike. Për më tepër, do ta rrisim rolin e komunave duke fuqizuar kapacitetet e tyre njerëzore dhe duke ua deleguar disa përgjegjësi mjedisore.

2. PARQET URBANE DHE HAPËSIRAT E GJELBRA. Mbështetje për çdo komunë në zhvillimin e parqeve të reja urbane dhe peri-urbane, si dhe për përmirësimin e hapësirave ekzistuese të gjelbra, me qëllim krijimin e mjedisëve të pasura e të qasshme për të gjithë qytetarët. Këto projekte do të ofrojnë hapësira të sigurta dhe të gjelbra për rekreacion, sport dhe aktivitete kulturore, duke ndikuar pozitivisht në mirëqenien fizike dhe mendore të komuniteteve tona.

Gjithashtu, këto zona të reja do të kontribuojnë në ruajtjen e biodiversitetit lokal dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit.

3. FUQIZIMI I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË RESURSEVE UJORE PËRMES PËRMIRËSIMIT TË PLANIFIKIMIT DHE RITJES SË INVESTIMEVE. Do të investojmë në rritjen e rezervave ujore përmes ndërtimit të akumulacioneve të reja dhe rezervuarëve, si dhe në ndërtimin e impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura në zonat e mëdha urbane si Prishtina, Mitrovica, Gjilani dhe Ferizaj, duke synuar që deri në vitin 2030 të arrijë një nivel trajtimi prej 50 %. Investimet do të përfshijnë infrastrukturën e ujësjellësit, për të garantuar furnizim të sigurt dhe të mjaftueshëm me ujë për qytetarët. Do të zbatohen programe për uljen e humbjeve në sistemin e ujësjellësit dhe do të mbështeten teknologjitë e pastra për trajtimin dhe kursimin e ujit në industrinë prodhuese dhe përpunuese. Gjithashtu, do të promovohen praktika të mira bujqësore për optimizimin e përdorimit të ujit, pesticideve e plehrave dhe do të realizohen projekte për mbrojtjen e ekosistemeve të ujërave të ëmbla dhe restaurimin e zonave të ndotura. Në bashkëpunim me komunat, do ta mbështesim eliminimin e mbeturinave nga lumenjtë dhe brigjet e tyre përmes një programi nacional.

4. PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË AJRIT DHE REDUKTIMI I NDOTJES PËRMES ZBATIMIT TË MASAVE DHE SUBVENCIONEVE. Do të zbatojmë masa dhe subvencione për mbrojtjen e ajrit nga ndotja që shkaktohet nga industria, transporti dhe amvisëritë. Do t'i promovojmë dhe mbështesim nismat për zhvillimin e ngrohjes qendrore në zonat urbane, ndërsa modernizimi i transportit publik dhe lirimi nga dogana i automjeteve të reja elektrike do të ndihmojnë në promovimin e transportit të qëndrueshëm. Cilësia e ajrit, ujit dhe tokës do të monitorohet rregullisht, përderisa qytetarët do të informohen vazhdimisht mbi nevojën e shkurtimeve të ndotjes dhe ndikimin e saj në shëndetin publik. Gjithashtu, do të zbatojmë një program nacional për rehabilitimin e zonave të ndotura dhe të degraduara, duke forcuar rregulloret mjedisore për ta ulur ndotjen. Bizneset do të mbështeten dhe nxiten të zbatojnë zgjedhje miqësore me mjedisin dhe teknologji të pastra, ndërsa do të krijohet një program për projekte dhe nisma që mbrojnë mjedisin.

5. PROMOVIMI I MAKINAVE ELEKTRIKE NË KOSOVË. Do të ndërmarim veprime për të nxitur përdorimin e mjeteve miqësore me mjedisin. Së pari, do t'i eliminojmë tarifatat doganore për importin e makinave elektrike, duke i bërë ato më të përballeshme. Do të kërkohet që çdo pompë karburanti të ketë karikues për automjetet elektrike brenda katër viteve,

duke siguruar një infrastrukturë të gjerë karikimi. Do të krijohet vende parkimi të dedikuara për makinat elektrike në qytete dhe do ta fillojmë zëvendësimin e flotës zyrtare me makina elektrike për ta treguar angazhimin ndaj mbrojtjes së mjedisit. Gjithashtu, do ta subvencionojmë instalimin e stacioneve private të karikimit, duke e bërë më të lehtë qasjen për karikim.

6. PËRMIRËSIMI I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE DHE ZBATIMI I PARIMEVE TË EKONOMISË QARKORE. Do të angazhohemi për rishikimin e legjislacionit për menaxhimin e mbeturinave, duke përcaktuar synime më ambicioze për ta forcuar ekonominë qarkore. Përmes hartimit të një Strategjie dhe Plani të Veprimit për Ekonominë Qarkore, do ta promovojmë riciklimin dhe ripërdorimin e mbeturinave, duke kontribuar në uljen e ndotjes dhe përdorimin e qëndrueshëm të resurseve. Gjithashtu, do ta mbështesim dhe bashkëfinancojmë ndërtimin e qendrave për ndarjen, klasifikimin, trajtimin dhe përpunimin e mbeturinave komunale, duke synuar riciklimin e 50 % të tyre deri në vitin 2030. Po ashtu, do të investojmë në zhvillimin dhe modernizimin e infrastrukturës për mbledhjen dhe trajtimin e mbeturinave të ndërtimit dhe demolimit, si dhe do t'i eliminojmë deponitë e egra, mbyllim ato sanitare të vjetra dhe zgjidhim problemin e mbeturinave të rrezikshme përmes trajtimit të tyre të duhur.

7. MBROJTJA E BURIMEVE NATYRORE DHE RUAJTJA E BIODIVERSITETIT. Do të angazhohemi për krijimin e korridoreve për kafshët e egra për t'i ruajtur habitatet natyrore. Përmirësimi i menaxhimit të zonave ekzistuese do të arrihet përmes rritjes së përgjegjësisë, kompetencave dhe buxhetit për organet menaxhuese, duke hartuar plane dhe programe për menaxhimin efikas. Do t'i zbatojmë në tërësi kërkesat e Legjislacionit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe atë strategjik mjedisor, duke parandaluar veprimet e dëmshme ndaj natyrës dhe biodiversitetit. Krahas mbrojtjes së natyrës, do t'i mbështesim programet për promovimin e ekoturizmit, ndërlikohen me trashëgiminë kulturore dhe zhvillimin rural. Masa urgjente do të ndërmerren për mbrojtjen e pyjeve nga keqmenaxhimi, rritjen e pyllëzimit dhe restaurimin e ekosistemeve të rëndësishme. Gjithashtu, do të zbatohen masa kundër shpyllëzimit, tregtisë së paligjshme të kafshëve të egra dhe shkatërrimit të habitateve.

8. PROGRAME TË DEDIKUARA PËR PYLLËZIMIN E ZONAVE TË REJA DHE RIPPYLLËZIMIN E PYJEVE TË DËMTUARA. Kjo fushatë do të ketë disa qëllime, përfshirë rritjen e thithjes së karbonit, ruajtjen e biodiversitetit, nxitjen e industrisë së përpunimit të drurit, mbrojtjen e tokave nga degradimi i erozionit, përmirësimin e cilësisë së ajrit përmes rritjes së biomasës, promovimin e turizmit natyror dhe krijimin e punësimit sezonal për të rinjtë. Prioritet në pyllëzim do të kenë hapësirat pranë zonave urbane, për ta përmirësuar cilësinë e ajrit, brigjet e lumenjve për ta shmangur erozionin dhe përmytjet, zonat me potencial turistik dhe zonat malore ku ka rrezik për ortekë apo rrëshqitje toke. Gjithashtu, pyllëzimi do të luajë një

rol kyç për përbalimin e ndryshimeve klimatike, duke shkurtuar emetimin e karbonit dhe ndihmuar vendin ta përballojë ngrohjen globale. Po ashtu, ai do të kontribuojë në ruajtjen e biodiversitetit, duke rikthyer ekosistemet dhe mbrojtur shumëllojshmërinë e florës dhe faunës. Plani është mbjellja e 500 mijë fidanëve çdo vit, duke arritur dy milionë fidanë deri në fund të mandatit të PDK-së.

9. DEKARBONIZIMI DHE TRANZICIONI I GJELBËR NË SEKTORIN E ENERGISË. Do të angazhohemi për rritjen e investimeve në prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtërishme si energjia solare, era, hidro dhe gjeotermale. Do të promovohen masa për efikasitetin e energjisë në industri, transport dhe ndërtesa, duke synuar rritjen e investimeve dhe krijimin e vendeve të gjelbra të punës. Do të ofrohen edhe programe trajnimi për ta mbështetur tranzicionin drejt një ekonomie me karbon të ulët. Në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare dhe obligimet në procesin e integritetit në Bashkimin Evropian, do të zbatohen masa dhe subvencione për zbutjen e ndryshimeve klimatike. Gjithashtu, do të paraqesim dhe mbështesim masa përshtatëse në sektorët më të cenueshëm ndaj ndryshimeve klimatike si energjia, bujqësia, pylltaria, infrastruktura dhe menaxhimi i ujit. Për më tepër, do të promovohet prokurimi i gjelbër në prokurimin publik për të mbështetur praktika të qëndrueshme.

10. NDËRTIMIN E PARKUT BOTANIK KOMBËTAR NË LUGINËN E DRINIT, ZONA E HASIT. Ndërtimi i Parkut Botanik Kombëtar në Luginën e Drinit është një angazhim për ruajtjen e biodiversitetit në Kosovë dhe për edukimin e qytetarëve mbi florën vendase. Si çdo shtet dinjitoz, nevojitet një park botanik për t'i konservuar burimet natyrore dhe për t'i arsimuar brezat e ardhshëm. Parku do të ofrojë hapësira të gjelbra me koleksione bimësh autoktone dhe ekzotike, si dhe një qendër edukative për shkollat. Ky projekt do të jetë një atraksion turistik, duke tërhequr vizitorë dhe duke ofruar mundësi për ecje, çiklizëm dhe vëzhgim të florës dhe faunës. Një liqen i vogël do të mbështesë habitate ujore dhe do të mundësojë aktivitete si kayaking. Gjithashtu, "Shtegu i Lirisë" do të lidhë parkun me historinë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), duke i dhënë kuptim simbolik. Parku do të shërbejë si një qendër kërkimore për universitetet, duke lehtësuar studimet mbi biodiversitetin. Ai do të kontribuojë në zhvillimin e një kulture mjedisore të qëndrueshme dhe do ta pozicionojë Kosovën si një destinacion për turizmin ekologjik.

DREJTËSI E REFORMUAR PËR KOSOVËN



PDK

11. DREJTËSI E REFORMUAR PËR KOSOVËN



VEPRIMET E PROPOZUARA

1. STRATEGJIA KUNDËR KORRUPSIONIT 2025-2029 DHE FORCIMI I POLITIKAVE DHE MEKANIZMAVE PËR LUFTIMIN E KORRUPSIONIT. Kosova nga viti 2019 nuk ka një strategji për luftimin e korrupsionit. Mungesa e kësaj strategjie për një kohë kaq të gjatë dhe dështimi për të hartuar një dokument të tillë dëshmon për mungesën e vullnetit politik të partisë në pushtet për ta luftuar korrupsionin. Ndër prioritetet e para të qeverisë së PDK-së do të jetë miratimi i Strategjisë Kundër Korrupsionit, e cila do të ketë katër shtylla kryesore: 1. Parandalimi i korrupsionit përmes rritjes së integritetit të institucioneve publike, duke zbatuar Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve; 2. Fuqizimi i kapaciteteve të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit; 3. Fuqizimi i bashkëpunimit dhe koordinimit institucional të institucioneve dhe agjencive që zbatojnë Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Korrupsionit, duke respektuar pavarësinë kushtetuese dhe ligjore të tyre; 4. Prioritizimin e trajtimit të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë nga organet e drejtësisë, duke respektuar pavarësinë e këtyre institucioneve. Po ashtu, do të realizojmë një rishikim të plotë të legjislacionit dhe politikave që mundësojnë luftimin në mënyrë efektive të korrupsionit. Kjo do të bëhet duke fuqizuar prokurorinë e shtetit përmes themelimit të Byros Kombëtare të Hetimit dhe avancimit të digjitalizimit të shumë proceseve administrative dhe gjyqësore, veçanërisht ato që lidhen me prokurimin publik për ta zvogëluar ndikimin e njeriut në këto procedura.

2. VETINGU NË SISTEMIN E DREJTËSISË. Ne do të realizojmë një proces të plotë të vetingut përmes ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore, që mundëson pastrimin e sistemit nga individët joprofesionalë dhe të korruptuar. Vetingu i plotë do të realizohet pas një debati dhe konsultimi të gjerë me institucionet e drejtësisë, ekspertët dhe akademikët, shoqërinë civile, zyrën e BE-së, ambasadat e shteteve mike, si dhe duke zbatuar me besnikëri rekomandimet e Komisionit të Veneçias. Me qëllim të ngritjes së besimit të publikut në këtë proces kaq jetik për ngritjen e integritetit dhe llogaridhënies së sistemit gjyqësor dhe prokurorial, ky proces do të realizohet duke u bazuar në parimet e transparencës deri në masën që e lejon ligji dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare.

3. THEMELIMI I BYROSË KOMBËTARE TË HETIMIT. Luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë do të jetë prioritet i qeverisë së udhëhequr nga PDK-ja. Krahas përmirësimit dhe ngritjes së integritetit të bartësve kryesorë të sistemit të drejtësisë përmes procesit të vettingut dhe ofrimit të kushteve optimale për PSRK, ne përshtatshëm do të formojmë një Byro Kombëtare të Hetimit me kompetenca dhe përgjegjësi të ngjashme. Karakteristikë e këtij institucioni të ri, i cili do të përbëhet nga jo më shumë se dhjetë prokurorë të specializuar, do të jetë policia gjyqësore që do t'i trajtojë të gjitha rastet kur ka dyshime për keqpërdorim të detyrës zyrtare apo kur bien ndesh me ligjin gjyqtarët, prokurorët dhe stafi mbështetës i sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Ky mekanizëm, po ashtu, do të jetë kompetent për t'i trajtuar rastet e korrupsionit të nivelit të lartë në rastet kur PSRK nuk ndërmerr veprime sipas kompetencës së saj. Ky organ i specializuar dhe i pavarur nga ndërhyrjet politike do ta ketë detyrën për të hetuar dhe ndjekur penalisht korrupsionin dhe krimin e organizuar në mënyrë efektive, veçanërisht në nivele të larta të pushtetit. Po ashtu, ky organ do të ketë kompetenca për ta hetuar pasurinë e pajustificueshme të zyrtarëve shtetërorë. Përmes formimit të këtij organi do të ngriten kapacitetet për luftimin e korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimit të organizuar dhe do të arrihet forcimi i ndjeshëm i kapaciteteve hetimore të prokurorisë për të ndihmuar në çrënjosjen e praktikave të paligjshme brenda dhe jashtë sistemit të drejtësisë.

4. PËRMIRËSIMI I DREJTËSISË CIVILE. Numri më i madh i lëndëve në sistemin gjyqësor i takon fushës civile, ku cenohen të drejtat dhe liritë e qytetarëve për t'i realizuar të drejtat e tyre pronësore, nga raportet juridiko-civile, kontratat kolektive apo obligimet që institucionet publike i kanë ndërmarrë në raport me të punësuarit në sektorin publik. Vetëm në tre vitet e fundit numri i lëndëve civile në sistemin gjyqësor është

rritur për më shumë se 80 mijë lëndë për shkak të qasjes in-joruese të qeverisë për përmbushjen e obligimeve që dalin nga ligjet e aplikueshme, kontrata kolektive dhe praktika gjyqësore e ndërtuar nga gjykatat e rregullta. Me përmbushjen e obligimeve që dalin nga ligji, kontratat kolektive dhe praktika gjyqësore nga ana e qeverisë, rastet civile në gjykata do të përgjysmohen, duke ndikuar kështu drejtpërdrejt në uljen e rasteve, uljen e kostos së shpenzimeve nëpër gjykata dhe duke ua realizuar të drejtat qytetarëve. Masat dhe intervenimet e tilla do të ndikojnë drejtpërdrejt edhe në rritjen e efikasitetit të gjyqësorit në trajtimin e rasteve civile dhe me këtë edhe në përgjysmimin e kohës së trajtimit të rasteve civile nga gjashtë vjet në tre vjet.

5. DIGJITALIZIMI I PROCESVEVE NË SISTEMIN E DREJTËSISË.

Ne do ta digjitalizojmë punën brenda sistemit të drejtësisë për të sjellë transparencë, efikasitet dhe qasje më të lehtë në drejtësi. Do të bëhet e mundur mbajtja e seancave përmes videokonferencave dhe hartimi i procesverbaleve përmes inteligjencës artificiale. Gjithashtu, do të mundësohet dërgimi i shkresave dhe komunikimi elektronik mes palëve dhe gjykatave. Çdo marrje në pyetje e dëshmitarëve dhe të pandehurve do të bëhet duke u incizuar me video dhe audio. Kjo bëhet me qëllim të përshtatjes së sistemit të drejtësisë me epokën digjitale në të cilën jemi dhe sigurimit të një qasjeje moderne në drejtësi për qytetarët dhe bizneset.

6. RRIJTJA E NUMRIT TË GJYQTARËVE, PROKURORËVE DHE BASHKËPUNËTORËVE PROFESIONALË NË GJYKATA.

Ne do ta rrisim numrin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë pas një konsultimi të gjerë me Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial dhe vlerësimit real dhe të saktë të nevojave që ka sistemi. Kjo do të bëhet me qëllim të zgjidhjes më të shpejtë të lëndëve të pazgjidhura që janë grumbulluar në gjykata dhe zgjidhjes së shpejtë, cilësore dhe efikase të lëndëve të reja. E gjitha kjo do të jetë në funksion të realizimit të së drejtës për gjykim në kohë të arsyeshme, një gjë kjo e munguar aktualisht në sistemin tonë dhe hapjes së perspektivave për bizneset përmes zhblokimit të shumë aspekteve dhe kapitalit të bllokuar nga moszgjidhja e rasteve. Ne do të hartojmë një strategji të veçantë për uljen e numrit të lëndëve nëpër gjykata, e cila do ta rishikojë edhe sistemin e vendosjes në organet administrative, në mënyrë që gjykatat të mos ngarkohen më shumë me lëndë.

7. PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE NË PROFESIONET E NDËRLIDHURA ME SISTEMIN E DREJTËSISË.

Gjatë mandatit tonë do t'i kushtojmë rëndësi zhvillimit dhe promovimit të mëtutjeshëm të ndërmjetësimit, me theks të veçantë në procedurat penale dhe civile. Fuqizimi i mëtejshëm i kapaciteteve të MD-së në lidhje me këtë nevojitet për të qenë në gjendje t'i ushtrojë kompetencat e tilla. Specializimi i ndërmjetësuesve (posaçërisht në fushën e ndërmjetësimit në rastet familjare, e cila është më e ndjeshmja) është një pikë e dobët në sistemin trajnues të ndërmjetësuesve në Kosovë. Trajnimi në ndërm-

jetësim duhet të ofrohet duke i pasur parasysh tri lloje të kompetencave: profesionale, sociale dhe teknike, duke qenë se ndërmjetësuesve nuk u duhen vetëm njohuri dhe shkathtësi për ta ushtruar profesionin, por ata duhet të jenë në gjendje edhe të ndikojnë dhe menaxhojnë marrëdhëniet shoqërore në kontekstin profesional dhe, gjithashtu, duhet të kenë edhe aftësi teknike dhe shkathtësi që nevojiten për kryerjen e punës. Zbatimi efikas dhe profesional i ndërmjetësimit në Kosovë do të ndikojë drejtpërdrejt në uljen e rasteve në gjykata dhe do të shërbehet drejtësia në mënyrë më efikase dhe brenda një afati të arsyeshëm kohor.

8. PËRMIRËSIMI I QASJES SË QYTETARËVE NË DREJTËSI.

Ne do të ndërtojmë një sistem të drejtësisë ku të gjithë qytetarët, pavarësisht statusit ekonomik apo social, të kenë qasje të barabartë në drejtësi. Kjo do të bëhet duke përmirësuar ndihmën juridike falas, duke reformuar sistemin e drejtësisë për të garantuar të drejtën për gjykim të drejtë dhe në kohë të arsyeshme dhe duke rritur transparencën. Po ashtu, do të hapim nga një zyrë për ndërmjetësim në çdo qytet të Kosovës.

9. STRATEGJIA KOMBËTARE PËR KRIMET E LUFTËS.

Ne do ta miratojmë Strategjinë Kombëtare për Krimet e Luftës në Kuvendin e Kosovës. Ky dokument do të përmbajë institucionet, procedurat dhe veprimet për adresimin, zbardhjen dhe vënien para përgjegjësisë të të gjithë atyre që kanë kryer krime gjatë luftës së fundit në Kosovë. Përmes saj do ta realizojmë drejtësinë e munguar dhe do ta zbardhim të vërtetën. Përveç ofrimit të drejtësisë, kjo strategji do të shërbejë për dokumentimin, grumbullimin dhe ruajtjen e historisë dhe kujtesës kolektive të popullit. Po ashtu, Instituti për Krimet e Luftës do të transformohet sipas Ligjit për Veprimtarinë Kërkimore Shkencore.

10. THEMELIMI I GJYKATËS SË PUNËS.

Ne do ta formojmë Gjykatën e Punës për t'i mbrojtur të drejtat e punëtorëve dhe për të garantuar siguri në punë. Kjo gjykatë do të mundësojë ligjshmërinë dhe meritokracinë në punësime dhe zgjidhjen e shpejtë të rasteve të shkeljes së të drejtave nga marrëdhënia e punës. Zgjidhja e çështjeve të punësimit në një gjykatë të specializuar do të sigurojë që konfliktet e punës të trajtohen me ekspertizë të lartë dhe në mënyrë të shpejtë.

11. FUQIZIMI I SISTEMIT TË VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS SË PROKURORËVE DHE GJYQTARËVE.

Ne do të bëjmë një rishikim të thellë të legjislacionit në lidhje me sistemin e vlerësimit të performancës së prokurorëve dhe gjyqtarëve. Kjo do të sigurojë politika të qarta të vlerësimit të performancës së tyre dhe qartësi në adresimin e përgjegjësisë për dështim. Me këtë, ne do ta rregullojmë aspektin cilësor të punës, duke përmirësuar cilësinë e vendimeve dhe akteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Por, do ta rregullojmë edhe aspektin sasior, duke rritur numrin e rasteve të zgjidhura muaj pas muaji dhe vit pas viti.

12. REFORMIMI I VENDIMARRJES DHE LEGJISLACIONIT NË DREJTËSI.

Ne do ta rishikojmë legjislacionin për sistemin e drejtësisë dhe atë relevant për gjykatat. Gjykata e Shkallës së dytë do të ketë të drejtën ta kthejë çështjen në rigjykim vetëm një herë, ndërsa në gjykimet e konflikteve administrative, nuk do të ketë kthim për rivendosje tek organi administrativ, por do të ketë vendosje meritore nga vetë gjykata. Në kontestet e punës, ne do të sigurojmë që gjykata të ketë juridiksion të plotë për të vendosur të gjitha procedurat dhe rastet e punësimit në sektorin publik, pa të drejtën e kthimit në rivendosje tek organi administrativ. Po ashtu, ne do të miratojmë një ligj të veçantë për Gjykatën Supreme.

13. EDUKIMI PËR SUNDIMIN E LIGJIT.

Një pjesë kyçe e reformës së drejtësisë do të jetë organizimi i një fushate të gjerë edukimi për sundimin e ligjit, duke synuar rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për rëndësinë e respektimit të ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre. Kjo nismë do të përfshijë futjen e programeve edukative për drejtësinë dhe respektin për ligjin në kurrikulat e shkollave parauniversitare, për të formuar qytetarë të përgjegjshëm që në moshë të re. Po ashtu, do të ketë trajnime të vazhdueshme për administratën publike, me qëllim që të rriten kapacitetet e tyre për njohjen dhe zbatimin e ligjeve dhe procedurave ligjore në mënyrë më efektive. Për ta fuqizuar më tej sistemin e drejtësisë, prioritet do t'i jepet një programi të dedikuar bursash për juristët që duan të ndjekin studime të thelluara në jurisprudencë, duke ndihmuar në përgatitjen e kuadrove të larta në këtë fushë. Gjithashtu, do të organizohen programe arsimore të vazhdueshme për kuadrot e sistemit të drejtësisë dhe stafin mbështetës, për t'i mbajtur të përditësuar me ndryshimet në legjislacion, praktikat më të mira dhe zhvillimet globale në fushën e drejtësisë. Në këtë kuadër, do të jepen fonde të dedikuara për hulumtime, përkthime, botime dhe për organizime të konferencave e seminareve shkencore në fushën e drejtësisë, duke synuar rritjen e vetëdijes dhe thellimin e dijes juridike në shoqëri.

14. FUQIZIMI I PROFESIONEVE TË LIRA NË KOSOVË.

Fuqizimi i profesioneve të lira, përfshirë noterinë, ndërmjetësimin, arbitrazhin dhe përmbaruesit privatë, është thelbësor për rritjen e efikasitetit të sistemit të drejtësisë dhe lehtësimin e ngarkesës së gjykatave. Ndërmjetësimi, veçanërisht, është promovuar si një mënyrë alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve civile dhe penale, duke ulur kohën e zgjidhjes së lëndëve dhe duke e bërë drejtësinë më të qasshme për qytetarët. Ligji i ri për ndërmjetësim i miratuar më 2018 ka krijuar stimuj që qytetarët të zgjedhin këtë rrugë në vend të gjykatave, duke përfshirë edhe tarifa më të përballueshme që do të bazohen në analizën e gjendjes socio-ekonomike. Zgjerimi i ndërmjetësimit të detyrueshëm për lëndët kontestimore është një hap i mëtejshëm për rritjen e efikasitetit të drejtësisë. Në të njëjtën kohë, fuqizimi i sistemit të noterisë dhe përmbaruesve privatë ka përmirësuar arkitekturën e drejtësisë, duke u bazuar në ligjin e ri të noterisë, i cili parasheh rrit-

jen graduale të numrit të noterëve dhe mbrojtjen e të drejtave trashëgimore, veçanërisht për gratë. Një sistem i mbikëqyrjes më të fortë për këto profesione të lira është thelbësor, pasi aktiviteti i tyre ndikon në ekonominë e vendit dhe duhet të jetë i bazuar plotësisht në ligj. Kjo qasje do të kontribuojë në ngritjen e transparencës dhe integritetit të profesioneve të lira në funksion të drejtësisë.

12

**ADMINISTRATA
PUBLIKE NË SHËRBIM
TË QYTETARËVE**



PDK

12. ADMINISTRATA PUBLIKE NË SHËRBIM TË QYTETARËVE



VEPRIMET E PROPOZUARA

1. RISHIKIMI I LEGJSLACIONIT PËR REFORMËN NË ADMINISTRATËN PUBLIKE. Ne do ta rishikojmë dhe miratojmë legjislacionin përkatës për reformën në administratën publike, duke siguruar që ky proces të jetë plotësisht në përputhje me parimet kushtetuese, Marrëveshjen e Stabilitimit-Asociimit dhe standardet e SIGMA-s. Kjo reformë do të ketë për qëllim rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë dhe efikasitetit të administratës, duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë e shërbimeve për qytetarët dhe bizneset. Nëpërmjet ndryshimit të Ligjit për Zyrtarët Publikë do ta rivendosim sistemin e karrierës në administratë, duke eliminuar sistemin e mandateve të vendosur nga qeveria aktuale, i cili ka kontribuar në politizimin e administratës. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet krijimit të një sistemi të mirëfilltë të vlerësimit të performancës, i cili do të fillojë me ministrat dhe do të zbatohet në të gjitha nivelet e administratës.

2. ZBATIMI I SISTEMIT PËR MENAXHIMIN E PERFORMANCËS SIPAS STANDARDEVE TË SIGMA-S. Ne do të ndërtojmë një Sistem për Menaxhimin e Performancës në përputhje me standardet e SIGMA-s, që do të ketë ndikim thelbësor në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të administratës publike. Përmes këtij sistemi do të vendosen mekanizma të qartë për vlerësimin objektiv dhe të drejtë të performancës së nëpunësve civilë, duke u bazuar në kritere të matshme dhe të standardizuara. Zbatimi i këtij sistemi do ta sjellë rritjen e

llogaridhënies, motivimin e stafit dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike, duke i bërë ato më të përgjegjshme dhe të orientuara drejt rezultateve.

3. RITJJA E KAPACITETEVE PËR ZGJIDHJE TË ANKESAVE DHE MONITORIM TË KËSHILLIT TË PAVARUR MBIKËQYRËS TË SHËRBIMIT CIVIL. Ne do t'i rrisim kapacitetet e Këshillit të Pavarur Mbiqëqyrës të Shërbimit Civil për monitorimin dhe shqyrtimin e ankesave, duke u fokusuar në përmirësimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë brenda administratës publike. Ministratë përgjegjëse do të jenë të angazhuara për zbatimin e plotë të rekomandimeve të Këshillit, duke siguruar që puna e tyre të përputhet me standardet më të larta të qeverisjes dhe administrimit publik.

4. SHNDËRRIMI I INSTITUTIT TË KOSOVËS PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE NË AKADEMINË E KOSOVËS PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE. Akademia e Kosovës për Administratën Publike do të ketë fonde dhe kapacitete më të mëdha, me qëllim përmirësimin e trajnimit dhe zhvillimit profesional të nëpunësve civilë. Ky investim në kapacitetet e Akademisë do të sigurojë që stafi publik të pajiset me njohuri dhe shkathtësi të avancuara, duke rritur cilësinë e shërbimeve publike dhe efektivitetin e administratës. Përmes angazhimit të ekspertëve ndërkombëtar si trajnerë dhe me mbështetje financiare të qëndrueshme, Akademia do ta zgjerojë gamën e programeve trajnuese dhe do të zhvillojë module të reja që përputhen me nevojat në ndryshim të sektorit publik në Kosovë. Ky institucion do të luajë një rol kyç në ndërtimin e një administrate publike më të aftë dhe të përgatitur për sfidat e qeverisjes moderne.

5. QEVERISJA ELEKTRONIKE (E-QEVERISJA) DHE DIGJITALIZIMI I ADMINISTRATËS PUBLIKE. Këto procese janë thelbësore për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve që qytetarët marrin dhe për luftën kundër korrupsionit. Përmes qeverisjes elektronike, procedurat burokratike do të thjeshtohen ndjeshëm, duke ulur kohën dhe kostot për qytetarët dhe administratën, si dhe duke rritur efikasitetin e ofrimit të shërbimeve publike. Qasja elektronike do të bëjë që çdo hap i ndërveprimit me administratën të jetë transparent dhe i monitorueshëm, duke ngushtuar hapësirat për korrupsion dhe duke forcuar llogaridhënien e institucioneve. Krijimi i një portali të unifikuar për shërbimet publike do t'u mundësojë qytetarëve dhe bizneseve të kenë qasje më të lehtë dhe më të shpejtë në shërbimet publike, duke përmirësuar ndjeshëm përvojën e tyre. Digjitalizimi i administratës jo vetëm që lehtëson proceset për qytetarët, por rrit edhe cilësinë dhe efektivitetin e shërbimeve të ofruara. Përmes automatizimit të proceseve dhe hapjes së të dhënave publike, qytetarët do të

kenë qasje më të madhe në informacion dhe do të përmirësohet transparenca e veprimeve qeveritare. Kjo do të kontribuojë në uljen e korrupsionit, pasi monitorimi dhe mbikëqyrja e vazhdueshme do të bëhen më të lehta dhe më efektive. Në të njëjtën kohë, investimet në teknologji dhe inovacion për administratën do të krijojnë një ambient më të favorshëm për zhvillimin ekonomik dhe demokratik të vendit, duke modernizuar sektorin publik dhe përmirësuar ndjeshëm jetesën e qytetarëve. Po ashtu, do ta aktivizojmë sistemin digjital për hartimin dhe miratimin e legjislacionit nga qeveria, i cili do të jetë i lidhur me sistemin e Kuvendit, duke siguruar një proces më transparent dhe të integruar.

6. RISHIKIMI FUNKSIONAL I NJËSIVE LIGJORE NË INSTITUCIONET PUBLIKE.

Do të realizojmë një rishikim funksional të të gjitha njësisve ligjore brenda secilit institucion, deri në nivel të agjencive dhe ministrive, si një proces i domosdoshëm për të siguruar që struktura dhe funksionimi i tyre të jenë në përputhje me nevojat aktuale dhe objektivat strategjike të administratës publike. Kjo masë do ta garantojë hartimin e ligjeve dhe akteve nënligjore në përputhje me Kushtetutën. Përmes këtij procesi, do të identifikohen mangësitë dhe dublimet e mundshme, me synimin e optimizimit të resurseve dhe përmirësimit të efektivitetit ligjor në secilin institucion. Po ashtu, do të sigurohet që njësitë ligjore të pajisen me kapacitetet e duhura dhe të strukturohen në mënyrë që të ofrojnë këshillime ligjore të cilësisë së lartë, duke përmbushur detyrat e tyre më efikase dhe të koordinuara. Ky riorganizim do ta rrisë përgjegjshmërinë dhe transparencën në administratën publike, duke kontribuar në një qeverisje më të drejtë dhe më të mirë. Për më tepër, ne do të hartojmë një agjendë legjislative të harmonizuar me kornizën afatmesme të shpenzimeve, duke e bërë planifikimin qeveritar të ndërlidhur dhe do ta shtojmë numrin e zyrtarëve ligjorë për t'i përmbushur këto detyra.

7. INSTALIMI I SISTEMIT "POLITIKËBËRJA E BAZUAR NË TË DHËNA".

Ne do të promovojmë një qasje të "Politikëbërjes së Bazuar në të Dhëna", duke u fokusuar në matjen e funksionimit të politikëbërjes së bazuar në dëshmi. Kjo nismë do t'i vlerësojë kërkesat dhe praktikën ligjore në lidhje me përdorimin e proceseve konsultative, vlerësimin e ndikimit buxhetor dhe vlerësimin e gjerë të ndikimit. Për më tepër, do të vlerësohet disponueshmëria e dokumenteve trajnuese dhe udhëzimeve për vlerësimin e ndikimit, ngritja e funksionit të kontrollit të cilësisë dhe cilësia e analizës që mbështet miratimin e projektligjeve. Si pjesë e kësaj qasjeje, ne do të realizojmë një rishikim ex-post të legjislacionit, jo për qëllime politike, por për t'i identifikuar dobësitë në zbatimin e tij dhe për t'i evidentuar ndryshimet e nevojshme. Ky rishikim do të shërbejë si bazë për planifikimin e ardhshëm dhe përmirësimin e politikave ligjore në të ardhmen.

8. DERREGULLIMI SI MASË KUNDËR KORRUPSIONIT.

Derregullimi përfshin thjeshtimin dhe eliminimin e procedurave administrative të panevojshme, duke e bërë më të lehtë për qytetarët dhe bizneset marrjen e shërbimeve pa pengesa burokratike. Harmonizimi i procedurave administrative me ligjin për procedurat e përgjithshme administrative garanton mbrojtje më të mirë të të drejtave dhe interesave të qytetarëve. Një element kyç është përforcimi i parimit të hetimit administrativ, duke kërkuar vetëm dokumentet që nuk gjenden në organet publike. Përmes përdorimit të teknologjisë informative dhe reduktimit të lejeve dhe licencave të panevojshme, administrata do të bëhet më transparente dhe më e qasshme për qytetarët, duke ofruar shërbime administrative pa pagesë dhe duke reduktuar inspektimet e panevojshme, të cilat do të planifikohen paraprakisht dhe do të bazohen në rrezik. Këto masa synojnë krijimin e një administrate publike më të pavarur, efikase dhe të orientuar drejt qytetarëve. Thjeshtimi i procedurave dhe eliminimi i paqartësive dhe mbivendosjeve do t'i zvogëlojë hapësirat për korrupsion, duke kufizuar mundësitë që zyrtarët t'i kushtëzojnë qytetarët për ryshfete apo të marrin vendime selektive që favorizojnë individë të caktuar. Përmes një qasjeje më të hapur dhe transparente, administrata do të sigurojë një mjedis më të drejtë dhe të paanshëm për të gjithë qytetarët dhe bizneset.

13

**NJË KOSOVË E FORTË
DHE E PËRGATITUR
PËR ÇDO SFIDË**



PDK

13. NJË KOSOVË E FORTË DHE E PËRGATITUR PËR ÇDO SFIDË



VEPRIMET E PROPOZUARA

1. KORNIZA E UNIFIKUAR DHE ADAPTIVE E SIGURISË PËR KOSOVËN DHE QYTETARËT E SAJ. Do të krijojmë një kornizë gjithëpërfshirëse sigurie që integron mbrojtjen kombëtare, sigurinë publike dhe parimet e sigurisë njerëzore. Qasja jonë do të vendosë mirëqenien, të drejtat dhe liritë e çdo individi në qendër të politikës sonë të sigurisë kombëtare. Duke përqafuar teknologjitë më të fundit dhe strategjitë vizionare, ne do t'i adresojmë kërcënimet dhe sfidat e reja me masa inovative dhe adaptive që garantojnë sigurinë dhe prosperitetin e të gjithë qytetarëve. Do ta digjitalizojmë mbarë sektorin e sigurisë kombëtare dhe mbrojtjes, duke integruar edhe Inteligjencën Artificiale për t'i rritur kapacitetet për vlerësimin e kërcënimeve në kohë reale dhe planifikimin efikas.

2. FUQIZIMI I SOVRANITETIT DHE KAPACITETET MBROJTËSE TË KOSOVËS. Do t'u japim përparësi përpjekjeve diplomatike për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kufitare, duke siguruar mbështetje të fuqishme ndërkombëtare për sovranitetin e Kosovës. Strategjia jonë përfshin rritjen e partneriteteve me vendet fqinje dhe entitetet rajonale për ta promovuar sigurinë dhe stabilitetin reciprok. Për ta mbrojtur shtetin tonë, ne do të investojmë në modernizimin e infrastrukturës ushtarake, rritjen dhe modernizimin e kapaciteteve të forcave tona mbrojtëse, duke përfshirë ngritjen e gardës kombëtare me të gjitha strukturat e parapara dhe sigurimin e gatishmërisë së tyre. Duke zhvilluar korniza të sofistikuara

të inteligjencës, veçanërisht në luftën kundër kërcënimeve kibernetike dhe dezinformative, si dhe duke integruar sigurinë mjedisore në strategjinë tonë kombëtare të mbrojtjes, ne do të ndërtojmë një sistem mbrojtës agjil dhe të gatshëm për të ardhmen.

Do t'i vlerësojmë dhe modernizojmë vazhdimisht kapacitetet ushtarake, duke përfshirë zhvillimin e Gardës Kombëtare. Zhvillimi i Gardës Kombëtare të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) është një hap kritik drejt forcimit të qëndrueshmërisë së Kosovës, në përputhje me kornizën e NATO-s "NATO 2030" dhe thellimin e partneritetit strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Garda Kombëtare do të rritë gatishmërinë civile të Kosovës, duke bashkuar sektorët ushtarakë dhe civilë për t'iu përgjigjur më mirë kërcënimeve të jashtme dhe emergjencave të brendshme. Kështu, Kosova do të krijojë një infrastrukturë të adaptueshme që mbështet mobilizimin e shpejtë, menaxhimin e krizave dhe reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë. Garda Kombëtare jo vetëm që forcon aftësitë mbrojtëse të Kosovës, por fuqizon edhe civilët me aftësi dhe përgjegjësi thelbësore, duke ndërtuar një qasje kohezive të mbrojtjes kombëtare që mbron nga sfidat në zhvillim të sigurisë dhe promovon stabilitetin në vend dhe në të gjithë rajonin.

Do t'i forcojmë institucionet përgjegjëse për sigurinë dhe mbrojtjen kombëtare për të siguruar bashkëpunim efektiv ndërinstitucional. Do t'i përditësojmë rregullisht ligjet e sigurisë kombëtare dhe të mbrojtjes për t'i trajtuar kërcënimet bashkëkohore bazuar në rishikimin periodik të sektorit të sigurisë, të cilin do ta institucionalizojmë. Do të zhvillojmë një strategji afatgjatë të sigurisë kombëtare dhe mbrojtjes në përputhje me synimet më të gjera të zhvillimit të shtetit.

Do të vendosim një kornizë gjithëpërfshirëse të sigurisë kibernetike për ta rritur ndërgjegjësimin e publikut për luftën e informacionit. Do t'i përmirësojmë aftësitë për mbledhjen dhe analizën e inteligjencës, si dhe zhvillimin e masave të fuqishme të kundërzbulimit të AKI-së.

3. FUQIZIMI I PARTNERITETEVE STRATEGJIKE NDËRKOMBËTARE DHE PËRSHPEJTIMI I INTEGRIMIT NË NATO. Do të thellojmë lidhjet tona me ShBA-në, NATO-n dhe organizatat e tjera ndërkombëtare për ta forcuar pozicionimin strategjik dhe kapacitetet e sigurisë dhe mbrojtjes së Kosovës. Duke shfrytëzuar vendndodhjen strategjike të Kosovës, do të propozojmë iniciativa të veçanta kontributdhënëse në mes të Kosovës dhe NATO-s, të cilat do ta lehtësojnë rrugën tonë drejt anëtarësimit të plotë në NATO, duke e siguruar vendin brenda komunitetit global të mbrojtjes. Do

ta shtojmë bashkëpunimin ndërkombëtar, veçanërisht me ShBA-në dhe NATO-n, për ta rritur kapacitetin e sigurisë dhe mbrojtjes së Kosovës.

4. PROMOVIMI I NJË KONCEPTI GJITHËPËRFSHIRËS TË SIGURISË NJERËZORE DHE KOHEZIONIT SHOQËROR.

Do t'i mbrojmë qytetarët nga kërcënimet fizike, psikologjike dhe ekonomike përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse të fokusuar në sigurinë njerëzore, e cila thekson të drejtat e njeriut dhe kohezionin social. Do të ofrojmë sigurim të plotë shëndetësor dhe jetësor për pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës, policisë, AKI-së dhe zjarrfikësve, duke siguruar mirëqenien dhe gatishmërinë e tyre operacionale. Për t'i luftuar ideologjitë radikale, ne do të zbatojmë strategji gjithëpërfshirëse që promovojnë kohezionin social dhe një identitet shtetëror të rrënjësor në vlerat demokratike. Do të zhvillojmë një qasje gjithëpërfshirëse për ta luftuar dhunën ndaj grave, duke integruar njësi të specializuara policore, shërbime të përkushtuara mbështetëse, trajnime të synuara dhe fushata të ndërgjegjësimit publik, që sigurojnë një përgjigje gjithëpërfshirëse dhe efektive për mbrojtjen dhe fuqizimin e grave në mbarë Kosovën.

5. RITJA E SIGURISË PUBLIKE PËRMES FUQIZIMIT TË KAPACITETEVE POLICORE DHE ANGAZHIMIT TË KOMUNITETIT.

Do ta rrisim sigurinë publike, duke ristrukturuar policinë bazuar në të dhënat e popullsisë dhe krimin, si dhe duke investuar në iniciativa për ngritjen e kapaciteteve. Nëpërmjet policimit në komunitet do të ndërtojmë besim dhe do ta nxisim ndërveprimin e rregullt midis policisë dhe komuniteteve, duke inkurajuar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit. Për ta parandaluar përfshirjen e të rinjve në aktivitete të paligjshme, do të zhvillojmë programe të synuara që promovojnë angazhim pozitiv të komunitetit. Duke integruar sisteme të avancuara monitorimi dhe analiza të të dhënave, do ta ulim krimin në mënyrë më efektive dhe do ta përmirësojmë sigurinë e përgjithshme publike.

6. FORCIMI I KAPACITETEVE TË POLICISË SË KOSOVËS PËR HETIMET FINANCIARE.

Forcimi i hetimeve financiare në rastet e korrupsionit, krimin të organizuar, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe veprave të ngjashme kërkon ngritjen e kapaciteteve përmes përgatitjes, trajnimit dhe certifikimit të më shumë ekspertëve financiarë. Kjo mund të arrihet me mbështetjen e partnerëve përmes projekteve si IPA apo ICITAP. Procesi i certifikimit për hetuesit financiarë filloi në tetor 2014 me trajnim profesional të financuar nga BE-ja, ku shtatë zyrtarë nga agjenci të ndryshme zbatuese të ligjit, përfshirë Policinë e Kosovës, Administratën Tatimore, Doganat dhe Bankën Qendrore, u certifikuan. Që nga viti 2014 nuk janë zhvilluar më procese certifikimi, prandaj është e domosdoshme të zhvillohet më tej kjo fushë për t'i rritur hetimet financiare, duke mundësuar më shumë raste të sekustrimeve dhe konfiskimeve përfundimtare. Për hetime efektive dhe konfiskime përfundimtare është esenciale të kemi ekspertë financiarë të trajnuar, të cilët do t'i përgatisin rastet në mënyrë

të plotë për organet e drejtësisë.

7. RITJA E EFIKASITETIT TË POLICISË PËR TRAJTIMIN E RASTEVE.

Duhet të hartohet një plan veprimi dhe të angazhohen burimet më profesionale të policisë për hetime proaktive, duke përfshirë grumbullimin dhe analizën e informacionit dhe inteligjencës për iniciimin e rasteve. Këto çështje duhet të përfshihen në Strategjitë Kombëtare dhe planet e veprimit nën përgjegjësinë e MPB-së dhe policisë si institucion i zbatimit të ligjit. Duhet të përcaktohen standarde dhe objektiva të matshme për parandalimin dhe hetimin e krimeve të profilit të lartë. Është i domosdoshëm forcimi i kapaciteteve të Njësisë së Veçantë të Hetimeve, rritja e bashkëpunimit me Prokurorinë Speciale, shtimi i hetuesve dhe ekspertëve të fushave të nevojshme si ekspertë financiarë dhe fuqizimi i kapaciteteve të inteligjencës dhe analizës.

8. RITJA E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR POLICOR.

Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar është thelbësore për efikasitetin e Policisë së Kosovës në luftën kundër krimin të organizuar, krimin transkufitar, terrorizmit dhe krimeve të tjera si trafikimi i narkotikëve, migrantëve, qenieve njerëzore dhe pastrimi i parave. Aktualisht, Policia e Kosovës ka rreth 100 marrëveshje ndërkombëtare dhe ka marrëveshje me EUROPOL-in, por pjesëmarrja në hetime të përbashkëta ndërkombëtare dhe operacione të mëdha ka rënë dukshëm. Nuk ka ekipe hetimore të përbashkëta apo operacione të rëndësishme ndërkombëtare me përfshirjen e Kosovës. Për ta ndërtuar besimin reciprok dhe për ta përmirësuar bashkëpunimin është i nevojshëm forcimi i lidhjeve me shtetet e rajonit përmes vlerësimeve (si raportet SOCTA), hetimeve dhe operacioneve të përbashkëta. Po ashtu, Policia e Kosovës duhet të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi me më shumë shtete për ta përforcuar më tej bashkëpunimin policor.

9. ZHVILLIMI I NJË SISTEMI TË FUQISHËM TË MENAXHIMIT TË KRIZAVE DHE REAGIMIT NDAJ EMERGJENCAVE.

Do të krijojmë një kornizë të integruar të menaxhimit të krizave që garanton koordinim efektiv midis të gjithë akterëve përballë fatkeqësive natyrore dhe emergjencave. Duke investuar në sistemet e paralajmërimit të hershëm dhe teknologji të tjera të avancuara të mbrojtjes, do ta rrisim sigurinë kombëtare dhe qëndrueshmërinë mjedisore. Fokusi ynë në ngritjen e kapaciteteve njerëzore do të sigurojë që i gjithë personeli i sigurisë të marrë trajnim dhe mbështetje të vazhdueshme, duke i pajisur ata për t'i trajtuar sfidat moderne me sukses. Do të zhvillojmë një kuadër efektiv për menaxhimin e krizave për emergjencat dhe fatkeqësitë natyrore. Do të investojmë në teknologjitë e avancuara të paralajmërimit të hershëm dhe integrimin e sigurisë mjedisore në planifikimin e sigurisë kombëtare. Do t'i shtojmë kapacitetet ajrore për emergjencat civile, duke krijuar një sistem gjithëpërfshirës të kujdesit paraspitalor të integruar me aftësitë e avancuara të reagimit ndaj emergjencave civile dhe duke siguruar qasje të shpejtë në shërbimet mjekësore që shpëtojnë jetë në mbarë Kosovën.

74

ART DHE KULTURË PËR TË GJITHË



PDK

14. ART DHE KULTURË PËR TË GJITHË



VEPRIMET E PROPOZUARA

1. STRATEGJIA E RE PËR KULTURËN PËR TA PROMOVUAR POTENCIALIN KRIJUES DHE EKONOMINË KREATIVE. PDK-ja do të krijojë një strategji të re për kulturën, duke identifikuar dhe zhvilluar potencialet krijuese në bashkëpunim me komunitetin. Në përputhje me kartën ndërkombëtare që garanton të drejtën e fëmijëve për pjesëmarrje në jetën kulturore dhe artistike, strategjia do të përfshijë masa për edukimin formal të fëmijëve në sferën kulturore dhe stimulimin e ideve kreative në kulturë dhe inovacion. Strategjia do ta promovojë turizmin kulturor dhe ekonominë kreative, duke vendosur artistin si qytetar dhe aktivist që përparon përmes kulturës. Prioritete do të jenë digjitalizimi i përmbajtjeve kulturore, rritja e institucionit dhe krijimi i një baze të dhënash për krijuesit e Kosovës.

2. FUQIZIMI I PAVARËSISË SË INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË KULTURËS PËRMES DEPOLITIZIMIT DHE RITJES SË INVESTIMEVE. Ne do ta fuqizojmë pavarësinë e institucioneve publike të kulturës përmes masave juridike për depolitizimin dhe strukturimin e tyre. Kjo do ta përfshijë rritjen e buxhetit për institucionet si Teatri Kombëtar, Filarmonia e Kosovës, Galeria Kombëtare, Agjencia Shtetërore e Arkivave, Biblioteka Kombëtare, Baleti Kombëtar, Qendra Kinematografike, Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve "Shota", duke ndihmuar në menaxhimin dhe renovimin e tyre. Do ta mbështesim ndërtimin e qendrave kulturore multifunkionale që shërbejnë për nevojat e të gjitha komuniteteve dhe do të investojmë

në adaptimin e godinave të vjetra dhe krijimin e objekteve të reja për kulturën. Interesim të veçantë do t'u kushtojmë teatrove komunale dhe artistëve të tyre. Do të krijojmë kushte më të mira për performancat e tyre artistike në teatrot që do t'i rinovojmë dhe do të investojmë në objekte të reja teatrore. Do të shqyrtohet një model hibrid për përfshirjen e aktiviteteve nga sektorë të ndryshëm. Prioritet do të jetë pasurimi i koleksioneve të bibliotekave, muzeve dhe galerive, si dhe digjitalizimi i fondeve kulturore për të ofruar një qasje më të gjerë për publikun. PDK-ja do ta rrisë mbështetjen për krijim dhe ekspozim të veprave artistike nga individë me nevoja të veçanta dhe do t'i pasurojë bibliotekat me literaturë për të verbrit dhe materiale të regjistruara për konsum më të lehtë të tyre. Do ta rrisë mbështetjen për veprimtarinë botuese dhe krijuesit do t'i subvencionojë çdo vit për realizim të projekteve kolektive dhe individuale brenda dhe jashtë vendit.

3. ADAPTIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE, SI PROMOTORE E VLERAVE IDENTITARE, PËR T'I SHËRBYER JETËS BASHKËKOHORE. Asetet kulturore do të mund të gjenerojnë të ardhura vetjake përmes një qasjeje të integruar dhe partneritetit publiko-privat, duke u bazuar në standardet e ICOMOS dhe parimet e UNESCO-s, me synimin që të prodhojnë vlerë ekonomike dhe të mirëmbahen vetë. Do të angazhohemi për parandalimin e gjurmëve ilegale dhe do të fokusohemi në konservimin dhe restaurimin e aseteve të trashëgimisë, me vëmendje të veçantë për objektet me vlerë historike dhe shpirtërore për të gjitha komunitetet etnike në Kosovë. Po ashtu, do të stimulojmë projekte të shoqërisë civile që edukojnë brezin e ri për rëndësinë e trashëgimisë historiko-kulturore dhe do ta rrisim buxhetin dhe kapacitetet e Institutit të Arkeologjisë për pasurimin e burimeve materiale. Gjithashtu, do ta shtojmë numrin e inspektorëve të trashëgimisë kulturore dhe nëpërmjet tyre do ta shtojmë kujdesin për objektet që janë nën mbrojtjen e Ligjit për Trashëgiminë Kulturore.

4. STIMULIMI I BASHKËVEPRIMIT NDËRETNIK DHE DIPLOMACISË KULTURORE. Ne kemi për qëllim t'i nxisim shkëmbimet kulturore ndëretnike brenda Kosovës për të krijuar mundësi të reja komunikimi dhe njohjeje për gjeneratat e reja. Shkëmbimet kulturore regjionale do të kenë prioritet për ta forcuar paqen dhe sigurinë. Do ta rrisim mbështetjen për festivalet vendore me karakter ndërkombëtar përmes masave më të mëdha financiare dhe logjistike. Do ta fuqizojmë praninë e artit në institucionet dhe hapësirat publike, duke mundësuar edhe blerjen e veprave për këto institucione. Programi "Arti në Ambasada" do të zgjerohet për t'i shfaqur vlerat e Kosovës ndërkombëtarisht, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës dhe me Ministrinë e

Kulturës. PDK-ja do ta mbështesë pjesëmarrjen e Kosovës në festivale ndërkombëtare dhe do ta promovojë bashkëpunimin me qytetet krijuese për t'i forcuar identitetet lokale dhe për ta stimuluar rritjen ekonomike. Për çdo vit, nëpërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, do të hapim thirrje të veçantë për mërgatën tonë, për realizim të projekteve kulturore, shkencore dhe arsimore dhe për promovim të kulturës sonë në të gjitha vendet që ka mërgatë shqiptare.

5. MBËSHTETJA E EKONOMISË KREATIVE PËR ZBATIMIN E TË DREJTËS SË AUTORIT. Për më shumë se dhjetë vjet është tentuar nga komuniteti i industrisë kreative, që përmes iniciativës vetjake të zhvillohen shoqatat për menaxhim kolektiv. Ky objektivi nuk ka rezultuar me sukses, prandaj pa subvencionimin shtetëror, funksionalizimi dhe operimi fillestar i tyre është mjaft i vështirë. Në këtë kontekst planifikohet stimulimi financiar i tyre. Në bashkëveprim me mekanizmat e sigurisë dhe organet juridike, do ta riaktualizojmë angazhimin institucional kundër piraterisë, falsifikimit dhe shkeljeve të tjera eventuale në rrafshin e të drejtave të autorit dhe atyre të përafërta. Me këtë rast, veç të tjerash, parashihet edhe mbështetja për kampanjat e shoqërisë civile që kanë për synim shpërndarjen e informacionit dhe pasurimin e vetëdijes kolektive në raport me rëndësinë e po këtyre të drejtave.

6. ZHVILLIMI I QYTETEVE KREATIVE DHE TURIZMIT KULTUROR. Do ta rrisim bashkëpunimin në mes të nivelit qendror dhe lokal për t'i mbështetur iniciativat kulturore dhe zhvillimin e qyteteve kreative. Këto qytete, si qendra të inovacionit dhe kulturës, do të kenë mundësi të avancohen në rrjetin global të komunikimit dhe të krijojnë impakt ekonomik pozitiv. PDK-ja do t'i mbështesë komunat për renovimin, restaurimin dhe ndërtimin e objekteve kulturore sipas nevojave të identifikuar në analiza paraprake. Kjo do të kontribuojë në forcimin e identiteteve lokale dhe në stimulimin e aktiviteteve kulturore, duke krijuar mundësi të reja për zhvillim dhe turizëm kulturor.

7. NDËRTIMI I QENDRËS KOMBËTARE TË ARTEVE PERFORMUESE NË KOSOVË. Kosova ka një trashëgimi kulturore të pasur dhe potencial të madh për zhvillimin e artit, duke e bërë të domosdoshëm ndërtimin e Qendrës Kombëtare të Arteve Performuese. Kjo qendër do të shërbejë si një platformë për Teatrin Kombëtar, Operën, Filarmoninë dhe Baletin Kombëtar. Ajo do të ketë salla të dedikuara për performanca në një ambient të aksesueshëm në rrethinat e Prishtinës, me hapësira të mjaftueshme për parkim. Përveç sallës kryesore, do të ketë një sallë multifunkionale për ngjarje të mëdha dhe hapësira për prova dhe administratë. Ndërtimi i Qendrës Kombëtare do të krijojë një mjedis inovativ për artin dhe kulturën, duke kontribuar në promovimin e artistëve vendas dhe rritjen e turizmit kulturor, duke e vendosur Kosovën në hartën e aktiviteteve kulturore dhe artistike. Gjithashtu, po në këtë qendër, do të krijojmë hapësirë të përshtatshme edhe për organizim të panairëve të librave e festivaleve.

8. NDËRTIMI I GALERISË KOMBËTARE TË ARTEVE PAMORE NË KOSOVË. Ndërtimi i Galerisë Kombëtare të Arteve Pamore do të ofrojë hapësirë për promovimin e artit dhe kulturës, duke krijuar një identitet kulturor të fortë dhe duke nxitur edukimin publik. Galeria do të ketë hapësira për ekspozita të përhershme dhe të përkohshme, duke shërbyer si qendër për artistët dhe dashamirësit e artit, si dhe për ngjarje kulturore dhe ekspozita ndërkombëtare. Ajo do ta përfshijë artin tradicional, modern dhe bashkëkohor, si film, fotografi, animacione, grafika dhe instalacione. Një qendër edukative do të ofrojë programe për të rinjtë dhe hapësira kërkimore për studiues, duke ndihmuar në zhvillimin e talenteve të reja dhe bashkimin e komunitetit artistik. Galeria do të ndihmojë në promovimin e trashëgimisë kulturore dhe rritjen e turizmit, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe social të Kosovës përmes artit dhe kulturës.

9. NDËRTIMI I SHKOLLËS SË RESTAURIMIT DHE KONSERVIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE SI DHE REHABILITIMI I QENDRAVE HISTORIKE TË KOSOVËS. Kosova ka një trashëgimi kulturore të pasur, por qendrat historike si Prishtina, Prizreni, Gjakova, Peja, Vushtrria dhe Mitrovica janë dëmtuar ndër vite. Ndërtimi i një Shkollë të Restaurimit është thelbësor për ruajtjen e kësaj trashëgimie dhe rikthimin e identitetit unik të këtyre qyteteve. Shkolla do të ofrojë programe të specializuara për konservimin e objekteve historike dhe do të trajtojë profesionistë për teknikat tradicionale dhe moderne të restaurimit. Projekti i restaurimit do ta përfshijë rindërtimin e pazareve historike dhe monumenteve, duke i kthyer ato në qendra për turizëm, artizanat dhe kulinari tradicionale. Pjesëmarrja aktive e komunitetit në aktivitetet e restaurimit do ta forcojë ndjenjën e përgjegjësisë për trashëgiminë lokale. Ky proces do ta përmirësojë atraktivitetin turistik të Kosovës dhe do ta nxisë zhvillimin ekonomik përmes turizmit kulturor dhe krijimit e mundësive të reja të punësimit. Një konkurs ndërkombëtar për restaurim do të sjellë ide të reja nga ekspertët botërorë, duke siguruar ndikim të qëndrueshëm në trashëgiminë kulturore për brezat e ardhshëm.

10. NDËRTIMI I MEMORIALIT TË GJENOCIDIT NË KOSOVË. Do të propozohet ndërtimi i një Memoriali të Gjenocidit, i cili do të shërbejë si një pikë përkujtimore kombëtare për t'i nderuar viktimat e gjenocidit dhe krimeve të luftës në Kosovë. Ky memorial do të krijohet për të reflektuar mbi dhimbjen dhe humbjet e përjetuara, duke u kthyer në një hapësirë përkujtimi dhe nderimi për ata që humbën jetën. Memoriali do të jetë një simbol i përpjekjeve të Kosovës për drejtësi e pajtim dhe do të shërbejë si një kujtesë kolektive për brezat e ardhshëm mbi rëndësinë e respektimit të të drejtave të njeriut dhe përbaljes me të kaluarën. Për ndërtimin dhe dizajnimin e këtij memoriali do të shpallet një konkurs ndërkombëtar, me qëllim që të sigurohet një dizajn që reflekton përmasat historike dhe simbolike të projektit.

15

TURIZMI NË
FUNKSION TË
ZHVILLIMIT



PDK

15. TURIZMI NË FUNKSION TË ZHVILLIMIT



VEPRIMET E PROPOZUARA

1. KRIJIMI I AGJENCISË KOMBËTARE PËR PROMOVIMIN DHE MBËSHETJEN E TURIZMIT. Nevoja për politika ndërsektoriale dhe të specializuara për sektorin turistik e bën të domosdoshëm krijimin e një Agjencie Kombëtare për Turizmin. Ky institucion do të luajë një rol kyç në hartimin e strategjive gjithëpërfshirëse për zhvillimin e turizmit, promovimin e Kosovës si destinacion turistik dhe bashkëpunimin me akterët ndërkombëtarë për të tërhequr investime. Agjencia do ta mbështesë modernizimin e infrastrukturës turistike dhe krijimin e kushteve të favorshme për sektorin privat. Ajo do të vendoset në përkujdesjen e Zyrës së Kryeministrit në mënyrë që të sigurojë qasje në të gjitha institucionet shtetërore që lidhen drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë me zhvillimin e turizmit. Përmes Agjencisë Kombëtare për Turizmin do të zhvillohen programe për përfshirjen e komunitetit lokal dhe krijimin e partneriteteve publiko-private për nxitjen e inovacionit në turizëm.

2. INVESTIME PUBLIKE PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT DIMËROR DHE MALOR. Do të zhvillojmë dhe zbatojmë një plan gjithëpërfshirës të investimeve në infrastrukturën publike në Brezovicë dhe Borea, përfshirë rrugët, skiliftet dhe shërbimet thelbësore. Do të krijojmë një mjedis të favorshëm për tërheqjen e investimeve të sektorit privat në këto dy resorte skijimi, duke promovuar kështu Kosovën si destinacion kryesor i skijimit në rajon. Me rëndësi të veçantë do të

studiohen mundësi për pista të reja skijimi e komplekse të turizmit dimëror më afër qendrave të mëdha urbane sikurse janë Prizreni, Deçani dhe Peja, në mënyrë që këto projekte të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien e qytetarëve të Kosovës. Ndërtimi i kompleksit të sporteve malore në lartësitë e Sharrit, pranë Prizrenit, jo vetëm që do ta nxisë masivizimin e sporteve dimërore në Kosovë, por do të mundësojë edhe organizimin e garave shtetërore dhe ndërkombëtare që do ta nxisin turizmin e lidhur me këto evente. Investimet infrastrukturore për sportet dimërore do të ndihmojnë në krijimin e një destinacioni tërheqës për turistët vendorë dhe të huaj, duke ndihmuar zhvillimin e zonave rurale dhe qendrave të rëndësishme urbane të Kosovës.

3. TURIZMI SPORTIV DHE I AVENTURËS. Kosova ofron kushte ideale për zhvillimin e turizmit sportiv dhe të aventurës. Do të promovojmë aktivitete si paragliding, vozitje me kanoe, ngasje me makina dhe sporte malore që tërheqin vizitorët e apasionuar pas natyrës. Zhvillimi i këtij lloji turizmi do të sjellë jo vetëm të ardhura, por edhe do ta promovojë imazhin e Kosovës si një destinacion atraktiv për sportet e aventurës. Një nga nismat kyçe në këtë drejtim do të jetë ndërtimi i Parkut Olimpik të Kosovës, një projekt i rëndësishëm që do të shërbejë për organizimin e garave ndërkombëtare dhe si pjesë e përgatitjeve për Lojërat Mesdhetare që do të zhvillohen në vend. Ky kompleks do t'i përmbushë standardet më të larta për organizimin e garave dhe ndeshjeve të nivelit ndërkombëtar, duke ofruar një ambient të përshtatshëm dhe të avancuar për sportistët profesionistë, studentët dhe qytetarët e thjeshtë që janë të apasionuar pas sporteve të aventurës. Për ta mbështetur këtë zhvillim do të ndërmerren masa shtesë, duke përfshirë trajnimin dhe licencimin e udhëzuesve të specializuar, si dhe ndërtimin e terreneve, fushave, poligoneve dhe qendrave të dedikuara për sporte ekstreme në kuadër të Parkut Olimpik. Sportet e aventurës janë, gjithashtu, një mënyrë për të tërhequr një audiencë të re, duke zgjeruar gamën e turistëve që vizitojnë Kosovën.

4. POTENCIALI I TURIZMIT KULTUROR. Kosova ka një trashëgimi kulturore të pasur, që përfshin monumente historike, vende arkeologjike, kisha, xhami dhe tradita të vjetra që përbëjnë një aset të çmuar për turizmin kulturor. PDK-ja do të përqendrohet në promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, duke nxitur aktivitete kulturore dhe artistike që tërheqin vizitorë nga brenda dhe jashtë vendit. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet restaurimit të monumenteve të rëndësishme historike dhe krijimit të itinerareve kulturore, që vizitorët të mund ta përjetojnë historinë dhe kulturën unike të Kosovës. Aktivitetet si festivale folklorike, panairë artizan-

le dhe ekspozita artistike do të kontribuojnë në zhvillimin e këtij sektori, duke ofruar një përvojë të pasur kulturore për turistët dhe duke krijuar një lidhje më të thellë me identitetin kombëtar. Po ashtu, do të subvencionohen dhe inkurajohen nismat private të artizanatit, të cilat jo vetëm që do të shërbejnë për të mbajtur gjallë e për të trashëguar brez pas brezi trashëgiminë tonë kulturore, por do ta pasurojnë ofertën turistike duke ofruar produkte unike dhe tërheqëse për vizitorët.

5. NXITJA E AGROTURIZMIT DHE ZHVILLIMI I ZONAVE RURALE. Agroturizmi përbën një potencial të madh për zhvillimin e turizmit në zonat rurale të Kosovës. Ne do të mbështesim zhvillimin e agroturizmit, duke promovuar jetën tradicionale rurale, kulinarinë tipike dhe mikpritjen e popullit tonë. Në këtë mënyrë do të rriten të ardhurat dhe do të hapen vende të punës në zonat rurale, duke kontribuar njëkohësisht në zbutjen e varfërisë në këto zona. Agroturizmi mund të shfrytëzohet si një strategji për ta diversifikuar ekonominë rurale dhe për ta promovuar qëndrueshmërinë në bujqësi.

6. PROMOVIMI NDËRKOMBËTAR I TURIZMIT TË KOSOVËS. Në kushtet e konkurrencës ndërkombëtare, promovimi i Kosovës si destinacion turistik është kyç për suksesin e këtij sektori. Do t'i angazhojmë kompanitë më cilësore të marketingut për të ndihmuar në pozicionimin e Kosovës në tregjet ndërkombëtare. Po ashtu, rrjeti diplomatik dhe diaspora do të jenë pjesë e strategjisë për promovimin e imazhit të Kosovës si një vend me oferta të larmishme turistike. Promovimi ndërkombëtar do të përqendrohet në krijimin e një imazhi të fortë dhe të besueshëm të Kosovës në tregjet globale.

7. NGRITJA E BURIMEVE NJERËZORE NË SEKTORIN E TURIZMIT. Do të angazhohemi për rritjen e cilësisë së burimeve njerëzore në sektorin e turizmit, duke ofruar programe trajnimi dhe bursa për kuadro të rinj. Kjo do të ndihmojë në rritjen e profesionalizmit dhe përmirësimin e shërbimeve të ofruara në fushën e hotelerisë dhe gastronomisë, duke siguruar që Kosova të jetë konkurruese në tregun ndërkombëtar turistik. Investimet në trajnime dhe edukimin e stafit turistik janë vendimtare për ofrimin e përvojave të standardeve të larta për turistët vendas dhe të huaj.

16

KOSOVA, SHTET I SPORTIT DHE SPORTISTËVE ELITARË



PDK

16. KOSOVA, SHKET I SPORTIT DHE SPORTISTËVE ELITARË



VEPRIMET E PROPOZUARA

1. MBËSHETJJA E SHKOLLAVE DHE KLUBEVE SPORTIVE PËR ZHVILLIMIN E TALENTËVE VENDORË. Shkollat e sportit dhe klubet sportive janë adresat kryesore të zhvillimit të sportistëve të rinj dhe atyre elitare. Në mënyrë që ato të shndërrohen në fabrika të prodhimit duhet që të ketë kritere të mirëdefinuara të licencimit dhe kategorizimit nga të cilat do të përfitojnë të gjithë, por fokusin kryesor të përkrahjes infrastrukturale dhe financiare do ta kenë ato që brenda tyre zhvillojnë programe të mirëfillta të zhvillimit të talentëve vendorë në bazë të sistemit: të mësosh ta duash sportin, të mësosh të trajnohesh, të trajnohesh për të garuar dhe të mësosh për të fituar. Shkollat dhe klubet që angazhojnë numër më të madh mësuesish dhe ekspertësh të fushave (edukatë fizike, mjekësi sportive, psikologji e sportit, nutricionizëm, etj.), numër më të madh anëtarësh dhe rezultate kulmore sportive, do të kenë stimuj të veçantë financiarë.

2. KRIJIMI I NJË DATABAZE PËR SPORTISTËT POTENCIALË ELITARË. Për sportistët potencialë elitare do të krijohet një databazë dhe sistem i integruar i identifikimit dhe përcjelljes së zhvillimit nga sistemi shkollor fillor e deri te inkuadrimi i tyre në shkolla dhe klube, në bashkëpunim me drejtoritë komunale për sport dhe arsimtarët e edukatës fizike të shkollave fillore dhe të mesme. E në bashkëpunim me federatat e sporteve përkatëse do të etablohen qendrat kombëtare të zhvillimit.

3. SENSIBILIZIMI I TË GJITHËVE PËR RËNDËSINË E SPORTIT DHE PRAKTIKIMIT TË AKTIVITETEVE FIZIKE. Së bashku me Komitetin Olimpik, federatat sportive, drejtoritë komunale për sport dhe Fakultetin e Edukatës Fizike dhe të Sportit, do të bëhet kalendari i të gjitha ngjarjeve sportive dhe aktiviteteve që lidhen me to sipas sporteve të caktuara. Promovimi i sporteve nëpër shkolla është shkathtësi e vlefshme që fuqizon avokimin e përfshirjes dhe mbështetjen e edukimit sportiv në institucionet e edukimit. Kjo shkathtësi përfshin kuptimin e rëndësisë së aktiviteteve fizike, punën e ekipore dhe disiplinën në zhvillimin e nxënësve. Për fuqinë punëtore moderne, promovimi i sportit nëpër shkolla do të thotë të krijosh individë të përgatitur që nuk kanë vetëm njohuri akademike, por edhe përgatitjen fizike, shkathtësitë për lidhshmëri dhe sensin për komunitetin. Të gjitha këto duhet të integrohen nëpër platforma, portale dhe rrjete sociale informative, ku nxënësit dhe qytetarët kanë qasje dhe mund të përfitojnë varësisht nga nevojat e tyre.

4. SISTEMI I PUNËSIMIT, FINANCIMIT DHE SHPËRBLIMIT TË MËSUESVE DHE TRAJNERËVE. Mësuesit e edukatës fizike dhe të sportit do të angazhohen si staf i ri me pagesa të rregullta nga klasa e parë. Po ashtu, fondi i orëve të edukatës fizike nëpër shkollat e mesme do të ngritet në normën një orë në ditë, për çdo ditë mësimore. Do të krijohen lidhjet komunale të mësuesve të edukatës fizike dhe të sportit me qëllim të koordinimit të të gjitha planprogrameve dhe aktiviteteve. Nga kjo lidhje dhe nga buxheti qendror do të ndahen mjete financiare për avancimin profesional të këtyre kuadrove të angazhuara dhe të kuadrit ekzistues.

5. PLANIFIKIMI I VAZHDUESHËM PËR NDËRTIMIN E OBJEKTEVE TË REJA DHE SHFRYTËZIMIN MË TË MIRË TË OBJEKTEVE EKZISTUESE. Në çdo qytet të Kosovës do të ketë hapësira të reja sportive për të gjitha sportet dhe do të iniciohet makroplani nacional: Një lagje - një fushë sporti. Do të rirregullohen për shfrytëzim të efektshëm të gjitha objektet ekzistuese. Do të themelohet, ndërtohet e zhvillohet Instituti i Ekspertizës dhe Performancës Sportive në bashkëpunim me Fakultetin e Edukatës Fizike dhe të Sportit, Komitetin Olimpik dhe të gjitha federatat nëpërmjet qendrave kombëtare të zhvillimit. Do të angazhohen ekspertët më të mirë të fushës nga vendi dhe nga jashtë me qëllim të përmirësimit të performancave sportive, si dhe zhvillimit sa më profesional të talentëve të të gjitha sporteve. Sportet individuale duhet ta kenë si bazë referimi xhodon, ndërkaq sportet kolektive duhet të kenë objektiva të qarta sa iu përket arritjeve të ekipeve dhe përfaqësuesve të Kosovës, sepse synojmë që patjetër deri në vitin 2030 të jemi nëpër kampionate evropiane dhe botërore me sporte si futbollli, basketbollli, volejbollli dhe hendbollli.

6. FINANCIMI ADEKUAT I NEVOJAVE TË SPORTIT DHE PËRMIRËSIMI I SHPËRNDARJES SË MJETEVE FINANCIARE.

Përveç përfitimeve që sjell Ligji për Sponsorizime, do të krijohen edhe mekanizma të tjerë me theks në rezultatet sportive dhe të arriturat kulmore në mënyrë që të ketë përfitime shtesë të shpërndara në formë të bonuseve dhe vauçerëve. Organizatat dhe klubet që në radhët e veta kanë organizime profesionale me kuadro të licencuara dhe që prodhojnë lojtarë dhe talentë të dëshmuar, do të shpërblehen në mënyrë të veçantë.

7. RRIJTJA E BASHKËPUNIMIT ME INSTITUTET SPORTIVE VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE.

Do të stimulohet financiarisht dhe profesionalisht bashkëpunimi i të gjitha institucioneve tona sportive, me të gjitha institucionet prestigjioze sportive ndërkombëtare nga të cilat Kosova dhe sportistët e saj në të ardhmen mund të përfitojnë në të gjitha format dhe do të stimulohen bashkëpunimet e tipit institut amë dhe degët e tij në Kosovë.

8. ZGJERIMI I ANËTARËSIMEVE DHE PJESËMARRJEVE NËPËR ORGANIZATA DHE ASOCIACIONE NDËRKOMBËTARE TË SPORTIT.

Duhet të zgjerohet dhe të përmbillet lista e anëtarësimit nëpër të gjitha organizatat dhe asociacionet ndërkombëtare të sportit, ashtu që edhe nga këto anëtarësime të përfitojnë institucionet tona sportive, federatat, klubet dhe sportistët. Që kjo të bëhet e mundur duhet të ekzistojë fondi special për lobim dhe anëtarësim. Në bashkëpunim me MPJ-në dhe institucionet e tjera që bëjnë diplomaci ekonomike dhe sportive duhet të krijohet një mekanizëm i rrjetëzimit për ta arritur qëllimin e plotë.

9. NGRITJA E CILËSISË SË PËRFAQËSIMIT NËPËR GARA DHE EVENTE NDËRKOMBËTARE.

Do të investojmë më shumë në ngritjen e cilësisë së përfaqësimit ndërkombëtar të sportistëve kosovarë, duke nisur nga stimujt financiarë që lidhen me rezultatet dhe të arriturat në skenën ndërkombëtare, deri te investimet në hulumtim dhe zhvillim bashkë me qendrat nacionale të zhvillimit dhe institutin e ekspertizës dhe performancës sportive, sepse pikërisht aty bëhen formulat e avancimit dhe zhvillimit që ndikojnë në ngritjen e konsiderueshme të cilësisë.

10. REHABILITIMI, MODERNIZIMI DHE REVITALIZIMI I PALLATIT TË RINISË DHE SPORTEVE NË PRISHTINË.

Pallati i Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë, simbol i identitetit urban dhe trashëgimisë kulturore, do të rehabilitohet dhe modernizohet për t'u kthyer në një qendër multifunksionale. Projekti parashikon rritjen e kapacitetit të sallës kryesore për 15 000 vizitorë dhe krijimin e hapësirave për ngjarje kulturore, sportive dhe shoqërore, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe turistik të Kosovës.

11. NDËRTIMI I STADIUMIT KOMBËTAR OLIMPIK TË FUTBOLLIT.

Ndërtimi i Stadiumit Kombëtar Olimpik është një projekt i rëndësishëm që synon të krijojë një qendër moderne dhe funksionale për futbollin dhe sportet e tjera të atletikës. Ky stadium do të ofrojë një infrastrukturë të avancuar që përfshin një terren futbollit sipas standardeve të FIFA-s dhe UEFA-s, hapësira për stërvitje dhe rekreacion, si dhe ambiente të përshtatshme për ngjarje sociale dhe kulturore. Stadiumi do të ketë hapësira për akademi futbollit, salla stërvitore dhe një kamp trajnimi për të rinjtë, duke ndihmuar në zhvillimin e talenteve të reja dhe rritjen e pjesëmarrjes në sport. Stadiumi Kombëtar Olimpik jo vetëm që do ta përmirësojë infrastrukturën sportive të vendit, por do të shërbejë edhe si simbol i krenarisë kombëtare dhe përkushtimit të Kosovës për zhvillimin e sportit dhe kulturës në një nivel më të lartë dhe do të ndihmojë në një organizim dinjitoz të Lojërave Mesdhetare.

17

**POLITIKA E JASHTME E
KOSOVËS: RRUGA PËR
PARTNERITET, NJOHJE,
SIGURI DHE ZHVILLIM**



PDK

17. POLITIKA E JASHTME E KOSOVËS: RRUGA PËR PARTNERITET, NJOHJE, SIGURI DHE ZHVILLIM



VEPRIMET E PROPOZUARA PËR DIPLOMACINË

1. RIKTHIM I PROCESIT TË NJOHJES NDËRKOMBËTARE TË PAVARËSISË DHE SOVRANITETIT TË KOSOVËS. Kosova duhet t'i vazhdojë përpjekjet për ta forcuar subjektivitetin ndërkombëtar, duke synuar ta rrisë numrin e njohjeve të reja nga vendet që ende nuk e kanë njohur pavarësinë. Përfundimi i këtij procesi është vendimtar për konsolidimin e sovranitetit të Kosovës në arenën ndërkombëtare dhe për forcimin e pozitës së saj në organizatat globale si Kombet e Bashkuara. Një diplomaci më proaktive në raport me vendet që nuk e kanë njohur ende pavarësinë, përfshirë shtetet e Azisë, Afrikës dhe Amerikës Latine, është thelbësore. Qëllimi strategjik është të arrihet që 2/3 e vendeve anëtare të Kombeve të Bashkuara ta njohin Kosovën në mandatin katërvjeçar.

2. SHTRIRJA DHE FORCIMI I SUBJEKTIVITETIT NDËRKOMBËTAR TË KOSOVËS NË FUSHËN MULTILATERALE, DUKE RRIUR PRANINË NË ORGANIZATA RAJONALE DHE NDËRKOMBËTARE.

Pjesëmarrja aktive e Kosovës në organizatat ndërkombëtare dhe rajonale si Këshilli i Evropës dhe OSBE-ja është një mënyrë për ta shtrirë më tej subjektivitetin ndërkombëtar dhe për ta forcuar pozicionin e Kosovës në botën multilaterale. Rritja e rolit dhe influencës në këto organizata do të ndihmojë në promovimin e interesave të Kosovës, përfshirë promovimin e demokracisë dhe zhvillimit ekonomik.

3. PROMOVIMI I AGJENDËS SË PAQE-NDËRTIMIT, MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE FORCIMIT TË DEMOKRACISË PËRMES ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE. PDK-ja synon ta avancojë politikën e jashtme të Kosovës përmes promovimit të vlerave universale të paqes dhe të drejtave të njeriut. Angazhimi i Kosovës në organizata ndërkombëtare si OKB-ja, BE-ja dhe OSBE-ja do të fokusohet në forcimin e demokracisë dhe zgjidhjen paqësore të konflikteve, duke ndihmuar në ndërtimin e imazhit të Kosovës si një shtet demokratik dhe paqedashës.

4. ANGAZHIM PËR MARRËVESHJE PËRFUNDIMTARE NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË, QË NËNKUPTON NJOHJEN E NDËRSJELLË DHE ANËTARËSIMIN NË OKB. Zgjidhja përfundimtare e konfliktit me Serbinë është një prioritet strategjik. Marrëveshja për njohjen e ndërsjellë midis Kosovës dhe Serbisë është vendimtare për të siguruar një paqe të qëndrueshme në Ballkan dhe për ta hapur rrugën e Kosovës drejt anëtarësimit në Kombet e Bashkuara. PDK-ja angazhohet për një dialog efektiv dhe të sinqertë që do të rezultojë në njohje reciproke dhe integrim të plotë ndërkombëtar.

5. ANËTARËSIMI NË KËSHILLIN E EVROPËS SI DËSHMI E KONSOLIDIMIT TË DEMOKRACISË DHE MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË NJERIUT. Kërkesa për anëtarësim në Këshillin e Evropës do ta tregojë përparimin e Kosovës në fushën e demokracisë dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Ky hap do ta forcojë angazhimin e vendit për standardet më të larta evropiane dhe do të kontribuojë në procesin e integritit të saj në strukturat euroatlantike.

6. THELLIMI I MARRËDHËNIEVE STRATEGJIKE BILATERALE ME SHBA-NË, NË NIVEL POLITIK, EKONOMIK, KULTUROR, SOCIAL PËRVEÇSE NË ATË TË SIGURISË. Kosova do të punojë fillimisht në riparimin e raporteve me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Një marrëdhënie strategjike dhe e fortë me SHBA-në është jetike për politikën e jashtme të Kosovës. Ne do të punojmë për zgjerimin e marrëdhënieve me ShBA-në përmes fushës së sigurisë, duke forcuar bashkëpunimin ekonomik dhe kulturor. Kjo përfshin projekte të përbashkëta në fushat e teknologjisë, arsimit dhe zhvillimit kulturor, duke bërë që lidhjet Kosovë - ShBA të bëhen më të fuqishme dhe të qëndrueshme.

7. VAZHDIMI I BASHKËPUNIMIT STRATEGJIK BILATERAL ME VENDET KYÇE EVROPIANE: GJERMANINË, FRANCËN, BRITANINË E MADHE, ITALINË. Thellimi i marrëdhënieve me partnerët kryesorë evropianë, Gjermaninë, Francën, Mbretërinë e Bashkuar dhe Italinë, do të ndihmojë në përparimin e procesit të integritit evropian të Kosovës. Këto vende janë mbështetës të fuqishëm të Kosovës në skenën

ndërkombëtare dhe kanë rol vendimtar në zhvillimin ekonomik dhe diplomatik të saj.

8. PROMOVIMI I FQINJËSISË SË MIRË DHE KONSTRUKTIVE ME TË GJITHA SHTETET E RAJONIT. Kosova do të mbetet e angazhuar për të ndërtuar marrëdhënie të mira me vendet fqinje dhe për ta promovuar stabilitetin rajonal. Fqinjësia e mirë është një nga gurët e themelit të politikës së jashtme të Kosovës dhe do të forcohet përmes bashkëpunimeve bilaterale dhe rajonale, duke kontribuar në sigurinë dhe zhvillimin e Ballkanit.

9. FUQIZIMI I BASHKËPUNIMIT RAJONAL DHE PJESËMARRJA NË ORGANIZATA DHE FORUME RAJONALE PËR SIGURINË DHE EKONOMINË. Kosova do ta rrisë përfshirjen në organizatat rajonale, veçanërisht në ato që kanë të bëjnë me sigurinë dhe ekonominë, si një mënyrë për ta përmirësuar stabilitetin dhe zhvillimin ekonomik në rajon.

10. PROMOVIMI DHE MBROJTJA E INTERESAVE DHE TË DREJTAVE TË PAKICAVE NË RAJON PËRMES MEKANIZMAVE TË BE-SË, KIE-SË DHE OSBE-SË. Kosova do të angazhohet për t'i mbrojtur të drejtat e pakicave në rajon, duke shfrytëzuar mekanizmat ekzistues evropianë dhe ndërkombëtarë si BE-ja, Këshilli i Evropës dhe OSBE-ja. Ky angazhim do ta forcojë imazhin e Kosovës si një shtet që respekton të drejtat e njeriut dhe promovon barazinë.

11. PRIORITETET PËR DIPLOMACINË EKONOMIKE DHE RRRITJEN E INVESTIMEVE TË HUAJA NË KOSOVË. Kosova do të përqendrohet në promovimin e interesave të saj ekonomike në skenën ndërkombëtare. Një diplomaci aktive ekonomike, që synon tërheqjen e investimeve të huaja dhe promovimin e produkteve dhe shërbimeve të Kosovës, do të jetë prioritet për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

12. ZGJERIMI DHE PËRMIRËSIMI I MISIONEVE DIPLOMATIKE DHE KONSULLORE. Do të angazhohemi për ta zgjeruar rrjetin e ambasadave dhe konsullatave të Kosovës në vendet strategjike për ta forcuar përfaqësimin e Kosovës dhe për t'i promovuar interesat e saj ekonomike, politike dhe kulturore në arenën ndërkombëtare. Riformatimi i sistemit të diplomacisë do të përfshijë rritjen e fondeve, depolitizimin, përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e profesionalizmit dhe sigurimin e bursave për specializimin e kuadrove të rinj.

13. REFORMA E SHËRBIMEVE KONSULLORE PËRMES OFRIMIT TË SHËRBIMEVE ONLINE DHE ME KOSTO TË ULËT. Kosova do ta reformojë sistemin e shërbimeve konsullore duke rritur qasjen në shërbime për qytetarët e saj përmes platformave digjitale, duke ulur kostot dhe përmirësuar cilësinë e këtyre shërbimeve.

14. PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË DIPLOMACISË ME RRRITJE TË FONDEVE, PËRMIRËSIM TË KUSHTEVE TË PUNËS DHE RRRIT-

JE TË PROFESIONALIZMIT. Reformat në sistemin diplomatik janë të nevojshme për ta përmirësuar funksionimin e tij. Ne synojmë t'i rrisim fondet për trajnime dhe bursat për diplomatë, për t'i përmirësuar kushtet e punës dhe për të garantuar që Kosova të ketë një diplomaci sa më profesionale dhe sa më efikase.

15. DIPLOMACIA PUBLIKE PËR PËRMIRËSIMIN E IMAZHIT TË KOSOVËS DHE MBËSHTETJEN PËR INTERESAT SHTETËRORE NË ARENËN NDËRKOMBËTARE. Diplomacia publike, përfshirë promovimin e artit, kulturës dhe sportit, do të jetë një nga mjetet kryesore për ta përmirësuar imazhin ndërkombëtar të Kosovës dhe për t'i promovuar interesat e saj strategjike në botë. Kjo përfshirje aktive do të kontribuojë në ngritjen e ndërgjegjësimit global për Kosovën si një shtet i qëndrueshëm, i angazhuar për paqe dhe zhvillim. Duke zhvilluar projekte të diplomacisë kulturore, Kosova do të krijojë ura bashkëpunimi me vende të ndryshme dhe do ta zgjerojë ndikimin e saj në skenën globale.

16. ANGAZHIMI I KOSOVËS SI NJË AKTORE E PËRGJEGJSHME NË ARENËN NDËRKOMBËTARE. Kosova do të angazhohet aktivisht për ofrimin e ndihmës humanitare në raste emergjente ndërkombëtare, përfshirë fatkeqësitë natyrore dhe krizat humanitare, duke treguar përgjegjësi dhe solidaritet në arenën ndërkombëtare. Në këtë mënyrë, Kosova do ta konsolidojë rolin e saj si një kontribuuese e rëndësishme për zgjidhjen e krizave globale dhe përforcimin e stabilitetit ndërkombëtar. Duke marrë pjesë në këto nisma, Kosova do t'i forcojë marrëdhëniet me aleatët ndërkombëtarë dhe do ta rrisë reputacionin e saj si një vend që kontribuon në zgjidhjen e sfidave globale.

17. MARRJA E KODIT TË SHTETIT 'TOP LEVEL DOMAIN' (TLD) PËR PROMOVIMIN E KOSOVËS NË INTERNET. Sigurimi i një kodi të veçantë për Kosovën në internet është një përparësi për ta rritur dukshmërinë globale dhe lehtësuar qasjen në tregjet ndërkombëtare për bizneset dhe institucionet e Kosovës. Ky kod do të jetë një mjet i rëndësishëm për promovimin e identitetit digjital të Kosovës dhe ndihmë për zhvillimin ekonomik.

VEPRIMET E PROPOZUARA PËR PROCESIN E INTEGRIMIT EVROPIAN

1. ANGAZHIMI PËR REFORMAT DHE PROCESIT PËR ANËTARËSIM NË BE. Do t'i shtyjme përpara reformat që përbushin kriteret e përcaktuara për anëtarësim në BE, duke synuar harmonizimin e legjislacionit të brendshëm me atë të BE-së. Procesi i reformave do të fokusohet në fusha kyçe si: sundimi i ligjit, transparenca institucionale dhe rrit-

ja e kapaciteteve administrative. Gjithashtu, do të përfshijë përmirësime në fushat e drejtësisë, luftës kundër korrupsionit dhe krijimin e një mjedisi të favorshëm për zhvillimin ekonomik.

2. KULTIVIMI I MARRËDHËNIEVE ME SHTETET ANËTARE TË BE-SË. Do të punojmë për rehabilitimin dhe thellimin e bashkëpunimit me shtetet anëtare të BE-së, duke ndërtuar dhe përmirësuar marrëdhëniet me pesë vendet që ende nuk e njohin Kosovën. Përmes një diplomacie aktive dhe strategjike, synojmë t'i ndryshojmë qëndrimet e këtyre shteteve, duke promovuar përfitimet e njohjes së Kosovës dhe bashkëpunimit të tyre në nivele politike, ekonomike dhe të sigurisë. Kjo nismë do të sjellë një frymë të re në politikën e jashtme të Kosovës, duke rritur mbështetjen ndërkombëtare për procesin e integritimit evropian.

3. ZBATIMI I PLOTË I MSA-SË DHE OBLIGIMEVE PËR INTEGRIMIN EVROPIAN. Do të angazhohemi për zbatimin e plotë të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) dhe përmirësimit të gjitha obligimeve të Kosovës në procesin e integritimit në BE. Implementimi i MSA-së është thelbësor për të avancuar në rrugën drejt anëtarësimit, duke siguruar që Kosova t'i harmonizojë politikat e saj me ato të BE-së. Ne do të krijojmë mekanizma të posaçëm për ta monitoruar përparimin e zbatimit të marrëveshjes dhe për të siguruar që çdo sektor t'i respektojë standardet e përcaktuara nga BE-ja.

4. KOORDINIMI DHE MENAXHIMI I FONDEVE IPA. Do të përqendrohemi në menaxhimin dhe koordinimin e fondeve të Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA), duke siguruar trajnime për shërbyesit civilë dhe përgatitje të projekteve konkurruese për të përfituar nga asistencë financiare e BE-së. Kjo nismë do ta përfshijë krijimin e një kornize institucionale për ta optimizuar përdorimin e fondeve të IPA-së, me qëllim që të maksimizohet ndikimi i tyre në zhvillimin e infrastrukturës, arsimimit dhe sektorëve të tjerë prioritarë për Kosovën.

5. PËRDORIMI EFEKTIV I FONDEVE TË BE-SË PËR PROJEKTE ZHVILLIMORE. Do të angazhohemi për projekte konkurruese nga institucionet e Kosovës, të cilat do t'i plotësojnë kriteret politike, institucionale dhe ekonomike, duke ndihmuar në përparimin e Kosovës drejt anëtarësimit në BE. Këto projekte do të përqendrohen në përmirësimin e infrastrukturës, zhvillimin e sektorit bujqësor dhe inovacionin teknologjik, duke rritur kapacitetet konkurruese të vendit në tregun evropian dhe përmirësuar standardin e jetesës për qytetarët.

6. SYNIMI I STATUSIT TË KANDIDATIT PËR ANËTARËSIM NË BE. Gjatë mandatit të ardhshëm, do të punojmë për ta marrë statusin e kandidatit për anëtarësim në BE, duke shënuar një hap të rëndësishëm në rrugën e integritimit evropian. Ky status do të hapte rrugën për negociatat formale të anëtarësimit dhe do të ofronte mundësi të reja për Kosovën që të përfitojë nga fondet dhe programet e BE-së. Do të zhvillojmë një

strategji të hollësishme lobimi, duke bashkëpunuar me partinerët ndërkombëtarë për ta përshpejtuar këtë proces.

7. BASHKËPUNIMI I NGUSHTË ME SHOQËRINË CIVILE. Do të angazhohemi ta përfshijmë shoqërinë civile në procesin e integritimit evropian, duke gjetur akterë të rëndësishëm për zbatimin e politikave të BE-së. Përmes dialogut të hapur dhe transparencës, PDK-ja do të sigurojë që organizatat e shoqërisë civile të kontribuojnë në mënyrë aktive në ndërtimin e politikave që harmonizohen me standardet evropiane, duke sjellë në vëmendje shqetësimet dhe nevojat e komuniteteve lokale.

8. PËRCAKTIMI I TREGUESVE TË MATSHËM PËR PROJEKTET E FINANCUARA NGA BE-JA. Do të vendosim tregues të qartë për matjen e rezultateve konkrete në sektorët kryesorë, duke synuar përmirësimin e politikave të brendshme dhe zhvillimin e vendit. Këta tregues do të përdoren për ta monitoruar efikasitetin e projekteve dhe për të siguruar që investimet nga fondet e BE-së të kenë një ndikim të qëndrueshëm në sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë dhe shoqërisë së Kosovës.

9. EDUKIMI I PUBLIKUT PËR PROCESIN E INTEGRIMIT NË BE. Do t'i kushtojmë vëmendje të veçantë edukimit të publikut për procesin e integritimit evropian, duke informuar për kushtet, obligimet dhe institucionet e BE-së. Përmes fushatave të ndërgjegjësimit, PDK-ja do të synojë t'i rrisë njohuritë e qytetarëve për përfitimet dhe sfidat e integritimit në BE, duke i bërë ata pjesë aktive të këtij procesi të rëndësishëm për të ardhmen e vendit.

VEPRIMET E PROPOZUARA PËR MËRGATËN

1. FORCIMI I LIDHJES SË DIASPORËS ME KOSOVËN. Do të angazhohemi që t'i forcojmë lidhjet mes diasporës dhe Kosovës, duke përmirësuar shërbimet dhe mundësitë për qytetarët e Kosovës jashtë vendit. Përmes programeve të veçanta për bashkëpunim ekonomik dhe shkëmbime kulturore do të krijojmë mundësi që diaspora të kontribuojë më shumë në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

2. PËRMIRËSIMI I KUSHTEVE DHE SHËRBIMEVE KONSULLORE PËR DIASPORËN NË KOSOVË. Do t'i zgjerojmë shërbimet konsullore, do të hapim konsullata të reja dhe do ta përmirësojmë orarin e administratës për t'i lehtësuar nevojat e diasporës gjatë periudhave të ngarkuara. Gjithashtu, teknologjia digjitale do të përdoret për ta përmirësuar qasjen në shërbime, duke lehtësuar procedurat burokratike dhe ulur kostot për qytetarët jashtë vendit.

3. PËRFAQËSIMI I DIASPORËS NË INSTITUCIONET E KOSOVËS. Diaspora do të ketë vende të garantuara për përfaqësim në Kuvend dhe Qeveri, duke i dhënë zë më të fuqishëm në proceset vendimmarrëse. Ky përfaqësim do të ndihmojë në përfshirjen e drejtpërdrejtë të diasporës në zhvillimin e politikave publike që ndihmojnë në përmirësimin e kushteve për ata që jetojnë jashtë vendit.

4. KRIJIMI I REGJISTRAVE TË DIASPORËS SIPAS PROFESIONEVE. Do të hartohen regjistra që do t'i kategorizojnë anëtarët e diasporës sipas profesioneve të ndryshme, duke përfshirë studentë, ndërmarrës, sportistë dhe ekspertë. Kjo bazë e të dhënave do të ndihmojë në identifikimin dhe lidhjen e profesionistëve të diasporës me projektet zhvillimore dhe sektorët e ekonomisë që kërkojnë ekspertizë specifike në Kosovë.

5. HAPJA E QENDRAVE TË REJA KULTURORE PËR DIASPORËN. Do të punojmë për të hapur qendra kulturore të reja në vendet me përqendrim të lartë të diasporës, duke ndihmuar në ruajtjen e identitetit kombëtar dhe kulturor. Këto qendra do të shërbejnë edhe si pika takimi për organizimin e eventeve kulturore, edukative dhe shkëmbimeve të përvojave ndërmjet diasporës dhe Kosovës.

6. MËSIMI PLOTËSUES NË GJUHËN SHQIPE PËR DIASPORËN. Për ta ruajtur gjuhën dhe identitetin kombëtar, do të mbështesim zhvillimin e mësimin plotësues në gjuhën shqipe për fëmijët e diasporës. Kjo nismë do të ndihmojë në forcimin e lidhjeve kulturore dhe gjuhësore të gjeneratave të reja me atdheun, duke ua ofruar atyre mundësinë t'i ruajnë rrënjët dhe kulturën shqiptare.

7. ANGAZHIMI I DIASPORËS NË LOBIM NDËRKOMBËTAR DHE PROMOVIM TË KOSOVËS. Do ta mbështesim angazhimin e diasporës në lobimin ndërkombëtar për njohjen e Kosovës dhe sjelljen e investimeve të huaja. Diaspora do të luajë rol kyç në promovimin e Kosovës në fusha si biznesi, politika dhe diplomacia, duke përdorur rrjetet e tyre ndërkombëtare për t'i avancuar interesat kombëtare të Kosovës.

8. NXITJA E KTHIMIT TË TRURIT DHE INTEGRIMI I TALENTEVE TË DIASPORËS (BRAIN GAIN). Do të angazhohemi për ta nxitur kthimin e profesionistëve dhe talenteve të diasporës në Kosovë, duke krijuar programe të posaçme për integrimin e tyre në tregun e punës dhe sektorët kyçë si arsimi, shëndetësia, teknologjia dhe inovacioni. Përmes këtyre programeve, profesionistët e kthyer do të kenë mundësinë të kontribuojnë në zhvillimin afatgjatë të vendit, duke sjell përvoja dhe njohuri të avancuara që kanë fituar jashtë Kosovës.

VEPRIMET E PROPOZUARA PËR RRIJTEN E INTEGRIMIT MBARËKOMBËTAR

1. RIPARIMI I MARRËDHËNIEVE ZYRTARE ME SHQIPËRINË DHE RIKTHIMI I MBLEDHJEVE TË PËRBASHKËTA PERIODIKE MES DY SHTETEVE. Marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Shqipërisë janë jetike për stabilitetin dhe bashkëpunimin rajonal. Riparimi i marrëdhënieve zyrtare me Shqipërinë dhe rikthimi i mbledhjeve të përbashkëta periodike mes dy shteteve do të jenë prioritete të rëndësishme për Kosovën. Kosova do të angazhohet në mënyrë aktive për t'i përmirësuar dhe konsoliduar marrëdhëniet institucionale me Shqipërinë, duke synuar të krijojë një platformë të përhershme bashkëpunimi në nivel qeveritar. Rikthimi i mbledhjeve të përbashkëta periodike në mes të dy qeverive do të shërbejë si një mekanizëm për të adresuar çështje të përbashkëta dhe për të planifikuar projekte strategjike në fusha si infrastruktura, ekonomia, energjia dhe kultura. Këto takime do të jenë, gjithashtu, një hap vendimtar për koordinimin e qëndrimeve në proceset e integritit të përbashkët në Bashkimin Evropian dhe për përfortimin e pozicionit të shqiptarëve në rajon.

2. THELLIMI I BASHKËPUNIMIT KONSULLOR ME SHQIPËRINË PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË PËRBASHKËTA. Thellimi i bashkëpunimit konsullor me Shqipërinë për ofrimin e shërbimeve të përbashkëta do të jetë një hap strategjik për t'i rritur burimet dhe për ta përmirësuar efikasitetin në përfaqësimin e interesave të qytetarëve të të dyja vendeve. Kosova dhe Shqipëria do t'i bashkojnë misionet konsullore për të ofruar shërbime të përbashkëta në vendet me interes, veçanërisht në zona të largëta të globit, ku të dy vendet kanë një prani të kufizuar diplomatike. Ky bashkëpunim do ta lehtësojë qasjen e qytetarëve ndaj shërbimeve konsullore dhe administrative, si dhe do t'i përforcojë marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve në arenën ndërkombëtare, duke krijuar një model unifikues për diplomacinë shqiptare. Për më tepër, kjo nismë do t'i rrisë kapacitetet për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve të diasporës në vende ku përfaqësimi diplomatik është i dobët.

3. LIDHJE TË REJA INFRASTRUKTURE ME SHQIPËRINË. Kosova do të fokusohet në ndërtimin e lidhjeve të reja infrastrukturore me Shqipërinë dhe vendet fqinje për ta forcuar integrimin rajonal dhe zhvillimin ekonomik.

- **LIDHJA HEKURUDHORE.** Do të promovohet krijimi i një lidhjeje hekurudhore moderne midis Kosovës dhe Shqipërisë, e cila do të rrisë tregtinë, transportin e mallrave dhe lëvizjen e njerëzve, duke krijuar një korridor strategjik për rajonin.
- **TUBACIONI I GAZIT QË LIDHET ME TAP.** Planifikohet ndërtimi i një tubacioni gazi që do ta lidhë Kosovën me Rrjetin Trans-Adriatik të Gazit (TAP), duke siguruar diver-

sifikimin e burimeve të energjisë dhe një infrastrukturë më të qëndrueshme për energjinë.

- **RRUGË TË REJA.** Do të ndërtohen rrugë të reja për ta lehtësuar lëvizjen ndërkufitare dhe për ta nxitur zhvillimin ekonomik të rajoneve malore dhe kufitare. Ngjashëm me rrugët rajonale ndërshtetërore të bëra së fundmi në krahinën e Hasit dhe të Dragashit, do të ndërtohen rrugë dhe pika të reja kufitare në Koshare - Padesh dhe Restelicë - Grykë Çajë, duke rritur qasjen dhe mundësitë për bashkëpunim ekonomik dhe turistik midis Kosovës dhe Shqipërisë dhe duke integruar më mirë rajonet kufitare.

4. PROJEKTE TË PËRBASHKËTA ZHVILLIMORE E INSTITUCIONALE ME SHQIPËRINË.

Kosova dhe Shqipëria do të bashkëpunojnë për hartimin e projekteve të përbashkëta zhvillimore, duke synuar shfrytëzimin e burimeve natyrore, potencialin ekonomik dhe forcimin e integritit mes dy shteteve. Projekte të tilla mund të ishin: hulumtime në zonën e Sharrit ose Bjeshkëve të Nemuna për ta gjetur potencialin e një resorti ndërkufitar të turizmit malor. Pra, projekte konkrete të prekshme zhvillimore ku mund të përfshihej edhe sektori privat nga të dy shtetet ose donatorët dhe investitorët e huaj. Njëherësh, mund të ndërmerren diskutime për investime të përbashkëta në institucione apo projekte me interes të ndërsjellë, si laboratorët e përbashkët ose një njësi e përbashkët ajrore për fikjen e zjarreve, etj. Po ashtu, mund të ndërmerret diskutimi për ndërtimin e një pike të përbashkët të kërkim-shpëtimit malor, duke qenë se zona alpine e Kosovës në pjesën më të madhe ndodhet pranë kufirit me Shqipërinë. Në kuadër të bashkëpunimit institucional do të zgjerohen përpjekjet për harmonizimin e procedurave apo standardeve në mënyrë që të lehtësohet e thjeshtohet bashkëpunimi në çdo sferë.

5. FORCIMI I LIDHJES ME MAQEDONINË E VERIUT.

Kosova me udhëheqjen e PDK-së do të përpiqet t'i forcojë raportet me shtetin fqinj jugor jo vetëm në kuadër të fqinjësisë së mirë, por edhe për t'i konsoliduar lidhjet tradicionale që kanë shqiptarët që jetojnë në të dyja anët e kufirit. Në këtë aspekt do të vijohet me projekte infrastrukturore që kanë për qëllim lidhjen më të shpejtë e më të ngushtë me bashkëkombësit përtej kufirit siç janë:

- Përfundimi i rrugës Prizren - Tetovë.
- Finalizimi i rrugës Restelicë - Dibër dhe funksionalizimi gjatë gjithë vitit i pikës kufitare në Strezimir.
- Realizimi i marrëveshjes së kahershme për të ndërtuar një pikë të re kufitare Debëllde - Tanushë.

6. PROPOZIM PËR KRIJIMIN E NJË ZONE TË LIRË EKONOMIKE TË DHEU I BARDHË.

PDK-ja propozon krijimin e një zone të lirë ekonomike pranë pikës kufitare Dheu i Bardhë, e cila do të ofrojë subvencione, infrastrukturë të përshtatshme dhe lehtësira fiskale për bizneset dhe sipërmarrësit që operojnë në këtë zonë. Kjo nismë synon të krijojë një

mjedis të favorshëm për investime dhe zhvillim ekonomik, duke tërhequr kompani që do të krijojnë vende pune edhe për banorët shqiptarë të Luginës së Preshevës. Punësimi masiv i banorëve të Luginës, të cilët do të mund të bëjnë kalimin ditor të kufirit për të punuar në këtë zonë, do të shërbejë si një burim i qëndrueshëm të ardhurash, duke kontribuar në zvogëlimin e emigracionit dhe duke ndaluar procesin e pasivizimit të adresave. Kjo zonë e lirë ekonomike do të luajë një rol thelbësor në stabilizimin e popullsisë në rajon dhe në përmirësimin e standardit të jetesës për shqiptarët e Preshevës, duke krijuar një rrugë të qëndrueshme për zhvillimin social dhe ekonomik të tyre.

7. FORCIMI I LIDHJEVE ME SHQIPTARËT E MALIT TË ZI DHE LUGINËS SË PRESHEVËS.

Lidhjet më të afërta me shqiptarët e Malit të Zi dhe Luginës së Preshevës janë prioritetet të rëndësishme për PDK-në. Finalizimi i autostradës së Anamoravës do të mundësojë një lidhje shumë më të shpejtë dhe efikase jo vetëm me Korridorin 10, por mbi të gjitha do ta lehtësojë integrimin me banorët shqiptarë të Preshevës, duke krijuar një rrugë më të përshtatshme për qarkullimin e njerëzve dhe mallrave. Gjithashtu, do të lobohet për funksionalizimin e pikës kufitare Kapi në rrugën Medvegjë - Kamenicë, duke ofruar një mundësi të re për lidhje tregtare dhe sociale midis dy vendeve. Sa i përket Malit të Zi, do ta përshtojmë ndërtimin e rrugës Deçan - Plavë, e cila do t'i forcojë lidhjet ekonomike dhe kulturore midis Kosovës dhe shqiptarëve të Malit të Zi, duke përmirësuar qasjen në rajonet malore dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërkufitar.

VEPRIMET E PROPOZUARA PËR DIALOGUN PËR NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE ME SERBINË

1. RACIONALË DHE TË PËRGJEGJSHËM NË PROCESIN E DIALOGUT.

Në dialogun me Serbinë, Kosova do të qëndrojë e përkushtuar për t'i respektuar dhe zbatuar obligimet që rrjedhin nga marrëveshjet e nënshkruara. Ne nuk e shohim dialogun si dobësi, por si forcë.

2. MOSFRIKA NGA DIALOGU.

Përvoja e kaluar na ka treguar se dialogu është një mjet i fuqishëm për avancimin e intereseve shtetërore të Republikës së Kosovës. Rambujeja rezultoi me çlirimin e Kosovës, ndërsa dialogu i udhëhequr nga presidenti Ahtisaari rezultoi me shpalljen e pavarësisë sonë. Duke qenë se ne do të sigurojmë se dialogu për normalizim është në konsultim të ngushtë me partnerët strategjikë, veçanërisht ShBA-në, ne jemi të bindur se do të sjellë njohje të reja për shtetin tonë dhe avancimin në integrimin tonë të plotë në BE dhe NATO.

3. RISTRUKTURIMI I PROCESIT TË DIALOGUT. Brenda tre muajve të parë të qeverisjes do të bëjmë një ristrukturim të plotë të procesit të dialogut. Ky përfshin demokratizimin dhe institucionalizimin e përfaqësimit të Kosovës, miratimin e një platforme të qartë në Kuvendin e Kosovës dhe krijimin e një strukture gjithëpërfshirëse përfaqësuese që do të përfshijë transparencë dhe konsultime të gjera me qytetarët, shoqërinë civile dhe komunitetin e biznesit.

4. TRANZICIONI NGA LEHTËSIMI NË NDËRMJETËSIM. Ne do të kërkojmë që roli i Bashkimit Evropian në dialog të kalojë nga lehtësimi në ndërmjetësim aktiv, gjithnjë në bashkëpunim me ShBA-në, në mënyrë që procesi të përfundojë me një marrëveshje të qëndrueshme dhe ligjërish detyruese.

5. DEFINIMI I QËLLIMIT PËRFUNDIMTAR TË DIALOGUT. Një qëllim i qartë duhet të përcaktohet në këtë proces. Ne do të punojmë që brenda vitit 2026, Kosova dhe Serbia të arrijnë një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe ligjërish obliguese, e cila do ta përfshijë njohjen reciproke të shtetësisë.

6. BASHKËPUNIMI I NGUSHTË ME SHBA-NË. ShBA-ja ka qenë gjithmonë mbështetësja jonë më e madhe dhe ne do të vazhdojmë ta thellojmë këtë marrëdhënie strategjike. Do të vendosim një dialog strategjik me Shtetet e Bashkuara, me fokus në zgjerimin e bashkëpunimit në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, por edhe për të siguruar njohje të reja për Kosovën.

7. DIALOG KUPTIMPLOTË ME KOMUNITETIN SERB NË KOSOVË. Për ta fuqizuar integrimin e komunitetit serb në jetën sociale dhe politike të Kosovës, ne do të angazhohemi për një dialog të vazhdueshëm dhe të thellë me përfaqësuesit e këtij komuniteti, duke e bërë pjesë aktive të zhvillimit të vendit.

8. ZHVILLIMI EKONOMIK DHE PUNËSIMI NË KOMUNITETET JOSHUMICË. Një program i veçantë do të krijohet për ta nxitur zhvillimin ekonomik dhe për të krijuar mundësi punësimi në zonat ku jetojnë komunitetet joshumicë, duke siguruar që çdo qytetar të ketë rol aktiv në zhvillimin e vendit.

9. INTEGRIMI I SHËNDETËSISË DHE ARSIMIT. Një plan i qartë do të krijohet në konsultim të plotë me BE-në dhe ShBA-në për integrimin e plotë të sektorit të shëndetësisë dhe arsimit të komunitetit serb në sistemin e Kosovës, sipas Kushtetutës së Kosovës dhe Planit Ahtisaari.